

JOSIF PAPAGJONI
KUR HËNA DIGJEJ LART
TREGIME E NOVELA

BOTIMET TOENA

JOSIF PAPAGJONI

Kur hëna digjej lart

Tregime e novela

BOTIMET TOENA



Me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Korrektore letrare: Arlinda Rrushi

Përkujdesja grafike: Arlinda Rrushi

Kopertina: Mirela Mihali

ISBN 978-9928-205-50-6

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Asaj që ishte,
që është e që do të jetë.*

FLUTURA DHE BRUMBULLI

Sime shoqeje, B. S.

- Jola!

... E ktheu trupin me shpinën mbi gur. Guri qe ngrohur nga dielli i asaj vere, ishte bërë përkëdhelës. Në pushin e hundës dhe sipër në qiellzë vinin avujt e uiskit që kishte pirë pak më parë në barin buzë detit dhe kjo ia shtonte prehjen e këndelljen. Mijëra fije të holla nervash e muskujsh, mijëra ganglione, kapilarë mbushur me gjak, dhe nyjat e kockave, dhe unazat e shtyllës kurrizore, dhe lëkura e rreshkur, gjithçka, si të këputura dysh, po rilidheshin e po tuboheshin në një mori vrimash, grimcash e gjallesash të padukshme, ashtu lëvrinjëse e si të heshtura, duke i dhënë mishit e kockave të tij një shkrehje asilloj sikur të futej i gjithi poshtë asaj mase guri të lëmuar nga dallgët miliona vjet. Dhe të tretej aty. Të bëhej edhe ai gur. Ujë i kripur deti të bëhej. Një masë që lëvizte nën diell. Atëbotë iu duk sikur mishi iu fry dhe ajri i hyri në lëkurën e mrrudhur, fishkur nga pleqëria.

- Fli pak, - i tha guri nën të.

- Fli, - i tha dhe mishi i molisur. Një dorë gruaje e butë dhe e dhembshur sikur po e fërkonte lehtë, lehtë.

- Ah, gruaja! - psherëtiu. - Ah, flutura ime! Ajo e kishte lënë...

- Jola, - bëzani pastaj, aq sa dhe gurit nën shpinën e tij të tharë i erdhi keq. Syri nën qepallë lëshoi lëng. Edhe lëngu i tha:

- Fli tani, je i lodhur! Rrashta e gjoksit iu ul poshtë, më pak ajër i thithën mushkëritë dhe atij çasti trupi iu bë eshtër e eshtra gur. Fosile. Po, ai ishte një fosile. Një fosile e “ngrohtë”. Një fosile e rrjedhës së kohës në vrapin e çmendur të jetës, kapur për gryke nga dhëmbët e harresës dhe pakuptimisësisë. Pas vdekjes së gruas, sensin e kohës po ia gëlltiste ditë pas dite ai hiçi i madh, i zbërdhulët, që i qe futur në kokë, pa caqe, pa ngjyra, pa peshë, që po e mbllaçiste nëpër dhëmbë dhe po e bënte copa-copa, kurse kozmosin vetë po e përqueshte duke e kthyer në kotni. “Kurva plakë”, shau ai për të njëmijtën herë “jetën” (s’dihet se kë, të tijën, të të tjerëve apo në përgjithësi).

- Jola, ku je?

Miliona herë po këtë pyetje bënte. Çdo vit ndihej më i lodhur, dita që vinte pas sikur ia këpuste muskujt, ashta e trashë dhe e zvogëluar e trupit i rëndonte, kyçet dhe eshtrat i dhembnin. Në mëngjes ngrihej herët, bënte një shëtitje buzë detit, por këmbët s’po e mbanin më si dikur; luhateshin, sikur i thyheshin në mes dhe ai gati sa s’po rrëzohej. “Pt, këto drejt këmbësh të stërgjata si të strucit!”, shante me vete ai. “Lëvizni shkopin, lëvizni ju hëngërt mortja!...” Që kur e shoqja i qe shuar duarsh, mendja i gjezdiste hergjele e nuk po e mblidhte dot më. Kishte qenë mëngjes herët. Ia kishte marrë kokën ndër duar, i kish folur dëshpërimisht, në ankth, por ajo dha shpirt me sytë e saj ngulur në sytë e tij...

- Jola...

Ndoshta iu duk atij apo pati veçse një përhitje sikur gruaja i foli. Por jo. Jo. Ajo s'kishte folur. Veçse në muskujt e ngrirë të fytyrës së saj kishte mbetur buzëqeshja e fundit. Fare-fare e lehtë. Vetëm syri i tij mund ta dallonte.

- Jolanda... mos ik!...

Por ajo kishte ikur.

Dhe ai s'kishte qarë dot. Sytë s'ia mbylli, ia la hapur. Donte t'ia shihte ende, si një çikëlim qielli i bruztë, paçka se mugëtira e pengonte. Agu s'kishte argjenduar ende mbi xhamin e dritares teksa drita e jetës në syrin e saj të bukur qe shuar. Dhe gjithçka u shpëla. U bë shkrumb. Mbi retinë i kishte mbetur një cipëz e hollë, e hollë, që ende përthyente agun. E kaltra e syve të saj kishte vrapuar gjithnjë e më dhimbshëm drejt blusë, ishte rrëzuar drejt të murrmes, qe epuar gjithë nxit kah e errëta për t'u gremisur tek e pangjyra: vdekja...

- Ah! Ti po ikën, shpirt!... Ike!... Dhe ai rrinte pa lëvizur në shtratin martesor me kokën e gruas mbi pëllëmbën e vet, ndërsa drita po lëpihej pas kurrizit të malit si luspë e stërmadhe peshku. Qentë, sakaq, kishin reshtur së lehuri.

- Flutur, - pëshpëriti.

E uli ballin dhe e vendosi mbi ballin e të shoqes, ndjeu leshrat e zeza të asaj koke të bukur, lëkurën që po ftohej pak nga pak, i rrëshqiti buzët mbi pjesën e gunguar të vetullave, i zbriti në gropat e syve, i puthi përmallshëm. Dy pika loti prej syve të tij pikuan e ranë mbi cepat e syve të saj, riguan teposhtë rrudhave të faqeve të flashkura si të ishin loti i lotit. Pastaj ia uli qepallat dhe iu duk sikur po mbyllte, jo sytë e saj, por portat e shtëpisë së vjetër të prindërve, dikur. Dhe ai, fëmijë i frikësuar nga shiu dhe qentë, qante e ulërinte mbetur befasisht jashtë, tmerrësisht jashtë...

- Flutur, - pëshpëriti sërish.

- Brumbulli im, mos ki frikë, jam këtu me ty! Eja të të tregoj një përrallë, eja! Hape portën! Mos u tremb nga qentë! - iu bë sikur dëgjoi nga pas...

- ... Na ishte njëherë një brumbull i zi, krenar për vetveten, - filloi të tregonte ai, - i rumbullt, kokën të shogët, me trup paksa të gjatë, disi i zeshkët, në të verdhë, lëkurë gruri, me fytyrën e mprehtë, që mbante syze. Ca miq andej-këndej qytetit thoshin se ishte njeri i lexuar, domethënë i mençur, me disa libra botuar, 20 a 25. Por ai e dinte se të gjitha qenë brofka të bukura për të gënjyer veten dhe të tjerët. Madje, si për ta gënjyer paq veten, hidhte rëndom mendime “të arta” në kartë, me qindra syresh, domethënë nëpër gazetatat e kohës: dër-dër-dër dhe vër-vër-vër. Ah, kjo gënjeshtër e bukur! Ah, ky rreng i vjetër i mendjes! Sa shumë i pëlqente! S’qe pos një tradhti e pafajshme e arsyes së topitur, një përvjedhje prej “hiçit” në voli të “diçit”, iluzion trallisës, venitje, frymë e ajër që peshën e rëndë të lëndës e të trupit ia hiqte! Mirëpo të shoqen, pikërisht kjo gjëzë rrenacake, ky sendërgjim i mendjes së tij, e bënte krenare. Dhe kështu krenaria e tij, prej krenarisë së saj, kishte zënë qiejt e pak purpur prej purpurit të hyjnueshëm, kishte marrë sipëri...

- Po pastaj? - iu bë se e pyeti e mbesa, një flokëdrudhë topolake, lëkurartë e syulli. - Ç’ndodhi pastaj, gjysh?

- Ku, kush, kur shpirti i gjyshit? - u hutua ai dhe doli nga molisja e trurit.

- Në përrallë...

- Ah, po, në përrallë, - buzëqeshi lehtë dhe e solli mendjen sërish në bina. U kujtua se pranë vetes kishte mishin e hajthëm të jetës, atë që kishte nxjerrë syth prej mishit të vet: mbesën e tij të zgjuar e të bukur me ato drudhat e saj që ia tundte vazhdimisht hundës, duke i kërkuar çdo ditë nga një përrallë. I duhej të bëhej një Sheherazade. “Dreq o punë, çfarë s’të bën kjo shejtankë e

vockël!”), mendoj një grimë ai. Riciklonte përralla nga Anderseni e shkrimtarë të ngjashëm me të, por dhe ato mbaronin. “Harry Potter”-in e kishte rrëfyer me kohë. Edhe përrallat e vendeve skandinave me Zylfida e Ulenshpigela ia kishte thënë.

- Mirë, pra, po të tregoj një përrallë tjetërsoj.

- Është e bukur?

- Po, shumë e bukur.

- Tregoma, tregoma! Dhe rishtazi humboi në përfytyrim.

- Ej, ti e ëmbla dhe e bukura jetë! - ia nguli sytë ai syve të mbesës si nëpër tymtajë të bardhë.

- ... Na ishte edhe një flutur, - vijoi plaku rrugëtimit të mendjes, - por kjo s’qe e zezë si brumbulli tullac e namuzqar, por e bardhë, shumë e bardhë, me sytë e rimtë që i ndërronin ngjyrë nga e bruzta tek e kaltra, nga qielli te deti, nga Jonufra te Krorëza, me një zë të butë, të butë, dhe të ngadaltë, të ngadaltë, mbytur në drojë e respekt. Dhe kjo flutura, shpirti i gjyshit, qe e hajthme, gjifortë e këmbëdrejtë, me pakëz gushë nën mjekrën e rrumbullt, buzagaz, me dhëmbët e mëdhenj nxjerrë jashtë me rast e pa rast, me një nishan në gushë e një tjetër në faqe, me qerpikun e kthyer si vala kur vjen nga tejdetit tek thyhet e zhaurin bregut të gurtë. Dhe ma kishte atë buzë aq të bukur, të hollë si një petal trëndafili që lakohet cepit përpjetë. Dhe më kishte një aromë...

- Sa bukur, gjysh! - shqoi ai dy vrimat mbi faqet e mbesës përthithur nga pjalmi i përrallës. - Si princesha tek...

- Po, zemra ime e vogël, si princesha... - dhe ai ndjeu se si rrodhën ujërat, lulet, avujt, ngjyrat, aromat, dritat, imazhet mes brinjëve të tij të thara dhe viruan paskëtaj drejt e në zemrën e lodhur. Ndenji pakëz, tërhoqi frymë brenda kraharorit, fryma ia hapi brinjët cep më cep, enët e gjakut iu zgjeruan, dhe të gjitha ato: ujërat, lulet, avujt, ngjyrat, aromat, dritat, imazhet

vërshtuan lirisht brenda tij dhe ia mbushën mishin me kujtesë. E kujtesa i theu caqet e eterta, një tjetër trajtë mori, solli vegime e u bë ndjesi.

- Një ditë brumbulli, - vazhdoi ai, - teksa fluturonte për të ngopur barkun me kokrra manash të pjekur, e pa fluturën që po rrotullohej ajrit të freskët të atij mëngjesi në qejf të vet dhe u bë xheloz se si ajo “dreqkë” ngjitej e ngjitej lart pa teklif e zbriste sakaq vrik teposhtë si në një rrokapjekthi. “U bë dhe kjo pipiruke të më shesë dëngla mua”, shpotiti me vete brumbulli. Dhe ashtu krenar siç qe, i foli: “Ej, flutur, mos m’u qas pranë se më bën vapë, është 25 korrik sot, dhe ora s’ka vajtur ende 11⁰⁰, ik nga kjo shkallare e moçme e nga ky tempull!...”. Flutura s’ia vari dhe brumbullit i erdhi inat. Pëf, as e tundi qerpikun fare! U gërmuq ai. Ia përmendte gjithmonë 25 korrikun, orën 11 dhe tempullin antik, sepse pikërisht atëherë dhe atje e kishte njohur. Me thënë të drejtën, ai vdiste për të. Qe gati që për lumturinë e saj të shiste ç’kishte, edhe trupin e tij të fortë me muskuj si fibër çeliku, edhe zhguallin e kurrizit të zi, edhe mustaqet qimeashpra që i zgjateshin nën buzë...

Heshti. Mendja e la përrallën. Rierdhi në fushëtirën e pluhurt të fundjetës. Ndjeu një si këputje të ëmbël në pejzat nervore rreth gjunjëve, pastaj i shtriu rishtazi këmbët mbi rrafshin e ngrohtë të gurit mu buzë detit. Kockat, palca dhe muskujt kishin thithur me kohë shumë ftohme brenda tyre dhe smërçi i kishte drunjëzuar, mrrudhur e holluar.

- Ah, ç’më bëre! - lëngoi ai. Fishkëllima e gjakut në vesh e pastaj në kokë po e shqetësonte, kurse mishrat nën shpatull i ndjeu të kapitura. Imazhi i fytyrës së mbesës u tret. Kujtoi se qe ende pranë tij, por kishte harruar që kishte shkuar me të ëmën në lokal sipër. Harroi, madje, ç’kishte sajuar pak sekonda më parë siç harronte shpesh në ikamendjet e tij: niste të thoshte diçka e diçka tjetër i

dilte përpara syve. Mendja lodronte kujtimeve, ato iknin e vinin me shpejtësi. Lëviznin e ndryshonin trajtë si retë dhe avujt e mëngjesit, aty bëheshin të njëmendta, aty xixonin nga poetika, më tutje shndërroheshin në nyjëtime imazhesh trillane e plot ngjyra, merrnin formën e përrallës, ktheheshin në mit. Truri i tij këtë punë bënte: sajonte e sendërgjonte vazhdimisht. Mbamendja po i humbte kufijtë e logjikës, e të besueshmes. Imazhet përziheshin. Ajo që mund të prekej me dorë teksa syri vendoste caqe të rrokshme, transformohej sakaq në diçka pa peshë, pa siluetë, pa formë, efemere, si ag. E matshmja bëhej e pamatshme. I pëlqente sidomos arratia nëpër kurme fantazish viteve të fëmijërisë së pafajshme e vrapacake, i pëlqenin metaforat ku deti bëhej arë me grurë ngjyrë blu e mali bëhej drapër që korrte yje, ku reja ngjante si floknaja e femrës shkundur nga era ndërsa limeret e detit si gjinjte e sirenës, ku fjala “të dua” mbinte si druri i portokallit mbi buzët e vajzës dhe digjej paskëtaj si kometë nëpër rrjedha ujërash të shkumëzuara. “Shiko atje, - i thoshte të shoqes, - stuhia po bëhet dragua e dallga kuçedër me 12 kokë. Shën Mihali me shpatën e zjarrtë po ia pret.” Ajo qeshte nën buzë, ia njihte fantazinë. “Budalla”, i thoshte. “A s’ngjan ajo tutje si një violonçelë?” “Shiko, shiko!”, këmbëngulte ai. Dhe gishti i mbetej liqenit të Butrintit, kthehej brigjeve të Ksamilit, shndriste Plazhit të Pasqyrave, lakohej lumit të Bistricës teksa ai përndritej shkëmbit aty te Kanali i Çukës e i turrej detit. Ngjante si një “fallos” që hynte vërtimë atij kanali. Dhe kanali i jepte lumit formën e trupit muskulator të një djaloshi në vrap, shtatbukur si një Akil, krep më krep e buzë më buzë, me ushtën drejt për t’ia ngulur detit mu në gjoks. E deti të vdiste. Gjak të bardhë të nxirrte, shkulma valësh të ëmbla e të shëllirta, ku ujërat të kërlesheshin me njëra-tjetrën, për t’u përqaftuar e pajtuar tutje, thellë, në një akt dashurie stërkalash e shkumëzimesh. “Unë jam Bistrica, po ti kush je?”, e ngacmonte me nëntekst ai të shoqen. “Ti je budallai”, buzëqeshte për të njëmijtën herë ajo...

Në rini kishte qenë i gjallë, gazmor. I pëlqente muzika, ndaj mësoi t'i binte kitarës. Kitarë e ndihmonte të tërhiqte vëmendjen e vajzave, syrin e tyre që shuhej midis avullit të lotit zhytur në eros. Ashtu e kishte tërhequr edhe syrin e saj. Sidomos të Saj. I kujtohej kur ajo mbeti fill vetëm një mbrëmje me të. Me atë dhe kitarën e tij. Dhe zërin ai e bëri mall, e bëri aht të shpirtit, e bëri brengë, dashuri e bëri, zë Orfeu që bilbilat të heshtnin e të dy në afsh e lot të klithnin:

*Të prita, oh, sa shumë të prita,
Dhe s'mërgon nata, dhe nuk vjen dita...
Pranvera jo, lule nuk çeli,
Ç'më ngriu dimri, ah, ç'borë që derdhi!...*

I kishte shkruar vetë ato vargje dhe po vetë e kishte kompozuar serenadën. Serenadën e dashurisë, në fill e në bulëz. Ia shihte syrin. Ngulazi. Dhe syri i saj i bruztë, ashtu si deti, u mbush me lëng e kulloi. Një sy i bukur. Një lot i bukur. Dhe aq shumë mall. Dhe aq shumë afsh. Dhe fryma që digjej. Dhe buza e hapur. Dhe pellgu poshtë që mishin e saj të murrme mbushte. Dhe atë hop, ajo e puthi. Apo e puthi ai? Nata kishte ikur, bora kishte shkrirë. Veç dy buzë digjeshin kredhur mbi dy buzë të tjera. Ah! Dhe lulet kishin çelur, dhe dimri qe gremisur. Ah! Ndoshta ai dru buthi i kalbur, vetëm ai e dinte se kush e puthi: Ajo atë apo ai "Atë". Ndoshta i kishte parë edhe ajo përroska marrake që shushurinte gjithë gëzim aty bri. Ose syri i butë i asaj lope, kokëngritur, që përtypte paqësisht fije bari. Ose... ose... një bretkosë e lagësht që frynte e shfrynte gushën, e habitur pse ato krijesa të çuditshme ishin ngjitur ashtu bark me bark e gojë me gojë pranë pellgut ku ajo kishte shtëpinë e vet, bretkun e saj! Por ata, si për inat, u puthën e u puthën sa akrepi i orës u thye e koha vetë e humbi kuptimin. Vetëm bulkthi që cëriste si i çmendur

nga gëzimi, e kuptoi. “Puthuni!”, u tha ai. Edhe një harabel që kërcente degë më degë mbi atë buth, ashtu u tha: “Puthuni!”. Atëbotë pellgu lumë u bë. E lumi det. E deti krejt në mish iu fut. E shkuma e tij e bardhë mbi atë pellg të ngrohtë mbeti tek ai lumë i murrmë, tek ai det gazmor e tek ato dallgë që suleshin e rrihnin pa pushim bregut të saj. U puthën e u puthën aq sa trangu i ullirit bri tyre nisi të digjej. E fleta, ullirit të vjetër mu në zemër i çeli gjelbërim. Mes zjarrishtës i çeli. Dhe nishani i saj i vogël nën qepallë u bë një hënë e madhe që lëshonte purpur mbi syrin e tij. Dhe lëkura e saj e bardhë u hap e argjend derdhi mbi faqen e tij. Dhe një okër të lehtë, të lehtë mbi qimet e ashpra. Dhe të tria ngjyrat u bashkuan, u bënë magji: dy sytë e saj në syrin e tij dhe nishani i vogël nën qepallë si aureolë. Dhe ai mbeti mbi ata sy e mbi ato buzë si dritë e aromë 50 vjet. Të vetmet buzë. Dhe e pa syrin e saj si premtim për 50 vjet. I vetmi sy. Dhe e dashuroi siç dashurohet në dashurinë e parë, 50 vjet. E vetmja dashuri.

Dhe ja... po ia mbante kokën me flokët tashmë të zbardhur nga pleqëria. Skalpi lëshonte aromat e fundit të gjakut nën të. Koka e saj mbi pëllëmbën e tij peshonte sa vetë jeta. Bota krejt qe aty. “Mbamë, Atlas!”, nisi të futej miteve ai. “Mbamë që të mos vdes, siç supet e tua mbajtën dheun mbytur në brengë! Falëm dhe ti, Pitagora, ti këngëtari i kozmosit! Ti ishe dijetar. Ti s’e dije ç’ishte vdekja e njeriut. Ti dije vetëm vdekjen e kozmosit tënd trillan, muzikën e yjeve që këputeshin heshturazi natën. Por muzika e gruas është shumë e dhimbshme, Pitagora im: nuk kullojnë yje të shuar nga gjiri i Artemidës, por lot të nxehtë burri. Dhe shpirti të dhemb. Më vdiq shpirti, miku im! Vdiq, rënduar atje, në shtratin tonë, pak më tutje orës tre. Vdiq syngulur mbi mua. Ku t’i fusja sytë unë i gjori, ku? Dua të ulërij, Pitagora! Mos më shaj pse rrjedh kaq shumë syri! Rrjedh se floku i saj i zi mbi bërrylin tim kishte rënë. Dhe bërryli qau

shumë, qau në vetmi, heshturazi. Më shumë se unë. Dhe teksa bërryli qante, po atë grimë buza e saj sesi lëvizi, kështu m'u duk, Pitagora im. Dhe më tha:

*Më puth, i dashur,
Gjak buzët m'i bëj,
Se në gjak bilbili,
Ka të ëmbilin zë.*

*Ah, moj ëndërr,
Aventurë e krisur, ah!
Në shkulmin tënd
Lulëzoi si zambak...*

*Ah, ky gji që mbushet,
Si gushë pëllumbi gufon,
E të vdes mbi ty,
Prej dorës tënde gjakon...*

*Më puth, shpirti im,
Që frymën e fundit ta jap,
Zjarr ti më kall,
E përjetë më ngjall!"*

Ai e puthi. Buza e saj ishte ende e ngrohtë. O Zot! Floku i saj u drodh. Apo atij iu duk kështu. Tek hoqi buzët nga buzët ende të ngrohta të së shoqes, iu bë se fryma e të porsavdekurës doli si një gurgullimë uji rrënjëve të lisit a degëzash shelgu lëshuar.

- Jola... - u përmall ai.

Dhe po atë hop syri i saj iku.

- Po brumbulli, gjysh, pse e la fluturën “Jola” që të ikte? - iu bë se i foli zëri i mbesës diku. Dhe mendja i brodhi sërish e sërish drejt mitit që ai vetë e shpikte si ngushëllim.

- Sepse brumbullit, moj shpirtë, i pëlqente lirshmëria e fluturës, e qeshura e saj, dhëmbët rruazë, sidomos shkathtësia, por dhe delikatesa, mirësia, ai trupi i hajthëm e i bukur me dy nishane të vogla ngjyrë okër nën buzë. A e di ti, drudhka ime, se brumbulli u dashurua me flatrimin dhe cërcëritjen e krahëve të saj? Me gjoksin, duart, këmbët, barkun, pushin, sytë dhe dy “gërshetat” që i ngriheshin lart mbi kokë? Me ato dy “gërsheta” prej fluturë si antena, ajo e dinte se ku mund të ishte brumbulli i saj, por dhe brumbulli me ata dy brirët e tij të zinj e dinte se ku mund të ishte ajo, dhe e gjenin njëri-tjetrin herë në bulevardin buzë detit, herë në 7 shkallaret e qytetit, herë në një shitore e herë tjetër pas një kthese, duke cekur duart rrëshqitazi, duke ndezur vështrimet e duke i thënë gjakut “digju”! Gjenin diku ndonjë qoshe në errësirë dhe putheshin. Brumbulli ia kapte flokun si push, që i zgjatej krahëve të shkruar. Zhyste aty hundën dhe aromat e saj ia bënin mushkëritë qiell. Dhe qielli bëhej ylber. Dhe ylberi valle. Ashtu kishin vallëzuar që të dy në mbrëmjen e maturës, si ylber. Të gjithë e dinin se ata qenë të dashuruar dhe i lanë të vetëm në sheshin e vallëzimit: Ai dhe Ajo. E në atë vallëzim ylberi i nxori gjithë ngjyrat. Ia merrte e verdha e këmbëve të drejta të fluturës, e kuqja kapte për dore pullat e hirta mbi barkun e saj të sheshtë, bëhej tok me portokallinë e kupave të gjurit, dhe portokallia bashkohej dorë për dore me sytë e lumtur të brumbullit. Të gjithë në atë pyllnajë trokisnin duart sipas ritmit muzikor dhe ai e rrotullonte dhe e rrotullonte fluturën e tij, e fluturës i hapej fustani si kurorë palme, e qafa e zgjatur si mjellmë i binte drejt e në ovalen e supeve të tij mbushur mish të fortë. Të joshur, nën trokitjen e duarve të maturantëve, ata gati u puthën në sytë e tyre. Sepse vetëm dritë

e ngjyra shihnin sytë e brumbullit dhe të fluturës, moj çupa e gjyshit! Dhe kur u futën në atë vallëzim shiritat ngjyrë vjollcë të gjoksit të saj të vogël e të fortë që ra mbi gjoksin tim... Oh, ç'të të them, o flori, ç'të të them?!

- Po jo mbi gjoksin tënd, o gjysh, - korrigjoi mbesa, - por të brumbullit. Ti je plak.

- Po pra, të brumbullit, - e transfiguroi sërish veten në brumbull ai. - Drithëronin gjinjtë e saj me çikëlimet e të murrmes së butë nën këmishën e bardhë puplin. Dhe bluja, ah, ajo bluja aq e bukur e syrit, ia bënte det të paanë shikimin. Shokët dhe shoqet e maturës, që të gjithë, i kishin rrethuar që të dy, brumbullin dhe fluturën, dhe rrihnin duart sikur ata të qenë dhëndëri me nusen.

- Po pse, kanë shkollë insektet, o gjysh?

- Kanë shkollën e tyre dhe ata.

- Pastaj?

- Pastaj ngjyrat s'mbaronin, o shpirt! Dhe lumturia s'mbaronte, o zemër! Dhe erdhi "Edeni"...

- Kush është Edeni, gjysh?

- Edeni është një krua me ujë të kristaltë. Vetëm brumbulli kishte pirë atje. Herën e parë kishte pirë mbi lëkurën e trashë të një shtogu të moçëm nën shi, me 13 degë e 13 llambadarë qelqi, me xhama pa fund, ku të dyve iu dukej sikur fluturonin, prandaj dhe porsa zbrisnin prej andej, përqafoheshin e putheshin. Kur puthej ajo bëhej shumë e bukur. Dashuria e tyre ishte e dëlirë, ndaj dhe gjallesat e tjera puthjen e tyre nuk e shikonin me inat, por si përdëllim ndaj dashurisë që shuhej paqësisht brenda secilit çdo mbrëmje. "Ah, dashuria, dashuria!...", psherëtinin ata tek i shikonin të dy dhe buzëqeshnin. Brumbulli e kishte ftuar fluturën krahëshkruar që të shkonin edhe te gjethet e hapura të një gështenje të lartë 24-degëshe, plot abazhurë, ku ndriste luksi e qyteti hapej teposhtë si krahë zogu. Nuk u puthën, veç i dhanë krahë ëndërrimit

duke parë qytetin dhe u tretën në ajër zhytur te sytë e njëri-tjetrit, me qiellin dhe natën sipër. Ata merrnin arratinë jashtë qytetit, diku në një shtog buzë lumit, te një mollë plantacioni, mbi lulet e një kumbulle në autostradë, nën zgërbonjën e një ulliri buzë katundi, te gjethet e një bajameje ku ai shpesh i shkruante vargje dashurie, te fiqtë e një shtëpie mali në qytetin e gurtë ku ajo kishte lindur e prindërit e saj kishin ngritur folenë, te një stol ku trëndafilat luanin me pulpat e tyre ngjitur, në errësirën e kinemasë shtrënguar pas njëri-tjetrit me gjakun vrushkulluar. Një ditë gënjyen familjet dhe shkuan mbi ca rrënoja të një qyteti antik, futur mes harlisjes së pemëve dhe aty, ngrohur nga trupat e njëri-tjetrit, qëndruan të vetmuar deri në mbrëmje vonë. Atje ata u bënë dy në një, lëkurë më lëkurë, por pa hapur portat. Dhe një hutim i bukur ua vrau kohën. Ai i thoshte se atje kishte bujtur motmoti Enea i trojanëve, djegur nga grekët e Agamemnonit, duke mbrojtur fis e farë. Dhe atyre iu duk vetja, s'dihet pse, si të qenë Helena me Paridin arratisur gjelbërimit: fajtorë të dashurisë së tyre të pafajshme. I kujtohej edhe kisha e vogël e Shën Sofisë, kur strukur pas xhamave blu dhe nën mbrojtjen e shenjtorëve, ata ndezën fshehurazi qirinj dhe u lutën që dashuria e tyre të rronte në jetë të jetëve. E si ta harronin pastaj ditën kur shkuan te një kështjellë mesjetare mes shiut të verës, që u kishte rënë rrebesh mbi krye e ujë i kishte bërë? Por ata nuk kishin ikur. Bash aty, i tmerrshmi i shqiptarëve, Ali Pashë Tepelena kishte vënë kurorë me greken e brishtë e të bukur, Vasiliqinë. Flutura, e mahnitur dhe e pahitur, e kishte tërhequr pas vetes brumbullin. Kërkonte një kurorë. Dhe brumbulli e kuptoi. Ajo u shtri. Edhe brumbulli u shtri bri saj. Këmisha e tij dhe këmisha e saj qenë të qullura. E ç'u duheshin këmishët?! I bënë çarçafë të “natës së parë”. Se qe një shtrat i thjeshtë me plloça guri dhe bar të lagur shtrati i tyre. Atje brumbulli ia kishte parë lotin e bukur

të humbjes së vashërisë. Dhe qe betuar: “Do ta bëj të lumtur fluturën time!...”.

“Ku shkon?”, i fliste asaj e ëma syshqyer sa edhe e pikëlluar.

“Në shtëpinë time, mama!”, i përgjigjej flutura dhe i tregonte brumbullin që e priste në rrugë, hipur mbi një makinë rrangallë. E ëma i ishte hedhur në gjoks dhe e kishte përqafuar me lot në sy.

“Prit, moj, prit, merri këto!”, dhe i kishte zgjatur boçën me rroba. Flutura ia mori dhe hipi në makinën rrangallë me sytë e kthyer nga e ëma. Dhe kishin ikur. Thanë se brumbulli e kishte rrëmbyer fluturën, se ai ishte mysliman dhe ajo e krishterë dhe familjet e tyre s’donin, se i ati i fluturës u kishte dërguar haber njerëzve të brumbullit që vetëm plumbi e ndante këtë turp, se vëllai i saj ishte betuar që do ta vriste brumbullin dhe do ta sillte motrën në shtëpi, se nëna u dërgonte fshehurazi lajm që të ndërronin strehë kur i biri nisej tinëz për t’i gjetur. Dhe ata iknin larg e më larg nëpër male... Diku atje thellë ndërtohej një hidrocentral. Pikërisht atje shkuan. Dashuria e tyre u kalit në prush si hekuri, farkëtare ishte koha. Hyji i farkëtarisë i grekëve të lashtë, Hefesti, qe topall. Ashtu ishte dhe koha e tyre, por jo fati. Ai u priu. Moirave që pleksnin fjetet e fatit, u erdhi keq për ta. Ndonëse ishin pa burra, në plazmën e tyre drithëronte instinkti i gruas që dashuron. Dashuria e fluturës me brumbullin në fillim ishte frikë e shpresë bashkë, mall e pikëllim, inat e përdëllim. Por pastaj kishin fryrë erëra të ngrohta. Se brumbulli, o shpirti i gjyshit, qe djalë punëtor, njeri me vlera, e nderonin të gjithë. Ai u shkruante gjithmonë letra të gjata babait dhe vëllait të fluturës, betohej se e donte dhe do ta bënte vajzën dhe motrën e tyre të lumtur. Dhe një ditë ata i erdhën që të tre në vendin e largët: babai, nëna dhe vëllai. Dhe brumbulli u gëzua aq shumë, ndërsa flutura s’pushonte së qari. Qante flutura, qanin dhe ata. Qeshnin ata, qeshte dhe flutura.

- Po pse qante dhe qeshte flutura, o gjysh?
- Nga lumturia dhe malli, kështu qajnë dhe qeshin njerëzit e mirë, moj bukuroshe!

- Uaaaaa, sa përrallë e bukur, more gjysh, vazhdoje, vazhdoje!...

- Po ja, brumbulli dhe flutura u gëzuan shumë. Dhe ia merrnin vrapit, me qindra e qindra herë lodronin trup me trup mbi një hardhi rrushi, ku gjethnajës së saj frynte era e malit dhe cicëronin bilbilat. Por ata zogj gushëkuq, krahëgjelbër e bishtundës s'i pickonin me sqepat e tyre të mprehtë. Qenë të mirë. Dhe aty, prej nga dukej gjithë pylli, kapur dorë për dorë, brumbulli i fliste e i fliste fluturës pa pushim, gjer në lodhje: “Të thashë se do të vijnë, të thashë?!...”. Dhe i kujtonte atë ditë kur mbi një syth mani, teksa e mbante mbi krahët e tij të fortë, plot kujdes e përgjërë, ja, mu atje e kishte shtrirë. Dhe kishte ndodhur çudia. Fleta e hardhisë ku rrinin, befas qe këputur. Por, oh! Sado me peshën e tyre përsipër, ajo gjethe zemërbardhë nuk kishte rënë poshtë, përkundrazi qe ngjitur lart si një qilim fluturues. Sepse në barkun e saj qe tashmë dhe fryti i tyre. Ata s’e kishin parë sesi qe këputur ajo gjethe rrushi, as kishin kuptuar gjë. Ata veçse putheshin. Por fleta e madhe e rrushit bashkë me dy trupat e tyre qe ngjitur lart e më lart prej erës, anohej herë majtas e herë djathtas si krahët e një avioni.

- Kush e drejtonte vallë?

- Fryti i tyre në barkun e fluturës e drejtonte, moj pipiruke! Se fryti është ajër, është qiell. “Shihni, shihni, ata po bëjnë dashuri!”, thoshin njerëzit poshtë. “Eeee, dashuria!”

- Pse psherëtin ashtu, o gjysh?

- Të gjithë psherëtinë, moj kumbulla e gjyshit.

- Domethënë, po dashurove, psherëtin?

- Psherëtin, qan, qesh, vrapon, fluturon, siç fluturonte edhe brumbulli me fluturën mbi fletën e hardhisë. Dhe ashtu buzë më buzë shikonin bukurinë që shtrihej poshtë. “Të dua si era”, i

thoshte ai. “Të dua si ajri”, ia kthente ajo. Dhe era me ajrin u bënë streha e puthjes së tyre të përhershme. Poshtë ishte qyteti, por ata nuk e shikonin: “qyteti” qenë ata vetë. Dhe ai e kishte ndier aq thellë lagështirën e buzës së saj tek i thoshte: “Ky është lëngu im!”. Dhe ajo e kishte ndier gjuhën e tij në gojën e saj dhe ia kthente: “Ky është mishi im!”. Dhe kështu ditëve, muajve e viteve, flutura i këndonte të njëjtën ninullë: “Brumbullo, eja tek unë, unë liqen e ti një lumë, uji yt mbush shpirtin tim, shpirti im për ty një himn...”. Kurse brumbulli ia kthente: “Ika flutur, fluturim; mal e fushë, mbi det e bimë; zjarr e mall, si era erdha; shelgjishteve si lumë u derdha; atje ftoi më thotë eja! Atje ëmbël rrjedh rrëkeja!...”.

- Ç’është kjo këngë e shpifur, o gjysh?

Rishtazi në trurin e plakut mori formë fytyra e bukur e mbesës me atë pakënaqësinë e saj për përrallën e tij “të shëmtuar”. Dhe bejtet që porsa kishte sajuar, iu dukën vërtet, siç i quante mbesa, “të shpifura”...

- Pse, di të puthë brumbulli i zi? Iiiiiiii, - u neverit ajo.

Ai e kuptoi se mendja i kishte sajuar sërish një nga ato rrengjet e përditshme për t’i bishtnuar trajtës konkrete të gjërave. I kishte qejf vargëzimet dhe gjithnjë i “recitonte” gruas të atilla, që i quante “budallallëku numër 1... 2... 3... 300...”. E bënte këtë sa herë hynte në shtëpi pas punës, zakonisht kur vonohej. Me sa duket, eglendisej me vargëzime kur kishte mbledhje të gjata rutinë, pa thelb, kotni e rite të mërzitshme sociale. Ajo e kuptonte dhe e ndiqte teksa i shtronte për të ngrënë. Rimat i vinin vetiu, ishte bërë me kohë njëfarë bejtexhiu...

- E ç’ta zgjasim më historinë, - vijoi plaku brenda zhguallit të trillit që i sajonte mendja e ndezulluar. - Ta thashë, moj zemër, të dy, edhe brumbullin e zi e tejet krenar, edhe fluturën e bardhë e tejet të çlirët, fati i bëri bashkë që të vinte në jetë babi yt dhe të lindje ti.

- Mua më ka lindur mami, - ia priste vogëlushja.
- Po babi ç'ka bërë?
- Babi hante bukë me makarona, - shtrembëronte buzët ajo.
- Pra, s'e paska punuar hiç arën ky babi yt, vetëm sa ka mbajtur ison, kështu?
- Babi im s'ka qenë bujk që të punonte arën, o gjysh, por është “juridik”.
- Ashtu?
- Po, kështu!
- Po ujin e bardhë kush ia dha mamit tat që të lindje ti, ë?
- Ua-ua, o gjysh, uji s'është i bardhë, qumështi është i bardhë... edhe akullorja...
- Mirë de, mirë, ama, që babi yt e ka punuar “arën”, këtë e di mirë gjyshi.
- Jo, gjysh, jo, bujku e punon arën, kështu e ka libri, - ngulte këmbë ajo.
- Dakord, e lëmë ujin, e lëmë akulloren, e lëmë dhe “arën”, po “kafenë” me kë e pinte babi atëherë, ë? - hidhte sërish në lojë ai nënkuptimin seksual.
- Me mamin, - i përgjigjej vajza.
- Edhe brumbulli, me fluturën e tij e pinte “kafenë”, çdo mbrëmje.
- Po mami me babin pse e pinë vetëm në mëngjes, o gjysh?
- Eh, zakone-zakone, - ia kapi ai mbesës së vet rricat e flokëve duke u argëtuar me hedhje-pritjet pa të keq të fjalës. - Brumbulli me fluturën, moj shpirtë, s'kishin orar, e pinin kafënë edhe në mbrëmje, edhe në mëngjes. Pinin shuuuumë “kafe”, puçrriza e gjyshit.
- Po pse kaq shuuuumë, - e përqeshi mbesa.
- Ashtu u qe bërë zakon. Herë i thoshte ajo: “Do pish një kafe” e herë i thoshte ai: “Të të jap një kafe?!”. U pëlqente shumë “kafeja” që të dyve, ditë-natë, vdisnin për të.

- Ma trego, ma trego gjysh!

- Po ja... - ia niste plakun, - një ditë, si piu “kafenë” me fluturën e tij atje në verandën e shtëpisë, për t’iu mburrur për vetitë e rralla prej kokëshogu dhe truprrumbullaku siç qe, demek si “i paarritshëm” në kompjuter, brumbulli i tha: “Ej, flutura ime, unë ta kaloj kur fluturoj. Ti flutur e ke emrin, por unë fluturoj më lart. Unë fluturoj mbi man e shegë, mbi mollë e kumbull, edhe mbi plepin që kap qiellin me degë e sythe, edhe mbi shtërgun krenar që mbi ajër flatron te liqeni i Pogradecit, edhe mbi shqiponjën e Hasit ku fryn era. Unë arrij qiellin, moj!... Ta mban të bëjmë një garë bashkë, moj-moj?!”.

Flutura vetëm buzëqeshi. I njihte mburrjet e tij, por e toleronte, sepse e donte. I pëlqente. I dukej një brumbull-budalla. Por budalla-tralala. Me ato bejtet e tij ai e bënte për të qeshur. I hiqte lodhjen, mërzinë. I pëlqente, madje, edhe koka e tij e shogët dhe e lëmuar. Edhe syzet e tij. Lëre “kafetë”! Dhe herë-herë mendonte t’ia merrte atë kokë e ta vendoste si topt h mbi gjoksin e saj. Ai gjak e ajo qumësht. “Hë, moj budallaqe, ta mban të bëjmë një garë?!”, e ngacmoi brumbulli dhe gufoi nga kapardisja, si këndesi mbi pleh. “Me një kusht, o brumbull-budallai im, - ia preu flutura, - kur njëri nga ne të mbërrijë më lart, ka të drejtën e një...” “E një kafeje?!”, e ndërpreu brumbulli me nënkuptim dhe buza i shkoi vesh më vesh, nxori gjuhën e tij të trashë dhe i shtroi një cipë pështyme buzëve të zhuritura nga dashuria. Se, të themi të drejtën, ai ishte një djalë i fortë, e merrte fluturën në duar hopa dhe kur pinin “kafenë”, shtrati nxirrte flakë. “Jo me kafe, por me një shpullë në fytyrë”, shtoi flutura, por tjetër gjë i thoshte syri. “Dakord”, tha brumbulli dhe mendoi se një shpullë e saj mbi fytyrën e tij s’ishte veçse një lezet më shumë, bile ajo do të ishte një lloj “kafeje” me qumësht, bardhezi, fare e ëmblëlth.

Dhe të dy u nisën fluturim. Brumbulli hapi krahët e fuqishëm dhe po ngjitej lart: zhu-zhu-zhu. Flutura e ndoqi pas: shu-shu-shu. I vërtitej trupit të tij, herë poshtë barkut e herë mbi kurriz, e shihte me tinëzi e shpoti, i nxirrte gjuhën e hollë, qeshte me të. Zhu-zhu-zhu e shu-shu-shu, ecën e ecën e ecën, punuan e lindën fëmijë, ajo pellg e ai lumë, ajo dhë e ai gurë, herë me gjumë e herë pa gjumë, herë me gaz e herë me lot, udhë e pa udhë, aksione e zbore, ik e shko autobusëve, trenave, avionëve, makinave, dhe prapë punë, punë, punë, diku me lopatë krahut, diku me çekiç e mistri, tulla e llaç. Zhu-zhu-zhu e shu-shu-shu, kursyen lekë e bënë çati, ik nga fshati dhe eja në qytet, ik nga qyteti dhe eja në kryeqytet, hyr e dil librave, rropatu me gjuhët e huaja, diku harruar në punë e diku me krisma kallashnikovësh, dhe plot britma, sherre, demonstrata, mitingje, fli nëpër zyra e fli nëpër kasolle, ku në borë e ku në zheg, emigrant andej e i përbuzur këndeje, u dhanë fëmijëve shkollë, dashuri, mirëqenie, u lodhën e u rraskapitën, me ca u prishën e me ca u ndreqën, pastaj fëmijët u martuan, bënë fëmijë të tjerë, njëri këndeje e tjetri andej, morën kurbetet, gjithsesi larg tyre dhe ata, më në fund, që të dy mbetën vetëm. Vetëm. U plakën papritur, zunë ilaçet, bisedat u bënë njësorj: më dhemb këtu e më ther atje, harro e kujto, vdiq dhe ky, vdiq dhe ai, ah, kur ç'më bie një hemorragji cerebrale natën në gjumë, në kokë e në gropë, veç jo me vuajtje e në krevat dergjur, kush do të më bëj hyzmet? Dhe kosa binte e pakonte grigjën njerëzore një nga një drejt lëndinës së hiçit. Dhe erdhi ajo natë... Mëngjesi s'kishte zbardhur ende, o zemra e gjyshit! Dhe më vdiq flutura në pëllëmbën e dorës...

- O gjysh, mos qaj!
- Po m'u shua si qiri... me syrin e kaltër mbetur syrit tim...
- Pse nuk e ngjall fluturën, pra?
- Vetëm në përralla ngjallen njerëzit...
- Po ti the se brumbulli dhe flutura nuk vdiqën.

- Po.

- Uaaa, sa mirë! Mos i vdis, o gjysh, aman! Ma trego si mbaron përralla, të lutem?!

- Ku e lamë?

- Flutura dhe brumbulli u ngjitën lart, lart...

- Po, lart...

Dhe plaku zbriti sërish në kalldrëmet e fabulës.

“Kam për ta puthur”, tha me vete brumbulli dhe iu turr fluturës, por ajo “frap”, e shkathët siç qe, iu shmang dhe fluturoi më tutje. Ajo ik e ai ndiq, ajo ik e ai ndiq dhe duke u ngjitur lart e më lart qiellit, brumbulli ndjeu peshën e trupit të vet. Ai po i rëndohej gjithnjë e më shumë. Toka po e tërhiqte. “Ah!”, i tha më në fund i mundur. “Ti qenke vërtet flutur! Ti je ajër, qiell, dritë, je e lehtë, je e shpejtë, unë jam tokë, jam gurë, jam i rëndë, jam i vrazhdë, jam i ngadaltë. Po bie!” “Kapu pas meje”, i tha ajo. U përpoq të kapej pas saj, por duart s’e mbajtën, pesha e uli. Ishte lloj insekti i ndërmjetëm: qiell-tokë. Kishte shumë dhjamëra, kishte punuar shumë, ishte lodhur, ishte sharë e përsharë, kishte qeshur e kishte qarë, kishte dashur e kishte urreyer, thikë ata e thikë ai, grusht ata e grusht ai. Por kishte mbetur gjallë. Gjallë... Tani, ah, po i merrej fryma, krahët sado të fortë dikur, s’po e ngrinin dot lart trupin e tij të rëndë. Befasisht ishte plakur. Bukuria i kishte humbur. Flokët i kishin rënë, lëkura i qe rreshkur, pështyma i rridhte nga goja. I kishin dalë dhe ca sëmundje të shpifura, jo diabeti që po ia shkartiste mishin, jo zemra, jo sytë, jo koka, jo tensioni, qe shushatur, nisej për diku e mbërrinte diku gjetkë, harronte emrat, harronte...

Ah, moj kokoridhka e gjyshit, kështu është gatuar i ngrati njeri, në fillim plot ojna e bojna, ndërsa në fund pa ngjyrë e pa tru. Prandaj dhe brumbulli u tha reve: “Ikni o re nëpër qiellin e paanël!”. Dhe retë ikën. Mbeti pa to. I la. I la dhe lumenjtë. Dhe

u tha: “Rridhni e vraponi deteve, s’kam fuqi t’ju mbaj!”. I lëshoi dhe shirat, bubullimat, rrufetë. Dhe u tha: “Bini, o rrebeshe, mbi shpinën time!”. I kujtohej se edhe “Syrin e kaltër” atje në Sarandë e kishte pastruar vetë, që princesha e tij t’i shpëtonte thonjve të kuçedrës me përgojimet e saj, me sharjet, shpifjet, intrigat, që ta përqafonte princin gjithë mall. Por tani ai burim uji i kulluar i kishte ikur duarsh dhe duart i qenë rreshkur. Edhe vetëtimat s’donte t’i mblidhte më në grusht si dikur. Boll rrufe i kishin rënë mbi pullazin e shtëpisë. Shtëpinë që e kishte ngritur me gjak, ndërsa zyrtarë të ndyrë rrekeshin t’ia rroposnin duke i kërkuar ryshfet. Por ai kishte bërë një gjest çudanë. I kishte shkruar Zotit dy germa mbi letrën e ashpër të një thesi çimentoje dhe i kishte betonuar atje, tek arkitrau i çerdhes së tij, si ato lutjet e përfaljet e qëmoçme religjioze themeleve të tempujve, katedraleve e kishave. E kishte pritur smirën dhe xhelozinë e të tjerëve mes për mes brinjëve, pa ia lënë të shoqes shakullinën. Edhe ambicien e vuri nën fre, edhe lakminë, edhe nepsin, edhe përkëdhelitë që i jepte emri, edhe klithmën e mishit, edhe ledhatimet e mendjes harbuar nëpër libra, edhe tundimet, edhe qenin e famës që ia kafshonte egon e pangopur si zekthi lopën. Koha e kishte pastruar nga llurbëtira si në tragjeditë greke, dhe ai i pat sfiduar pak nga pak gjithë furitë e veseve, gjithë joshjet trupore, gjithë zdërhalljet, gjithë mëkatet, që ia kishin shqyer gjoksin si zhgabat Prometeut dikur me vikamat e tyre zëçjerra: “Më jep, më jep, më jep...”.

Dhe i la të gjitha...

- Po pse i le, o gjysh? - sikur e pyeti mbesa.

- Sepse më lanë, o zemër!

- Kush të la?

- Purpuri i fjalës më la e para, ndezullia e trurit, lira e Orfeut, poezia, ndaj dhe kitarën ia dhashë një jevgu të ri, sepse loti m’u bë formulë jete, mendim, ide. Pas saj më la loja e mendimit,

diskutimet, ligjërimi, atletika e përsiatjes. Më la filozofia. Gjithçka më dukej një kot. Oh, më la dhe ai... S'kisha më nevojë për Erosin e ndezulluar të pyllit tek çmendte Titanian djegur në epsh.

- Ç'është epshi, o gjysh?

- Drithërimë është, vuajtje, ekzistencë, mllef, ritual, neveri.

- S'kuptoj fare... fare...

- Është herët, por do ta kuptosh dhe ti, shpirti i gjyshit, do të vijë ai dreq... Se ai është si gripi, të zë dhe s'të lëshon gjer në fund. Edhe mua kështu më zuri e s'më lëshoi. Por tani, ah...

- Pusho! - i foli plaku dikujt pa formë në ajër. - Ktheje mallin tënd në transcendencë, pajtohu me Hyjin, bëhu frymë, bëhu ngjyrë, bëhu muzikë, humbe peshën, shtypjen humbel!

Buzët e tij lëviznin fare lehtë, po fliste me vete. Ose fryma e tij bëhej zëth. Një zëth që veç ai e dëgjonte.

- Ndaluni ju ujëra të bardha, mjaft më! Të tejdukshme, qelqore e kristalore bëhuni! Ajër bëhuni! Jam në udhë drejt Zotit. Drejt Hiçit. Dua të marr pakëz frymë. Të prehem pakëz. Fare pak! - dhe plaku u kthye paksa nga ana tjetër. - Ndaluni ambicie, ndaluni ego e panginjur, ndaluni, moj lakmi, ndaluni të tria ju magjistrice, s'ju ndjek dot më, Makbethi s'ju dëgjon, kështjella e tij me kohë është shembur, ndërsa purpuri juaj paqen time dysh e ka shqyer. Më lini të hyj në tempull, atje, te Eskatologosi im. Shporruni që të gjitha! Zhdukuni! M'u hiqni sysh!

- Kujt i bërtet, o gjysh?

- Askujt, flas me vete.

- Po pse flet me vete?

- Sepse jam vetëm, o zemër, vetëm, vetëm...

Në sytë e tij rrëzëlleu një pikëz loti që shpejt zhegu e thau. U ndërmend se pak nga pak e pat lënë dhe puthja, ato qelqe blu që pika shiu mbanin përmbi syprinë të tyre si mall. I mjaftonte një shtrëngim i këputur dore me fluturën e tij. Po tani s'e kishte më.

E kishte lënë vetëm, vetëm... Nuk e donte më rrëqethjen e syrit si dikur, që dridhej siluetave mijëra formash: qiell, det e tokë. I la dhe e lanë. Më në fund e la edhe ajo, mprehtësia. Edhe ajo, kthjelltësia. E la mbamendja. Madje një ditë, teksa në dashuri të përmallshme ishte me një ëndërr që kurrë s’e arriti dot, iu shfaqën qenie si prej engjëjsh, me supe të kuq e flokë të artë; iu shfaq nëna e plakur shamibardhë që i buzëqeshte nga sipër, në yllnajë, iu shfaqën fytyra të tejdukshme kristalore që ecnin bri tij, dhe kishte aq shumë ajër transparent përreth, dhe pemë të bardha, dhe gjokse femrash si prej qelqi, dhe shpina meshkujsh të xhamtë që mund t’i shihje tejprtej. Gjithçka qelq...

- Po mami tënd ku është, o gjysh?
- Atje... - ngriti syrin drejt qiellit ai.
- Edhe gjyshe Jola, atje është?
- Po. Më thërret: “Eja, pse vonohesh?!...”.

Dhe e risolli në mendje gjithë atë fanitje parajsore që i kishte ngjarë teksa ai rrugëtonte mes njerëzish të gjallë e plot djersë të tokës, që ecnin drejt një sheshi mbushur banderola, flamuj, daulle, zëra të çjerrë nëpër podiume. Thuhej se qe fushatë. Gjithë jetën i qe mbushur koka me fushata, edhe këmbët i kishte plot fushata. Fushata e grurit dhe fushata e patates, fushata kundër shfaqjeve të huaja dhe fushata e zgjedhjeve të reja, fushata kundër karkalecave dhe fushata pro NATO-s, fushata e liberalizimit të vizave dhe ajo zhdukjes së minjve. Njerëzit me banderola, flamuj dhe fytyrë e ngjirur nga bërtitjet në kor e rrethuan. U gjend befasisht mes tyre. Po e shtynin para. Po e ngjishnin. Po i merrej fryma. Ç’punë kishte ai me ata?! Dikush ia shkeli këmbën. I dhembti dhe u ulë në tokë. Dikush tjetër i ra sipër. Po e shtypnin. Shihte lart një vrimë qiell. Gjendej mes qenieve të baltës në nxitimin e tyre të përhershëm drejt absurdit, marrëzisë, urrejtjes, përçmimit, si kope shtazësh, të tjetërfartë, trotuareve të kryeqytetit, kredhur në

erën e qelbur të jashtëqitjes, qenve të zgjebosur të rrugës, minjve, ujërave të zeza. I vetëm, i pambrojtur, i shtypur, i shkelur, vetëm me një vrimë qiell përsipër, në ikamendje, ai u gjend në mes i rrëzuar përtokë me fytyra njerëzish sipër. Dhe kërkonte i hutuar prej tyre se ku dreqin ishte i parkuar autobusi i varrezave, pa e ditur se “përtej”, në varreza, s’i lipsej aspak një tufë njerëzish të ndërkryer që ulërinin e lëshonin parulla.

- E paska marrë malli për varret gjyshin. Shko, gjysh, shko, plaka po të pret. Të punon apo hiç?! Ha-ha-ha!... E qeshura e të rinjve pas tij ia çau timpanin e veshit. U tmerrua nga gjithë ajo skorie frymësh e mishrash prodhuar nga mijëra zgafelle grash që qeshnin, që e shtynin, e shtypnin, ulërinin. Po për kë? Përse? Tanimë ai e njihte gënjeshtëtrën, iluzionin e bukur kur brohoritësit shqyenin gurmazet, ndërsa të brohoriturit vidhnin shpirtra, ideale, pará, hipoteka pa fund. Po çfarë kërkojnë vallë gjithë këta njerëz? Akoma duan të gënjehen dhe vetëgënjehen?

- O Zot, s’pushon së prodhuari “idhuj pa krena” ky popull... - shau ai dhe më në fund arriti të dalë jashtë turmës, e cila u derdh tërë ngazëllim drejt një sheshi. Hajde, pra, zhgërryhuni si derrat aty, i bëni temena lider-derbederit tuaj... Në fakt, edhe ai kërkonte “dikë”. Kërkonte shpirtin e tij binjak, Jolandën. S’mund të ikte dot “Atje” pa “Atë”. Dhe ajo herë i vinte si zë ankues: “Pse vonon, po të pres, eja!”, dhe herë i vinte si imazh i kaltër, si një qenie e brishtë ngujuar në një glob të stërmadh qelqi, ndonëse flokët i kishte të zinj e të gjatë. Apo ai glob s’qe veçse syri i saj. “Syri i kaltër.” Lërmëni ta takoj! Largohuni hije, erëra të qelbura, ulërima, njerëz pa tru! Zhbëjuni! S’më hyjnë në punë demonstratat tuaja! Mirëpo globi, teksa ai e merrte në dorë, thyhej e një mijë copa qelqi bëhej. Dhe ajo dilte prej andej e ikte. Terej. Bëhej ajër. “Eja, pra, pse s’vjen?”, i fliste ajo që sipër nga kupola e qiellit. Ndërsa ai binte sërish në tokë, në baltë, në llum, mes erës së qelbur, mbetej cullak

përballë hiçit. “Mos ik, mos ik!”, ngulfatej në gjumë e fryma i bëhej gur.

- Po kjo është si në televizor, o gjysh, mërzitem kështu! - frulloi veshit të tij zëri i pakënaqur i mbesës. - Unë dua një përrallë...

- Përrallë është, zemra e gjyshit, përrallë... Flutur e brumbull, brumbull e flutur qeshnin e gazmonin të dy, atje lart, lart... Toka po bëhej e vogël, e vogël, ta thashë. Njerëzit nuk po dukeshin fare. Dhe të dy ata nuk deshën t'i shikonin më ato qenie të çuditshme atje poshtë, zhytur në llucë. Brumbulli vuri re se si flutura po vallëzonte pranë trupit të tij, herë majtas e herë djathtas, herë poshtë e herë lart, se si e shikonte me bisht të syrit dhe qeshte. “U lodhe brumbull-budallai im, babushi im, pushti im...?” “Jo”, ia priste ai duke fshehur rraskapitjen. Po i reshte fryma. Dihaste. Sipër, mbi kupolën e qiellit, u shfaq një dritë e purpurt. Aq e bukur ajo dritë dhe aq i mrekullueshëm ai purpur, sa fluturës iu duk se mu aty qe shtegu i parajsës. Atje do ta tërhiqte edhe brumbull-budallanë e saj, tek ëndrra dhe pafundësia. “Kape dorë time!”, i tha ajo. Por brumbullin po e merrte pesha e tij me vete drejt tokës, atje ku gëlonin njerëzit mes plehut, jargëve, gjuhëve të pista, dhëmbëve të krimbur, syve të shqyer, erës së ndyrë dhe frymëve të tyre që qelbeshin ngado. “Po bie, - i tha brumbulli, - e fitove ti bastin, qëllomë me shpullë.” Por ajo ia ktheu: “Po të qëlloj, o brumbulli im budalla”. Dhe iu ul poshtë barkut. Dhe për herë të parë, atje lart, në qiell, në ajër, pranë Zotit, ku drita qe e purpurt si perëndimi më i bukur i diellit në det, atje ku ndihej e lirë, ku ëndrra e saj ishte bërë dëshirë, dhe jetë, dhe kënaqësi, dhe lumturi, dhe hir, dhe sqimë, dhe mëmësi, ajo afroi buzët e saj të holla te buzët e tij të trasha dhe e puthi. Ai kishte dashur ta puthte fluturën e tij pikërisht kështu, dhe fryma e saj të futej në frymën e tij si qiell, por asnjëherë s’kishte mundur ta bënte

dot atje, në tokë. Përkundrazi, këtu, në ajër, në lartësi, pranë
ëndrrës, pranë Zotit, ishte pikërisht ajo që e puthi.

Dhe ai ndjeu, çuditërisht, se si fryma e saj hyri me vull në
frymën e tij. E u bënë të dyja frymët një frymë. E u ndje mrekullisht
i lirë, i lehtë, i paprajtë. Ajër. Qiell. Kaltërsi. Dhe fuqia i buloi
trupit e gjakut të tij të bardhë. Dhe pesha e stërmadhe humbi. Dhe
lodhja iku. Brinjët iu hapën, aty hyri era. Mishi iu fry, aty hyri
drita. Dritë e ajër, dhe ai humbi peshë, humbi ngjyrë: nga i zi u bë
i bardhë, pastaj i kristaltë, pastaj vetëm spërndritje.

Dritë dhe ajër.

Dhe ai po fluturonte me fluturën e tij gjithnjë e më lart, lart,
shumë lart.

Dritë dhe ajër.

Që të dy, buzë më buzë e trup më trup ata vraponin atje ku
ëndrra e tyre priste të bëhej jetë, të bëhej brumbull-flutur ose
flutur-brumbull, njësoj që.

Dritë dhe ajër. Ajër dhe dritë. “Ah! Të dua!”, tha brumbulli.
“Të dua!”, tha flutura. Dhe të dy, gojë më gojë e frymë më frymë
ngjiteshin lart e më lart, atje ku pesha bëhej hiç, atje ku mishi bëhej
shpirt, atje ku gjaku bëhej avull...

Ai vdiq.

Kapelën e plazhit e kishte mbi sy. Askush s’e kuptoi. Dukej
sikur po pushonte në qejfin e vet. Vetëm kur plazhistët ikën dhe
mbeti fill i vetëm mbi pllakën e gurtë buzë detit, dikush nga bari
përbri u kujtua, ia hoqi kapelën dhe...

Në sytë e tij ngjyrë kafe prehej një paqe që veç Zoti mund ta
falte.

Qe fytyra e fluturës së tij...

LULJA DHE ULLIRI

... Një farëz e vockël, e vockël, marrë fluturim nga era mes endit të pemëve dhe diellit, vërtitej e vërtitej sikur të vallëzonte qiellit të rimtë të fushnajës, ku kishte gjiri, vëllazëri e histori. Kapërceu një mal, u tremb nga madhështia, kreshtat, akulli, suferinat. Pastaj përshkoi një det, dallgë të përbindshme, anije që rënkonin, detarë dhe peshkatarë që përlesheshin me shkulmat e ujërave, shqotat. Dhe prapë u tremb. “Jeta qenka e tmerrshme”, gati sa s’klithi ajo. Dhe u struk nën erë. Qe farë fushe e blerimi, jo mali e skërke.

- Largomë prej këndej, - u lut ajo. Dhe era e mori mbi krahë maleve e deteve. Në shtjellën e saj fara e vockël e harroi tmerrin. Përballë iu shfaq një breg i bukur, i bukur. Aty dhe një pemë e madhe ulliri, me trungun e hapur si zgërbonjë, degët e gjera me ndoca gjethe sipër, lëkurën si zhavër e vrima-vrima.

- Pse qenka ndryshe nga të tjerët ky ulli? - e pyeti farëza erën.

- Sepse është plak, - iu përgjigj era, - ka luftuar shumë me mua dhe vëllezërit e mi: të ftohtin, breshrin, shakullinën, vapën, zjarrishtën.

- Sa keq më vjen për të! - tha farëza dhe e zuri një mallëngjim i ëmbëlth, iu mbush gjoksi me avull loti. Dhe i ëmbëlthi mallëngjim iu kthye në dëshirë. Dëshirë për të qenë bashkë me ullirin.

- Çomë atje, - iu lut ajo erës.

- Ai nuk është vendi yt, - ia preu era.

- Ai është vendi im, - këmbënguli fara.

- Do pendohesh, - i tha era, - një farëz fushe nuk mund të jetojë dot me një ulli bregu; shihe, ai është plak, ka pak gjethe e një zgërbonjë të madhe mu në gjoks si plagë të hapur, s'duhet!

- Duhet.

- Dëgjomë mua, ai është vendi i vdekjes tënde.

- Jo, - ia ktheu me inat fara, - ai është vendi i jetës sime, më shpjer atje!

Era tundi krahët dhe farëza e vockël ra pikërisht në zgërbonjën e ullirit të moçëm. Vuri re rrënjët e trasha që nguleshin mbi dheun e ashpër të bregut. E dinte se diku në zemër të dheut ato thithnin lëng. “Lëngu i jetës”, kështu quhej. Farëza ngriti sytë lart dhe pema e ullirit iu duk madhështore, diçka që kishte mbirë aty shumë e shumë vite më parë, aq sa koha vetë që thinjur nga pritja dhe harresa. Ulliri sikur e dominonte atë reliev të blertë buzë detit me madhështinë e tij.

“Po, qenka vërtet një ulli i moçëm, tejet krenar, por dhe i butë. Erërat dhe rrebeshet e viteve i paska pritur në gjoks, trungun ia paska çarë dysh rrufeja, fletët i kanë rënë, shumë degë i janë tharë; edhe sythat i janë rreshkur, por sërish ngjaka aq i paqme, aq i mirë, aq krenar. Pa shih, kuvendon ende me qiellin lart dhe detin poshtë”, kështu mendoi farëza e brishtë dhe fill u ul mbi trungun e tij të vjetër, në rrashtën e shkrifët, si të honepsur, mu në mes të zgërbonjës. Mishi i ullirit iu duk si diç e qullët, e flashkët. Farëza u çudit, e tundoj kureshtja. Vuri veshin në syprinë të tij dhe dëgjoi që thellë ca si psherëtima, vajtime e lëngata. U prajt e

u pahit. E ngjeshi edhe më shumë veshin pas atij tuli të butë e si të kalbur. “Oh!”, iu bë se dëgjoi një rënkim të thellë, shumë të thellë.

- Ç’është kështu, mos të lëndova? - bishtnoi trupin e vockël farëza dhe iu bë sikur një shtizë iu ngul në zemër dhe e shpoi tejprtej. Hoqi veshin dhe dalloi poshtë këmbëve të saj një rremb. Iu qas pak nga pak. Befas mbi trupin e ullirit rrahu me tërsëllëm frushulla e erës.

- Oh! - dëgjoi sërish ajo nga përbrenda trungut. Druri i moçëm dukej se po qante. Vuante pleqërinë e vet. Era e tundi dhe e shkundi disa herë me tërbim për ta thyer dysh, por trangu qëndroi.

- Oh! - rënkoi edhe më thekshëm ai...

- Eeej, farëz e fushës, ik prej atij ulliri të thashë, - i foli era nga sipër, - s’është për ty, s’është dasma jote, por vdekja jote.

Dhe era fryu edhe më fort, i zgjati farëzës pelerinën e saj shtjella-shtjella dhe u përpoq ta hiqte nga zgërbonja e ullirit, por ajo, si për inat, u krodh thellë në një vrimë dhe s’donte të dilte prej andej.

- Eja, pra, mos m’u fshih si budallaqë!

- Nuk vij, - ia preu me kokëfortësi farëza, le të jetë dhe vdekja ime; varri im është dasma ime, o erë! Ik prej këndeje, ik! Era tërcëlloi dhëmbët dhe u vërsul mbi drurin e moçëm që ta bënte copë-copë e ta merrte farëzën e fushës me vete.

- Oh! - rënkoi për të tretën herë druri i ullirit. Rënkimi kësaj here që i thekshëm prorre. Farëzës i erdhi aq keq! Ulliri dukej se po qante tani me bote, si gratë e atij vendi, duke shkukur leshrat e duke çjerrë faqet.

- Fiu-fiu-fiuuuu, - ia bënte era.

- Oh, oh, ooooooh! - rënkonte ulliri.

Farëza s’mund ta duronte dot atë rënkim, ndaj dhe vendosi të ngrejë shtëpi pikërisht atje, paçka se era i bërtiste:

- Fisi yt më është lutur të të hedh në fushë mes motrave të tua, që të mbushesh me lëng nga toka e butë e të çelësh lule, e të

lidhësh farë, e të bësh fryt të ëmbël; s'është vend për ty ai, aty ka erëra, ka shkëmbinj, toka është e ashpër, deti është i shëllirtë! Dil, pra! Por farëzës ai ulli iu duk aq i mirë, i heshtur, pa mburrje. Dhe u shtri mbi tulin e tij të butë. Më në fund era iku, e la vetëm. - Nëse do të vdesësh, vdis, fryt të ëmbël s'ke për të bërë kurrë, por të athët! As aromë për vasha të reja s'do të kesh më kurrë!

"Le mos të bëj e le mos të kem", mendoi farëza dhe shpejt e zuri gjumi.

... Një ëndërr e bukur e kaploi. Ullirit i erdhi mirë prej asaj farëze krenare shtrirë mbi të dhe befas tuli iu bë i ngrohtë, i ngrohtë. Nën lëkurën e saj farëza ndjeu se si buronin lëngjet e heshtura të tij, madje ai pushoi së vajtuari dhe asaj iu bë se dëgjoi thellë-thellë një si këngë, një si motiv, ashtu butë-butë.

- Jam në ëndërr, - foli nëpër gjumë farëza.

- Je me mua, në gjakun tim, - dëgjoi një zë nga brenda trungut. I pëlqeu ai zë. Iu duk zëri më i bukur në botë.

- Ku je? - e pyeti.

- Jam këtu, poshtë teje, shtriji duart dhe prekmë! Përqafo më!

Farëza shtriu duart më thellë tulit të butë të ullirit, aty te zgërbonja e moçme, dhe ndjeu në mollëzat e gishtave një masë mishi të butë, të butë.

- Puthmë, - i tha zëri. Dhe farëza e puthi. Sakaq në buzë, në gjuhë e në qiellzë i vërshoi diç e ëmbël, asnjëherë s'kishte shijuar një gjë të tillë. Dhe iu mbush trupi frymë e avull. U bë muzikë.

- A më ndjeve? - dëgjoi që nga poshtë.

- Po, - i tha farëza.

- Kush jam unë atëherë? - e pyeti zëri brenda ullirit.

- Ti je kënga, - u përgjigj farëza. Dhe donte ta dëgjonte edhe më mirë se ç' ishte ajo këngë që vinte aq e bukur nga poshtë trungut, aq e butë, aq e ëmbël, si një pëshpërimë.

- Ti je shpirti, eja! - i tha zëri.

- Po vij, - ia ktheu farëza e vockël. Dhe duart e saj u zgjatën e u zgjatën, pastaj edhe këmbët, gjithë trupi, dhe ajo hodhi kështu rrënjë mbi tulin e butë e të ngrohtë të ullirit. Ndjeu se si trupi iu zhbë, gjoksi iu rrit e iu rrit, fryma ia mbushi kraharorin, brinjët iu hapën dhe koka sikur iu rrëmbush tejprtej me lëng.

- Po vdes, - mendoj farëza një grimë herë në ankth e tmerr.

- Po ringjallesh, - iu bë se dëgjoi.

- Ky është varri yt, të thashë, - i erdhi, s' dihet se nga zëri i erës në vesh.

- Kjo është dasma jote, - ia behu zëri tjetër nga thellësitë e drurit dhe farëzës iu bë se mbi kokë i vunë një kurorë me vezullime dritash mbi det. Për habinë e saj, prej kokës i doli një bulb, një syth, mëpastaj një filiz, një lastar. Ndërsa nga dy thithat e gjinjve i çelën dy pistila. Farëza kishte mbirë mbi trungun e ullirit. Ajo po rritej me shpejtësi. Ajo po transformohej. Gjymtyrët dhe duart iu bënë rrënjë mbi trupin e ullirit, kurse gjoksi dhe koka po shndërroheshin në një lastar të njomë mbushur gjethe ulliri të blerta e si të argjendta, më pas u shfaq një kurorë lulesh të bukura, shumë të bukura, verdhane, të vockla, ku rrëzëllente drita dhe ngjyrat. Ishte lulja më e bukur e ullirit që ato anë kishin parë ndonjëherë. Ulliri i vjetër dukej i lumtur.

- Vdis! - i tha vetes. Dhe trungu i moçëm u thye dysh. Stuhitë s'e rrëzuan dot, bukuria e kësaj farëze e rrëzoi. Trungu ra me gjënim në breg, por për habinë e tij, teksa binte, vuri re se nga trungu i vjetër kishte shpërthyer një filiz i drejtë, i bukur, gjithë dritë, me gjethe palcë të reja. Ai po bleronte, ishte mbushur gjithë lëng, aroma, hov e lumturi. Dhe ndodhi mrekullia... Kënga që farëza e vockël kishte dëgjuar thellë trungut të atij ulliri të moçëm mbi breg të detit po ngjitej tashmë lart e më lart, po rridhte klorofilit dhe lëngut të bimës së re mbirë prej saj dhe kumbonte nëpër

sythat dhe lulet e shumta që kishin shpërthyer sakaq. Ishte ulliri i moçëm që këndonte me zërin e lules, ndërsa lulja vetë, mbirë mbi tulin e tij, ndihej e gëzuar dhe e lumtur që i kishte ridhënë jetë, gëzim e kuptim pemës së vjetër. I kishte ridhënë dashurinë e fundit, më të madhen, më mallëngjyesen, që ishte ribërë dashuria e tij e parë dhe e vetme: dashuria e jetës dhe rijetës. Dhe lulet, sythat, shpërthyer prej asaj fare, tok me filizat, gjethet dhe kokrrat e reja të ullirit, jeshiluar gjithkrah, së bashku këndonin këngën e tyre të pamort...

- Lule, shpirti im, këndo! - i shushurinte ulliri.

- Ulli, zemra ime, këndo! - ia kthente lulja.

Dhe të dy këndonin e këndonin pa menduar për nesër, veç për sot, sot...

Sot...

VEZULLIMI I “RUBINIT”

Ai u afrua dhe tundi kokën lehtë.

- Ka mundësi?

- Më gjithë qejf! - i thashë, dhe të dy hymë në pistën e gjerë të vallëzimit.

Për herë të parë mund ta shikoja aq afër, ta prekja e të më prekte, të kërceja me të sup më sup. Sa herë e kisha parë nëpër ekranet e bardha të kinemave, në televizor, por asnjëherë si tani, fare pranë, të “gjallë”, ashtu i vërtetë, ashtu i njëmendtë, që merrte frymë bri meje...

- Ju studioni për frëngjisht? - pyeti ai.

- Po.

- Ah, shumë bukur! Frëngjishtja ka tingull, asonancë... dhe shumë “ëëëë”...

- Ëhëëëë... - ia bëra unë dhe qeshëm të dy.

- Nëse s’gabo, keni botuar edhe një vëllim poetik?

- “Loti i kujtesës”, kështu e kam titulluar.

- Kujtesës? - ngriti vetullat ai. - Kaq e rëndë paska qenë “kujtesa” për ju? Desha të them për moshën e një... studenteje... “Kujtesa” është histori dhe ajo fillon pas të dyzetave.

- S’është vetëm histori...

- Dakord, është... është... shpirt...

- Edhe drurët kanë kujtesë, - shtova unë.

- Drurët? Ha-ha-ha! Nuk do desha të ishim drurë... - ngacmoi ai dhe sakaq ndjeva shtrëngimin e gishtave të tij mbi gishtat e mi. - Unë, për shembull, po i afrohem “kujtesës”, domethënë stoicizmit të drurit, kurse ju... ehuuuu... - tundi dorën dhe krijoi disa rrathë.

Kishte një fytyrë të bukur, të lëmuar, gati fëmimore. Një tufë flokësh që ia lëpinte ballin e gjerë, bënte hije mbi rrudhëzat e tij të imta e të drejta. Por ajo që ishte joshëse, gati e papërballueshme dhe tunduese në portretin e tij, qenë sytë. Diçka e ngrohtë, e butë, e prajë regëtinte mes tyre. Diçka vezulluese, krejt rinore, si dashuria. Sikur gjithë stërkalat e detit thërrmuar pas shkëmbit të qenë mbledhur aty. Një e kaltër e mrekullueshme si... si... S’di me çfarë ta krahasoj. Shkurt, ata sy të magjepsnin. Tjetërloj. Të qashtër...

Dhe m’u përfytyrua Gjergji. Si grima e beftë e një vegimi ëndërror. Vetiu më lindi dëshira për të përqasur. Pse ne femrat pushtohemi, vallë, prej kësaj manie? Mos ndoshta sepse ne, në një tryezë meshkujsh, jemi thjesht “banketi i bukurisë”? Çokollata me bajamet brenda? Akullorja në zheg, buzë detit, shtrirë mbi shezlong? “Preja” qimeartë e gjahut? Një *Coca-cola*?... Ti kështu më the, Gjergji! Dhe cepi i buzës t’u shtriq anash dhëmbëve... Ah, sikur t’i kishe edhe ti sytë si ky Besimi, sa do të t’i pëlqeja?! Por ti sytë i ke të zinj, të thellë, disi të mëdhenj e pakëz të fryrë poshtë qepallave. Nganjëherë më duken edhe të lodhur, indiferentë, si të ngrirë, pa trajtë, pa ngjyrë, hutaq, me qeskat e murrëtyera varur teposhtë...

Nën tingujt e zvargur, por të mbushur me shumë mall të orkestrinës, më pushtoi një ndjenjë e beftë melankolie. Si në pragëndërr. Ndoshta ishte pezëm... Tamam pezëm qe. Sepse mëlçia m'u fry. Dhe m'u bë fare pranë e "hëna", kur u ndava nga Gjergji. Dhe gjoksi m'u ngushtua. Provova thellë një tkurrje që ma rëndoi frymëmarrjen. U ngulfata. Sytë e Gjergjit kishin një ftohje të lehtë si bryma që zverdh fletën dhe e drunjëzon. Edhe duart ne i shtrënguam jo si zakonisht. Vetëm sa kryem ritualin e ndarjes mbushur me fjalë e premtime. "Kodi" ynë, thellë-thellë, kishte pësuar një krisje. Gishtat tanë nuk u përkëdhelën si ngaherë, por vetëm rrëshqitën ftohtësisht njëri mbi tjetrin.

Rutina!...

Ajo e "hënë" e gjitha i ngjasonte një rutine topitëse. Pak fjalë, fare pak gjeste, asnjë puthje. Domethënë, vetëm një cekje rituale anëbuzësh dhe kaq! Gacat e zjarrit qenë shuar. Mungonte malli. Ishte e tmerrshme. Nuk mund ta përfytyroja dot sesi gishtat mund të kapeshin me njëri-tjetrin në fundndarje, pa thënë kurrëgjë. Pa luajtur më. Pa një shtrëngim. Pa një "puthje" të fundit, që veç ata dinin ta bënë mollëz me mollëz.

Rutina!...

O Zot, kjo shtrigë "e bukur" dhe "korrekte" është vrasja e dashurisë! E të papriturës. E lodrimeve. E sfidës. E lëngut të ëmbël, që diku në gjak e pështymë pikon dhe nën gjuhët e squllura mbetet. Dhe kthimi i tyre në një zakon të rëndomtë, në një rit të mërzitshëm. Ishte më e keqe se vdekja. Dhe vdekja fillonte te syri, kapte buzët, pastaj qiellzën dhe shkretonte teposhtë, aty ku duhitë e dëshirës përziheshin me lëngjet gjeneruese... Oh, jo Gjergj, jo, kurrë s'do desha të ndodhte kështu me ne! Kurrë nuk e dua më atë rrëshqitje buzësh, atë qiellzë të thatë, atë nemitje muskujsh, kurrë! Pse u zemërove me mua? Unë nuk desha kurrësesi që ti të fyheshe. Unë ashtu kot e thashë atë fjalë. Unë të dua, Gjergj, të dua shumë...

... Salla ishte e mbushur plot e përplot. Dhjetëra sy vështronin nga Besimi. Ne kërcenim pranë e pranë. Sytë e tij nuk ndaheshin prej fytyrës sime. Sikur diçka kërkonin. Ia ndjeva etjen, edhe simpatinë. Lëngu i rridhte... Dhe në çast u shkunda. Pezmi diku tutje iku, u shkërmoq, u tret. Ç’budallaqe që bëhesh, i fryn gjërat për hiçmosgjë. Dhe ngrita sytë. Mbi sytë e mi gazmonin sytë e Besimit. E kaltra e tij sikur brofi dhe u përthye në një mijë stërkala blu...

E kini vënë re bletën? Fluturon rreth një luleje të bukur, stërpikur nga vesa. Formon mbi petalet e saj një dridhje të lehtë me krahët fërgëllues. Pastaj ulet dhe qëmton polen mbi pistilat e tejppjekur, thith nektar nga gojëzat e tyre të hapura. Bleta... Vështrimi i Besimit se pse më ngjasonte pikërisht me bletën që thithte nektar, duke i dhënë kënaqësi vetes dhe lules njëherësh... Oh, Gjergj, nganjëherë bëhem budallaqe fare! Po ti kështu më the. Unë qenkam si ajo lulja e etur e mesditës, gojëhapur, që thërritkam bletët për të thithur nektarin e grumbulluar gjatë natës... Përdore një metaforë pa vend, Gjergj! Pse më fyen?! A e kupton sa më ke lënduar? Unë jam po ajo: edhe natën, edhe ditën. Jam e jotja.

Pezmi m’u ngjit sërish sipër, kësaj here në zemër, ma ngushtoi kraharorin e sikur ma hidhëroi gojën. U përtypa. Desha sërish të montoja copërat e përfytyrimeve të hallakatura, të krijoja me to pasditen e asaj të “hëne”, bisedën me Gjergjin, ndarjen tonë, por ishte e pamundur. Ritmi i shpejtë i foksit që sapo kishte nisur dhe klithmat e saksofonit, sidomos fytyra e ëmbël e Besimit, shtrëngimi i lehtë i dorës mbi belin tim, vetë prania e tij dhe hapat që morën nxitim, e shkërmoqën përfundimisht imazhin e vagullt të asaj të “hëne” vetmitare, dialogun me Gjergjin dhe mërinë e pabëzajtë të tij. Besimi fliste dhe më shikonte në sy. Disa herë sytë tanë u ndeshën. E kaltra e mahnitshme e tyre, ah, si një qiell!... Dhe sërish m’u bë në mendje bleta me zhuzhimën e krahëve mbi petalet e lules së bukur, nepsi i saj për të zhytur thithkën magjike

mbi gojëzat e hapura plot lëng të petaleve ngjyra-ngjyraku rrënjëzoheshin pistilat, këmbët që grimconin polenin pllenues dhe e ngjishnin rreth qimëzave të tyre ngjyrë kafe. Dhe... dhe... fluturimi i saj te një tjetër lule...

Bleta!...

Përse vallë s'më shqitej nga truri ky përfytyrim?

Besimi ishte një aktor i talentuar. Për rolet e tij diskutohej gjithandej. Figura e një luftëtari të lirisë që luante në një film të fundit teksa vritej për të shpëtuar të dashurën e plagosur, më kishte lënë mbresa të thella. Më kishte gllabëruar, pse ta fsheh?! Isha pothuajse e tronditur. Akoma e kisha në kokë skenën e vdekjes së tij tek ai krua prej guri të latuar teksa rrekej të pinte një grusht ujë, me sytë e rimtë drejtuar nga e dashura. Ujin e vdekjes. Apo të jetës?! Kurse poturet osmane të ushtarëve teposhtë ishin sulur me britma e krisma për t'i dhënë fermanin e vdekjes këtij luftëtari mjekërzi e flokëgjatë, yll të bukur, me jataganin e sermtë shtrënguar në dorën e djathtë, mu si nëpër ato pikturat romantiko-ekzotike të piktorit anglez Eduard Lir mbushur me shqiptarë fytyrëmprehtë, veshur me kostume të fisme. Jo, ai s'mundi ta pinte dot ujin e fundit të jetës, paçka se gurra buronte aty bri duarve dhe buzëve të tij. Ajo gurrëz që metafora e pavdekësisë. Dhe uji binte e binte bri fytyrës së tij të paqme, bri syve të tij të rimtë mbetur hapur. Më dukej e çuditshme që ai luftëtar-hero, me atë sublimitet në fundin e tij tragjik, aq të madhërishëm, aq poetik, të personifikohej te një trup e një fytyrë që kërcente me mua sup më sup. Që më shikonte në sy. Që buzëqeshte. Që e mbante dorën paksa shtrënguar në belin tim. Që lehtësisht dhe pafajësisht më cekte gjinjtë...

- Ju kërceni lehtë! - foli Besimi.

Eh, Gjergj, ti nuk i ke qejf mbrëmjet. Po pse vallë? Ti s'je plak?! As një zyrtar me syze mbi dosjet ngjyra-ngjyra?! Ti dhe

të vallëzosh nuk di mirë. Sa herë m’i shkel këmbët, m’i dërrmon fare...

Ngrita sytë. Ja Besimi! Ja aktori! Ja heroi! Kush që i vërteti nga këta të tre? Nuk desha assesi ta veçoja njeriun nga aktori, aktorin nga heroi; nuk doja që aty ku mbaronte heroi të fillonte aktori dhe pas aktorit njeriu i zakonshëm, domethënë ajo qenia e rëndomtë, si “gjithë ne të tjerët”, që përtypej, që mbllaçiste, që urinonte... Sa kot do të më dukej sikur këtë iluzion të ma shthurnin! Jo. Më pëlqente aq shumë të nanurisesha në tymtajën e tij, herë purpurore e herë të argjendtë. Kisha aq nevojë. Mbase sepse... ti Gjergj ike ashtu, si me inat, atë të “hënë”... Oh, do desha të arratisesha tutje asaj dite, tutje atyre fjalëve, tutje asaj mërie të kotë. Tutje... tutje...

Pranë trupit të Besimit dhe ngrohtësisë që mishi i tij lëshonte bri belit dhe ijëve të mi, mendja budallaqe mërgonte tej. Po ku? Vetëm ne femrat dimë të sajojmë imazhe. Përfytyroja figurën e atij luftëtari të lirisë që kisha parë në film, i cili, “çuditërisht”, ndodhej shi në krahët e mi. Dhe sikur isha pikërisht unë ajo që po i gjendesha teksa ai jepte shpirt, në vetmi, jo aktorja e filmit. Se isha pikërisht unë ajo që po i jepja një grusht ujë. Ujin e jetës. Sepse bash për mua ai po vdiste, jo për atë aktoren. Bash në syrin tim kishte mbetur edhe ai imazhi i tij i mbramë tek jepte shpirt. Dhe ndoshta isha unë që po e puthja në frymën e fundit, jo aktorja bionde në film. Po e puthja si... si... motra e vogël... Dhe ai ujë, që binte paqësisht nga kroi i gurtë bri gojës së tij të hapur derdhej e derdhej si një këngë malli, si një vajtim me oi-oi, si një iso burrash nën zë, me gjakun që i rridhte nga plaga e përhapej rrjedhës si deltëz. Dhe uji më tutje bëhej i kuq. I kuq deti. I kuq horizonti. Kurse unë qaja e qaja... Desha t’i mbyllja sytë një grimë dhe ta ruaja të paprekur, ashtu të bukur, ashtu të kaltër si stërkalat iluzionin e përfutur nga filmi, virtualitetin e shpërndarë si pjalm të njeriut-ëndërr që dashuroja. Ndoshta është e ekzagjeruar kjo

ndjenjë prej budallaçke, ndoshta fantazia ime shkonte ca më tutje nga ç'duhet. Më kuptoni, unë dashuroja imazhin. Ndoshta isha mitomane. Adoleshenca ime pa një të dashur, pa një të puthur të thellë, pa ma shtrënguar kush gjoksën e fortë që çante puplinin, pa më rrasur dikush, dikur, diku, pas një muri palestine, brenda një klase, qoftë edhe në një banjë; adoleshenca ime si kërmilli nën zhguall, e tërhequr veç pas librave, romaneve dhe filmave, pa ankthin e aventurës dhe "shkeljes" së këshillave prindërore, pa ofshamën kur mishi tërbohët dhe ujërat vërshojnë, pa një mashkull sipër meje, qoftë dhe të dhunshëm, nuk po e lëshonte ende këtë llogore të sajën të fundit: virtualitetin erotik. Mirëpo, në fakt, mua më pëlqen ende shumë fisnikja. Sublimja. E madhërishmja. Vdes për to. Truri im përthithet i tëri prej tyre, plagohet, dorëzohet. Dhe bëhem fëmijë, ose më saktë kam mbetur fëmijë. A ka dhe të tjera si unë, që dashurohen me imazhin, me mitin? S'e di. Ndoshta ka. Ndoshta s'ka. Koha sot tipa si unë i ka nxjerrë jashtë mode. Prandaj na quajnë budallaçkë. Pata: ga-ga-ga. "Ju as nëna s'keni për t'u bërë", na tallin vajzat që dinë të bëjnë seks. Në fakt, kjo s'luan ndonjë rol kushedi çfarë në historinë time. Për këtë shkak unë do desha që konvencioni i vrasjes së Besimit pranë gurrëzës së ujit teksa vdiste për të dashurën, të mbetej i paprekur, me po atë pastërti e vërtetësi që i kishte falur arti. Të mbetej, pra, diçka krejt-krejt e bukur, e kulluar, e parrokshme, sublime, vetëm ai, heroi, me vdekjen e tij te kroi, për dashurinë dhe të dashurën, si transcendencë dhe përjetësi...

Në belin tim dora e hapur, gjithnjë e shtrënguar e Besimit, erdhi duke u rënduar, zbriti pakëz më poshtë, aty ku mbaronte gropa dhe drithëronte shtegu i muskujve të vitheve të forta, si për t'i rrokur të tëra. Kurse unë akoma s'po shpëputesha nga ëndja e asaj afrie të beftë teksa mendoja se një artist i njohur kërcente

me mua brinjë më brinjë. Sesi më dukej?! Sikur s'isha unë ajo që flisja. Sikur s'qe ai holl restoranti luksoz, zhytur në gjysmëdritën blu, mbushur me studentë që vallëzonin, por diçka e inskenuar, filmike, përtej meje. Diçka që veç vinte diku nga larg, pa formë, si një masë e butë, diçka si purpur, rrëzëllim onirik dielli mbi retë e bardha. Një performancë. Këndellja ma kishte bërë mishin si të qe plot me ajër përbrenda. Gjithçka matesha ta përfytyroja si në një përrallë fëmijësh, përplot mrekulli dhe jo si diçka të rëndomtë: zgjohu në mëngjes, ha bukë, shko në leksione dhe bla-bla-bla me pedagogët, dhe bla-bla-bla me njëra-tjetrën nëpër kafenera: ky ka dashnore këtë, ai ka dashnore atë. Pastaj kthehu në shtëpi, ha prapë bukë, lexo, studio, pi aspirina nga dhimbja e kokës, shkarko nga interneti, skedo, dhe bla-bla-bla me prindërit dhe bla-bla-bla në *Facebook*. Dhe pambarimisht kështu, mërzitshëm kështu. Ju mund të thoni se ndjesitë e mia ishin të tepruara, si të dala mode. Mundet. Secili ka dobësitë e veta. Edhe unë të miat.

- Kinematografia është ndryshe... - fliste Besimi, pa harruar ta shtrëngonte herë pas here dorën mbi belin tim. - Në teatër, për shembull, arti i aktorit lind dhe vdes njëherësh, në procesin e vetë lojës. Sipari bie, gjithçka mbaron, shuhet. Ka, pra, një fund. Në film, përkundrazi, arti fiksohet në celuloid. Mbetet. Nuk vdes.

Besimi më nguli sërish sytë. O Zot, ishte shumë i bukur... Nga aktorët e rinj që unë e admiroja. Vdisja për të. Madje-madje, në ëndrra apo përfytyrimet e mia edhe flirtoja, pse ta fsheh?! Dha ja, fati e solli që të isha aq pranë, ngjitur me të. Ndieja gjoksin e tij mbi gjoksin tim. Edhe frymëmarrjen. Pastaj ajo muzikë, ajo drita blu...

- Sidoqoftë, ju edhe në teatër luani po aq bukur, - shtova unë. - Në shfaqjen e fundit, rolin e Ferdinandit ju e bënit... tamam...

- Ah, - qeshi Besimi, - diçka jam përpjekur të realizoj. Ishte një rol i vështirë, plot kontradikta shpirtërore. Kishte botë...

Po ti Gjergj, a ke botë?...

- Roli në vetvete është diçka inerte, germa të vdekura, që kërkojnë jetë, shpirt: shpirtin e aktorit.

Sa i pashpirt u tregove me mua Gjergj!...

- Duhet t'i japësh atij, rolit, nga gjaku yt, nga fryma jote, nga shpirti yt, më kupton?

Më kupton, Gjergj?

- Të dorëzohesh tek ai. Je mish prej mishit të tij...

Dhe në belin tim ndjeva shtypjen e gishtave të Besimit, kësaj here më fort. Madje, ato zbritën pak më poshtë, ku niste masa mishtore e vitheve. Dhe aty një gisht, si i pafajshëm, e shtypi atë masë mishi. Uaaaaa, ç'ishte kjo?...

- Roli është aktori, por edhe aktori është roli...

E ç'role mund të luash ti Gjergj?...

- Sepse roli është një rreth i tërë ndjenjash, mendimesh, aspiratash, si ciklet e mbyllura, kontrapunktet, inverset, një simbolikë totale. Duhet të hysh atje, përndryshe mbetesh jashtë. Ah, është shumë komplekse bota njerëzore, është e madhërishtme, pa anë e fund, e cila do analizuar, do zbërthyer, do luajtur bukur, me sens, me art. Roli është... është...

Sa bukur e luajte edhe ti rolin tënd, Gjergj!... Të pashë këtë të diel në televizor dhe motrat më ngacmonin më zë të ulët që të mos i dëgjonte babi: “Shiko, shiko Gjergji!”. Unë u skuqa pak, por më erdhi aq mirë. Ishte një kronikë televizive për ujëmbledhësin tuaj, që qyteti mos të përmbytej më. Ti ishe në rolin e inxhinierit. Sa bukur që flisje, Gjergj! Sa “botë” që kishe! Dhe “sens”. Dhe “kontrapunkte”. Dhe “inverse”. Gjithë “simbole” ishe. Tamam si artist. Megjithëse, t'u mor nja dy herë goja. Dhe babi të shau pak...

- Aktrimi s'është çfarëdolloj mishërimi. Jo. Ai është, për mua, rimishërim i frymës, ashtu si Jezusi te barku i Maries, një

pllenim, si të thuash, “virgjëror”, prandaj dhe aty ka shumëçka nga hyjnorja, nga sakralja... Aktrimi është etiologji, etnologji dhe antropologji...

Ah, Gjergj, ti ironizove me virgjërinë time! The se historia me Lirimin ishte e gjitha banale... Besomë, m’u drodh trupi dhe s’të thashë asnjë fjalë. Ti ike furtunë, gati ma përplase derën në turinj. S’të kisha menduar asnjëherë kaq të vrazhdët. Pse, Gjergj?! M’u duke si ata burrat e moçëm...

Tani Besimi po më fliste për filmat e huaj. Sytë e tij qenë ngulur diku në zbrazëtirë. Ishte krejt i rrëmbyer.

- Ndryshe, ndryshe... Lorenc Olivier është për mua një artist i paarritshëm. Çfarë diksioni, çfarë ndjenje, çfarë temperamentit?! Unitet. Stil. Po sytë? Po fjala? Bobooo, një humnerë, më beso! Lëre gjestikulacioni. Aq ekspresiv. Një kulm. Mbret i skenës. Perandor i vërtetë i artit të aktorit. Demiurg. Hamletin unë s’mund ta përfytyroj dot pa sër Laurenc Olivierin. Një unitet jashtë të cilit vizioni i njeriut do të mbetej cullak, krejt i zbardhur, fyl. Pse qeshni? Mos ju duket se ekzagjeroj?

Sytë e tij, mbushur në të kaltër, u hapën krejt. Sa dritë që kishin, o Zot! Sikur dolën prej andej mijëra stërkala deti. Dhe, s’di pse, iu afrova më pranë. Ndjeva kurmin e tij të ngrohtë, çikjen e gjinjve të mi, ashtu si padashur. Ai fill më shtrëngoi pas gjoksit. Një rrotullim i beftë dhe këmba e tij e majtë u fut vrullshëm në kofshët e mia. Barku m’u rrëqeth...

- Po Aleksandër Moisiu?! - pyeta unë ashtu kot, si e dalldisur nga ky intimitet i kërkuar me ngulm prej tij.

- Oh, Moisiu, ndryshe, mbase më i madh. Profet i skenës, Apolon, kështu e ka vlerësuar kritika botërore, më duket Stefan Cvajgu apo Franc Kafka. Një superstar. Rainhardi, një nga regjisorët më të mëdhenj të shekullit, s’do të kishte bërë kurrgjë pa Moisiun tonë. Le pastaj Basermani, aktori i kurorës gjermane, me sentencën e

tij të famshme: “Kjo unazë...”, domethënë unaza e Inflandit... Infandi qe një aktor i famshëm gjerman i kohës së Gëtes apo Vagnerit në mos gabo, për nder të të cilit ishte themeluar edhe çmimi më i lartë ndër artistët e hapësirës gjermanike. Unaza kalonte, postmortum, nga gishti i aktorit më të madh të kohës së vet te gishti i aktorit tjetër pasues, “trashëgimtarit”. Basermani qe trashëgimtari i fundit. Ai e hoqi unazën nga gishti i vet dhe e hodhi në arkivolin e Aleksandrit. “Kjo unazë të takon vetëm ty, Moisi!”, i tha. Çfarë gjesti fisnik, ë?! Dhe Moisiu e mori me vete në varr, atje në Zvicër, gjithë lavdinë e shekullit. Moisiu ynë... Hej, ç’farë uragani që ishte ai?! Një klithmë. Një ferr i vërtetë dantian. E keni dëgjuar ndonjëherë?

- Jo, - i thashë dhe bëra t’i shmangesha disi gjunjëve të tij që ngulmonin kofshët e mia. Madje më lart, aty ku ato bashkoheshin dhe fillonte materia e shurdhër mishtore e pubisit.

- Pupu... Një tmerr i vërtetë. Lëre kur reciton vargjet e Hofmanshtailit... Era që ulërin vu-vu-vu dhe dallgët mbi shkëmb prau-rau-au, dhe klithmat e zgalemave krau-krau, dhe shakullina e shqotës uuuu-uuu-uuu, dhe shiu sh-sh-shshshsh... Gjithë aliteracione, kadenca, fonosilabe, flukse timbrike, ritme poetike...

U kujtova se nuk ishte e hijshme të kërceja kaq ngjitur me të. Sy xhelozë shoqesh e femrash më ndiqnin, mirëpo unë isha e dashuruar me tjetërkënd. Vallë, ç’do të thoshin të tjerët? Po gojët xheloze të shoqeve që qimen e bënin tra? Desha t’i shtëmëngesha paksa trupit të avullt të Besimit, por dora e tij, përkundrazi, u rras edhe më thellë në belin tim duke më përfshirë krejt. Bëri një tjetër rrotullim dhe unë gati rashë e tëra mbi kraharorin e tij. Kofshët m’u hapën me vrull. Ndjeva, madje, fshikjen e muskulit të tij të drunjëzuar nën bark.

- Më fal! - u turpërova unë.

- Oh, çne?! Ju... ju... kërceni fare... fare... lehtë...

Besimi më nguli sytë. Desha të shihja sytë e kuq të ujkut a sytë e okërt të skifterit, a të kujtdo tjetër grabitqari, por jo! Tjetërsoj sysh qenë ata. Sy aq të bukur. Aq të butë. Krejt e kaltra vibronte aty si një perde rrahur nga fërfërima e mëngjesit. Gjysmëdrita blu sikur e kishte bërë blu edhe fytyrën e tij si në pikturat qelqore të Shagallit. Blu, blu, blu... Mirëpo mishi i tij i drunjëzuar vijonte të cekte herë pas here zonën ku arsyeya humbte.

... Dhe prapë m'u bë në mendje bleta. Zhuzhima e krahëve të saj mbi petalet e luleve, thithka ngjyrë kafe që zhytej thellë për të marrë nektarin dhe... fluturimi diku tjetër... Ah, ky vegim torturues! Shporru sysh!

Kishim hyrë në një zonë të errët. Ai e kuptoi se mishi i tij i drunjëzuar keq mund ta vinte në pozitë të vështirë para syve të të tjerëve që e njihnin. Sidomos për mua kjo do të ishte një turp.

- Hamleti është një humnerë, një infinit, - dhe ai bëri prapë një nga ato rrotullimet e tij të befta, dhe prapë gjinjtë e mi u ngjeshën mbi gjoksin e tij, dhe prapë mishi i tij i fortë preku diku në skajin e poshtëm të barkut tim. - Nuk dua ta banalizoj, por ja, kaq i thellë, i pacak është Hamleti për ne, aktorët. Një ëndërr. Një enciklopedi. Oqean. Tmerrësisht i vështirë për t'u luajtur, më besoni! Një hieroglif...

Frazeologjia e tij tërë emfazë mua më pëlqente shumë. Po, po, shumë. Pse ta fsheh? Ajo më hutonte. Ja që njeriu, nganjëherë, sikur ka qejf ta çlirojë veten nga rëndomtësia: çfarë pive sot, çfarë hëngre dje, sa lekë fitove? Ka nevojë të hidhet në krahët e ekstazës. Të bjerë edhe në delir, diku-dikur, pse jo? Ç't'i bësh, e tillë është natyra jonë. S'jemi gur. As prej druri s'jemi. Duam, pra, edhe të harrojmë. Dhe kur lëngu i kuq i Dionisit shkrihet me gjakun, bëhet vetë gjak... dhe epsh... Dhe pistilat e mallkuara hapen... Dhe bleta vjen... Dhe fut thithën...

Ah, Gjergj, sikur të flisje edhe ti si Besimi me këto “figurat artistike”, “klithmat dantiane”, “humnerat”, “infinitet”, “hieroglifët”, sa qejf që do të kisha?! Por ti nuk flet dot kështu, e di. S’i ke për zemër fjalët e mëdha. S’do. Vetëm atë të “hënë” fole edhe ti me figura, me “bletë”, me “polen”, me “nektar”, me “thithka”, me “fluturime nëpër lule të tjera”... Dhe ma përplase derën në turinj. Dhe gati ma ndrydhe dorën nga shtrëngimi. Dhe unë rashë në krevat e qava. Ti ike...

... Me Besimin kërcyem edhe dy herë të tjera, pastaj mbrëmja mbaroi. Kisha pirë mjaft verë. Dhe gjinjtë i ndieja ende si të shtypur nga gjoksi i tij, kurse mishi i butë i shalëve duhej të ishte kuqëluar nga fortësia e gjunjëve të tij që goditnin herë pas here e zhyteshin mbi to sipas ritmit të muzikës. E kisha tepruar.

- Më duket sikur e kemi rrugën bashkë, - tha ai.

- Po.

- Eja, ju përcjell unë...

Dhe hapi derën e makinës, një “Benz” katërfenerësh, i gjerë, luksoz. Unë hipa si budallaqe, pa u menduar fare. Qyteti ishte i heshtur. Gjithkund zotëronte qetësia. Ai vuri pak muzikë...

- Arti është diçka e bukur, Flora, akt sublim. Diçka nga vetvetja duhet të lësh për të bërë art. Një proces i mundimshëm, gati një vetëflim.

- Ashtu mund të jetë, - ia ktheva unë me një ndjenjë tkurrjeje, - por a ka kënaqësi më të madhe për ju aktorët? Juve ju ndjek pas admirimi, duartrokitjet. Të gjithë ju njohin, ju përshëndesin. Ju shohin në skenë, në filma, në televizior... - nisa të fitoj kthjelltësinë unë.

- Mua, pikërisht popullariteti s’më pëlqen, - tha Besimi. - Nuk e di, por më duket diçka, do të thosha, e bezdisshme që... që... të frenon... të ngushton... të...

- E pse? - u çudita unë.

- Sepse duhet të jesh kurdoherë i... i... si të ta them... me një fjalë, korrekt, i përmbajtur, protokollar... “Njeriu në këllëf”, siç thotë Çehovi... Njëfarë Propishkini... Ha-ha-ha!...

Dhe ai qeshi në mënyrë të sforcurar.

- Po pse i përmbajtur?

- Po ja... ashtu... Mijëra sy të shohin dhe ti humbet vetveten, individualitetin tënd, skutat e tua. Intimiteti yt bëhet kuriozitet për të tjerët. Më saktë, thashetheme, ose “skup”, siç thuhet sot, “showbiz”. Ti je në syrin e të gjithëve. S’je, pra, “ti”. Je ai “tjetri”.

Je bërë statistikë, videoklip...

Besimi bëri sërish të qeshte. Unë, përkundrazi, nuk qesha. Ai u kapërdi dy-tri herë, u kollit për të qëruar fytyrën e tharë nga disa emocione krejt të pakuptueshme për mua.

- Bie fjala... Ju keni flokë të bukur, një tjetër mund t’i prekë flokët tuaj pa të keq, kurse unë jo... - u gëlltit ai, kurse dorën e zgjati te flokët e mi, futi gishtat nëpër to. Unë u shmanga, por gishtat e tij vazhduan të qëndronin aty.

- E shikon? Ne trembemi të jemi vetvetja...

Ai vazhdonte të fliste, por tashmë unë prisja të shfaqej sa më parë rrugica e pallatit tim.

- E di ti se ç’është “kallosi”?

- Jo.

- E ka përdorur për herë të parë Aristoteli. “Kallosi” është një koncept estetik që përfshin të bukurën dhe të mirën... Ti je një “kallos”. S’je vetëm e bukur, por edhe e mirë.

- Nga e dini ju?

- Sepse ma lejuat dorën mbi flokët tuaj kaq të butë...

Ai e ktheu dorën dhe me prapthinë e saj më preku faqen. Ndërsa truri im, në beftin e panikut vajzëror, kuptimin e asaj dore e ndryshoi veçse përmes një germe: nga “kallos” në “fallos”. Dhe më zuri paniku. Ndihesha e pambrojtur.

- “Kallosi” lidhet, afërmendsh, me përjetimet e thella. Arti është “kallos”, siç është edhe “eros”, mëpastaj këto të dyja bëhen “thanatos”. Pra: bukuri, mirësi, dashuri dhe vdekje. Dashuria ka tri të parat, kurse arti merr edhe të fundit. Sepse arti është lindje dhe vdekje njëkohësisht, “eros” dhe “thanatos”. E di ç’ka thënë Niçja për “thanatosin”?

Unë e kisha qepur me kohë. Rrija e ngrirë në sediljen e makinës. Një frikë e pashpjegueshme po më pushtonte të tërën. Doja sa më parë të mbërrija në shtëpi... Më në fund arritëm në sheshin pranë saj.

- Ju faleminderit, - i thashë dhe bëra të hap derën e makinës.

- Jo, jo... rrini pak... ja... sa ta parkoj...

Ai u kapërdi prapë.

- S’ka nevojë, natën e mirë! - nxitova unë dhe bëra të hap sërish derën.

- Prit pak!

- Ju lutem!

Por tashmë ai kishte vënë dorën mbi dorën time. Errësira ishte e plotë. Pallati flinte. Befas Besimi më kapi fort nga qafa dhe me një lëvizje të rreptë më tërhoqi nga vetja. Unë rashë mbi trupin e tij.

- Ç’bën kështu?!?!...

Dy buzë që digjeshin nga zjarrmia ma përcëlluan gojën. Ma mbyllën si me kapak. Kaq papritur. Kaq befasisht. Ishte një temperaturë e prodhuar nga mishi. Kishte pabesi ajo puthje. Zjarrmi. Dhe neps. Shumë neps.

Ku je, Gjergj?! Pse s’vjen? Eja, eja të lutem!

Ai po më shtrëngonte fort në krahët e tij. Si darë ato duar. Kërkonte me ngulm buzët e mia. Më puthte në gushë. Në faqe. Fërgëllonte. Dridhej. Bleta, bleta, me thithën mbi gojzën e lules së hapur. Por vegimi i bletës më zhdukej sakaq nga pesha e trupit të tij. Uf, kjo

shtypje! Kjo këmbë mes kofshëve të mia! Isha e rrasur në sedilje. S'lëvizja dot. Dora e tij më kishte kapur gjinjtë. Po m'i shtrydhte. Pastaj dora tjetër, o Zot, zbriti epshëm nën bark. Rrekej më poshtë. Te pubisi. Dhe e preku. E shtypi. E kafshoi.

Uf, Gjergj, ky po më mbyt, ky po më shqyen, ku je? Eja, pra! Ç'më rri atje, tek ai ujëmbledhësi yt idiot?! Eja më shpëto nëse më do. Tani. Eja! Ky po më ha. M'i shqeu buzët...

Më në fund buzët tona u shqitën. Ai dihaste.

- S'ke turp, i poshtër! - i thashë. Por duart i ndieja akoma të mbërthyera, s'di se nga.

- Të dua, Flora, të dashuroj... Ti nuk e di, por kam kaq kohë që... dhe të dashuroj... çmendurisht... Zana, të ka folur për mua apo jo?... Mos më refuzo... zzzzzooooo...

Bëja të çlirohesha prej shtrëngimit të duarve të tij, por, o Zot, ishte e pamundur. Ai kapi dorezën e sediljes poshtë dhe ajo u shty nga pas. Menjëherë ai u ngjesh pas meje dhe me një forcë të përbindshme, me dy këmbët e tij prej guri hyri sakaq mes këmbëve të mia, m'i hapi krejt. U ndjeva e zbuluar, si e hapur dysh. Ai m'u hodh përsipër, po m'i shtrëngonte gjinjtë dhe po m'i thithte buzët, gati po m'i gjakoste. Uf, më mori frymën, i poshtri! Ik, pra, s'dua! Lërmë, ore, se do bërtas, do bëj skandal! Uf! S'po flisja dot. E kisha të gjithin mbi vete. Më përdorte dhe figura, pale! Infinite, hieroglifë, thanatose...

- Ej-ej, unë s'jam një Ofeli, as ti një sër Laurenc, Hamlet, Moisi, Besim kurvari, që të më shtypësh me trupin tënd?! Çmendurisht. Egërsisht. Pabesisht. Hiqe këmbën këtej, hiqe të them! Hiqi buzët!

- Flora... Flllll...ffff...oraaa... Po prit, moj...

Fryma e tij e nxehtë më përplasej në fytyrë. Digjte. Gjithë genia e tij digjte. Afsh si prej kaldaje. Dora ngulmonte me tërbim poshtëbarkun tim. Mbathjet m'i kishte grisur. Jo një, por pesë

gishta-thithash nguleshin, zhbirilonin, gjakonin aty, nën “petalin” tim të shqyer. Dhe në sy m’u rishfaq bleta. Zhuzhiste përpara syve të mi, buzëve të mia, nënbarkut tim, me thithën e zgjatur. Zhzhzhzhzhzh... Dhe më thumbonte... zhzhzhzhzhzh...

Grerëza...

Po, po, kjo s’është bletë, Gjergj, por grerëz. Grerëz e verdhë me thumbin e hidhur gati për të ma ngulur. Njësoj si ai tjetri që të shkroi “letrën anonime”, por kësaj radhe në celular, një SMS, teknikë moderne, s’ke ç’i thua. Ndonjë matuf a sozi nga ata tipat e njëhershëm të Enverit, por më të rafinuar, që rrinë gjithë ditën dhe çatojnë në kompjuter, dërgojnë mesazhe, montojnë foto. Mutacionet sociale të kohës së re. Dhe ti i beson?!...

S’kuptova sesi, por dora më preku në timon, ku ishte boria e makinës. Dhe ndjeva një hop sesi krah u lirua ca. E mbaja shtypur borinë dhe ajo binte e binte në mesnatë. Besimi sikur e mblodhi veten. Madje u tremb. Mos ndoshta aty afër qe policia dhe ia behte në çast. Ai u anua nga vendi i vet, por dorën s’ma hiqte nga mbathjet. U ndjeva e lirë. Mblodha gjithë dufin dhe e qëllova fort me shuplakë në fytyrë me sa fuqi që kisha.

- Flora... mos... tëëëë... tttt... ufffttt... thththth...

S’di sesi e shtyva derën dhe u gjenda jashtë makinës. Po vrapoja ashtu kot, kuturu, asfaltit që lëshonte avull prej ngrohtësisë së natës. Diku u ngjita shkallëve me shpejtësi dhe hyra pikërisht në apartamentin tim. Të gjithë flinin. Sa turp më vinte! Po sa... sa... e revoltuar që isha.

- Mama, si guxonte ky njeri të më prekte dhe... dhe... të më puthte... Shkoi gjer aty sa... Dhe përfytyroi gishtat e tij poshtë barkut të saj. - Vuri instinktivisht dorën aty dhe... O Zot, mbathjet qenë të grisura... Vendi i dhembte. - Uuuuu, mami, çfarë turpi?! A të shkonte në mendje që një artist, njeri i rafinuar, mes femrave, të... të griste... mbathjet?!... Dukej dhe aq i sjellshëm, pale?!

Aq korrekt?! Protokollari?! Infiniti?! Delikati?! Etiologjia-antropologjia-psikopatia... Pupu, tmerr!

Ah, Gjergj, pse nuk ishte atje që t'i këpusje një grusht? T'ia thyje turinjtë.

Mendimet më vërtiteshin si shtjella marramendëse dhe kafka e kokës më dukej si e tejmbushur cep më cep, gati të plaste. Nuk e mbaj mend, por vonë shumë duhet të ketë qenë kur dëgjova ndezjen e një makine poshtë pallatit dhe largimin e saj rënkues nëpër natë. Ç'njeri që ishte?! E pabesueshme! E ç'më duhej mua arti i tij, dashuria e tij?! Se ishte artist, e pastaj çfarë? Paska të drejtë të më puthë? Të më shtrëngojë gjirin? Të zbresë deri aty ku veç Gjergji mund të... Pupu, unë vërtet jam budallaqe. Idiote. Mirë më thotë Emi: "Ti Flora je 'fri' me çunat, do ta hash ndonjëherë". Çfarë "fri", moj, unë jam idiote, po të them, idiote, idiote, idiote... Jam "kallos"...

... E gjithë nata shkoi si makth. Nuk mbylla sy. Qava heshturazi që motrat mos të më dëgjonin. Por dënesat shpesh ma shqyenin grykën dhe dilnin jashtë. "E ke vetë fajin, e ke vetë fajin, e ke vetë fajin...", më buçiste në kokë.

... Gjergj, ti tani të më shikoje, jo atë të "hënë" buzë liqenit, atje tek ajo tufë akaciesh. Tani të ma përplasje derën turinjve e të ma copëtoje krahun. Unë e kisha shok Lirimin, shok të vjetër, pse ta fsheh? Ne dikur edhe jemi da... Po, po, s'mund të them se s'jemi dashuruar. Por ishte vetëm një sprovëz e pafajshme dashurie, e cila kurrë s'u kthye dot në diçka të thellë, të madhe, të pazëvendësueshme. Një mbresë e bukur, kupton? Diçka ëndërrore. Studentore. Mbeti aty. Dhe ca puthje. Doemos ai ishte ftuesi i parë dhe i vetëm në cipën time vaginale, më bëri "grua". Kaq. Edhe ti ke provuar ndjenja të tilla në atë moshë. Edhe ti diku, mbi trupin e ndonjë femre, je bërë "burrë" për së pari, apo jo? S'të kam pyetur ndonjëherë. Mos është "e

pistë” kjo Gjergj? Jo. E pistë është një rrasje në sediljen e makinës befasisht, kafshërisht, me gjurin mes kofshëve, duke vrarë mirëbesimin tënd. I pistë është ai, Besimi, jo Lirimi. Unë s’mund ta mohoj që Lirimin e kam dashur. Por koha ka rrjedhur, na ka ndryshuar. Dhe prapë, nëse me Lirimin do të takohem, tashmë do të jem unë ajo që do ta ftoj të pimë një birrë në lulishten “Streha” dhe të shëtisim buzë liqenit. Liqeni nuk është vetëm “certifikata” e të dashuruarve, Gjergj! Jo. Edhe dy miq mund të shëtisin atje, pse jo. Eja dhe ti dhe të bëhemi tre. Dhe atëherë ti do ta shikosh vetë se sa i mirë është Lirimi. Një shok i vërtetë. Ti i besove një shpifjeje, Gjergj. Një dinaku, smirëziu dhe matufi që të çon mesazhe mbushur me montazhe fotosh pornografike me fytyrën time dhe që gëzohet kur lëndon e prish një dashuri. Por mua, këta tipa të shpifur, që s’kanë guxim të dalin hapur, më neveriten. Perversitetin e tij as që dua ta llogaris, por thjesht më vjen keq pse të ta lëndoj ty zemrën kështu. Këta janë njësoj, një surrat kanë, përdhunues: të rrasin në sedilje makinash ose sajojnë montazhe fotosh të ndyra. Si ashtu, si kështu, ata prapë po atë punë bëjnë: të përdhunojnë. Por ai që pështyn tjetrin, pështyma do t’i kthehet surratit një ditë. S’jam fajtorë unë se shumë djem më kanë propozuar para teje. As pse i kam refuzuar. Bukurinë që më ka falur nëna, unë s’jam aq budallaqe që mos ta kuptoj si diçka që ngjall zili të “dikush”. Pse i beson këtij “dikush”? Pse u beson intrigantëve dhe mesazheve të tyre mbushur plot smirë, Gjergj? Pse s’më beson mua?! Ti je kaq i mirë! Ti më kupton. Më beson. Më beso, pra! Unë jam e pastër. S’të kam tradhtuar asnjëherë. E, megjithatë, edhe ti atë të “hënë” fole me figura. E ç’na duhen figurat ne të dyve?! Na mjafton, sa një shekull, njëri-tjetri. Pse më mërzit kështu, Gjergj? Uffff... sa më dhemb koka!!!...

... Hapat e Besimit ndiqnin hapat e mi, pastaj ata u ngadalësuan, u rralluan, derisa humbën në zhurmat e mëngjesit. Kur dola nga leksioni i fundit, ai prapë u mat të më ndalonte te dera e fakultetit. Disa ditë kështu. Ai ngulmonte. I binte celularit, shkruante mesazhe: “Më prano që të sqarohemi!”. Përse vallë ngulmonte kaq fort? Vërtet kishte diçka serioze për të më thënë apo ishte thjesht një truk të refuzuarish sedërthyer, me shpresën se sa më fort e sa më gjatë të trokasësh në portën e tjetrit, aq më lehtë ajo do të hapet. Këmbëngulja, përpos inatit, ka brenda edhe dashurinë, thuhet. Në një rast tjetër edhe mund të kisha ndaluar, por buzët më digjnin nga e puthura e tij tinëzare. E kisha ende në gojë pështymën e tij, frymën, shijen e gjuhës. Sidomos paturpësinë për të prekur fundbarkun tim.

Se ku e kishte gjetur *e-mail*-in tim dhe me një adresë të fshehur më dërgonte mesazhe të stërgjata ku shpjegonte se i vinte aq keq që “s’ishin kuptuar”, se “keqkuptimet ishin si dezertimet”; ato na paskan rrënuar muret e kështjellave, perandoritë, fetë e mëdha, doktrinat dhe jo më dritaret prej qelqi të dashurisë... Dhe plot e plot figura kësilloji. O Zot, sa qejf i kishte figurat ky njeri! Madje, atë të puthur prej hajduti ai e quante thjesht një “dialog konvencional”, “metafora e zanafillës së dashurisë”, një “hap i detyrueshëm prej ushtari” për të shkuar më tutje, në qoftë se dashurinë do ta quanim “gjeneralin e saj”; se njerëzit sot janë të “emancipuar, të lirë”, jo aq të ngurtë, aq... aq...

“Se, në fund të fundit, - shkruante ai, - s’ishin më vitet e ngurta të diktaturës! Pse duhej alarmuar kaq shumë, irrituar kaq shumë?! E ç’u bë?! Çdo gjë që ngjau midis nesh ishte e natyrshme, Flora, e logjikshme. Ndoshta u nxitova pak, por fundja, njeri me gjak jam, mashkull jam, s’jam eunuk... S’ma priste mendja që një studente frëngjishteje, aq më shumë

tiranase, të ishte kaq e mbyllur... si ‘kanarina në kafaz’... Unë s’jam një Arnolf që ndërtoj kafaze hekuri për femra shtëpie, dreqi e mori, as një Alcest mizantrop që i trembem femrës mendjehapur. Unë s’kam frikë nga dashuria. Dashuria s’mund të jetë një guaskë që merret ngado me vete, si kërmilli dembel dhe besnik i vetvetes. Guaska e dashurisë s’ka porta, ashtu si edhe qielli s’ka; ajo s’mund të jetë veçse besnike sa e vetvetes, aq edhe e tjetrit. Pa gishtat e dorës a lëshojnë tinguj vrimat e flautit?! Dashuria është si rubini i fshehur mes kapakëve të guaskës. Aty gjendet. Guaska hapet me qëllim që rubini të ndritë. Rubini i mbyllur në guaskë s’është as për vete, as për tjetrin. Vetëm ‘tjetri’ ia çmon dritën dhe bukurinë...”

Dhe vazhdonte një gjysmë faqe tjetër me “guaskën” dhe “rubinin”. Pastaj befasisht më drejtohej me ti, intimisht, si në një ritual shtrati, duke e mbyllur në fund me një përfalje klasike...

“... Unë kështu e kuptoj, Flora. Prandaj dhe të dua, sepse ti je një vajzë e kohës, e shpenguar, e veshur plot sqimë. Unë të kërkoj të falur nëse të kam lënduar. Një çast padurimi qe, quaje edhe epsh, por të betohem, do desha të isha një gur rubini në guaskën tënde. S’është thjesht një metaforë, të lutem më kupto! Bukuria jote është tronditëse për mua! Nuk e duroj dot rëndomtësinë, as fjalët dhe fytyrat pa ngjyrë. Le të jemi, pra, pa ‘porta’ me njëri-tjetrin... *Open*... Do të më vinte keq në qoftë se letërsia frënge, ku ti studion, të anashkalohej në vetë thelbin e saj: te dashuria...”

Letrat e tij qenë tmerrësisht të gjata. Tmerrësisht letrareske. Tmerrësisht të lodhshme. Tmerrësisht idiote. Dhe shumë prepotente. Apo kështu më dukeshin mua?! Tani çdo fjalë e tij më ngjallte veçse krupë. Vetëbesimi dhe mendjemadhësia e tij të lodhnin.

... Të shtunën erdhi Gjergji. Ne u përqafluam dhe u puthëm me mall. Kuptohet, guaska ime u çel vetiu sepse rubini kishte shumë dritë brenda tij.

- Shkojmë në film, luan Besimi, idhulli yt!

- Shkojmë diku tjetër, u shmanga unë, s'kam qejf sot.

... Në reklamat e kinemave të qytetit ishte afishuar fytyra e Besimit në një film të ri. Ajo të buzëqeshte ngado, nëpër mure, stenda, shtylla, vitrina, xhama shitoresh, trungje pemësh, fasada. Por mua, sesi më dukej e qeshura e tij. Një shqyerje buzësh... “Sa film i bukur!”, thoshin ata që dilnin nga kinemaja. “Ç’artist ai Besimi?!” Ndërsa mua s’më bëhej ta shikoja. Kisha një si pështjellim në stomak. Neveri.

- Shkojmë! - këmbënguli Gjergji.

Ndjeva një ngushtim në gjoks. Përse ai njeri ushtronte një ndikim të tillë edhe te Gjergji im? Kush ishte? Me ç’të drejtë? Pse ndërhynte vrazhdë në intimitetin tim? Më vinte aq inat. Ai e kishte vendin atje, tek ajo beze e bardhë që quhej ekran kinemaje, jo këtu, tek unë. Te ne...

- Hë, pra?

- Jo! - ia ktheva nervoze.

Gjergji u hutua disi. Futi faqet në gropëza dhe fjala iu shurdhua nën qiellzë.

- Të paska mbetur qejfi... - mbushi sytë me dashuri ai.

M’u kujtua rishtazi e “hëna”, fytyra e vrenjtur e Gjergjit dhe ato fjalët e panatyrshme me “bletë” dhe “polen”.

- Mirë, shkojmë ku ke qejf ti, - më shtrëngoi lehtë nga beli ai, pikërisht aty ku ende ndieja dorën e Besimit, e cila dukej sikur rrekej të zbriste me ngulm në masën e mishtë të vitheve... Edhe më poshtë... te ajo materie e butë, shurdhace, e pambrojtur, si e lëngët...

- Eja, - i thashë unë.

Hymë në kinema. Në mes të njerëzve, papritur, ndesha sytë e Besimit. Nuk besoj se ishte rastësi. Ai më kishte ndjekur. S'di sesi, por ai s'kishte hequr dorë prej meje. Edhe këtu s'më lë rehat, o njeri?

Rishtazi sikur ndjeva pranë zhuzhimën e grerëzës së verdhë në sediljen e “Benz”-it luksoz, puthjen e beftë në terr që përcëllonte, dorën që ngulmonte poshtë barkut, fjalët e palidhura të tij, “klithmat dantiane”, “infinitin e shpirtit”, “dialogun konvencional” dhe dër-dër-dër, pastaj “guaskën e kërmillit”, “sakralitetin e aktit seksual si pafajësi kozmike”, “rubinin vezullues” dhe prapë dër-dër-dër... Më në fund mbathjet e grisura... Ah, sa inat më vintel!

U ulëm me Gjergjin në vendet tona. Megjithëqë nuk e kisha përballë, gjithsesi vështtrimin e tij të ngulur pas shpinës sime e ndieja. Ishte si bryma. Po më dridheshin duart. Ai vështtrim kishte diçka më shumë se pyetja, më tepër se xhelozia. “Ti më paske ndërruar mua me këtë katundar, me këtë korrozi, me këtë veshllapush e syptull?!...” Habia kishte mbetur në fytyrën e tij si ato hartat e zhubravitura, gjersa u fikën dritat dhe filloi filmi. Portreti i tij në rolin e heroit rilindës zmadhohej në ekranin e bardhë, sulej e gllabëronte gjithë sallën. Sytë e kaltër, të stërzmadhuar kësisoji nga lentet e projektimit, nguliteshin në mendimet e mia si shtiza hekuri, shponin si turjelë. Ja dhe skena e vrasjes së tij tek po shpëtonte të dashurën. Ja dhe gurrëza e burimit, uji që skuqej nga gjaku. Paçka se ai vështtrim i fundit djaloshar qe krejt i mbushur me mallin e dashurisë e sikur po i pikonte qerpikëve, mua përkundrazi më ngjante prore si një kurth. Një maskë. Një dredhi. S'mund të shastisesha kurrsesi prej atyre syve, ashtu si shastiseshin të tjerët. Jo më! Uji, madje, nuk skuqej, por nxihej. Turp ta them, por sikur e desha “vdekjen” e tij në film, sikur dikush po merrte hak për mua ose unë vetë po hakmerresha kundër tij. S'di pse zëri i Besimit më buçiste në kokë, më shponte veshët. Buzët e trasha tek i flisnin të dashurës sikur po më thithnin

mua. Ato zgjateshin si tentakulat dhe unë, pa dashur, vija pëllëmbën e dorës për t'u mbrojtur. Më keq e kisha me dhëmbët e tij të bardhë. Ata sikur po më kafshonin, po ma gërryenin e po ma shqyenin kafkën. Më shumë nga të gjitha më stërmundonte shtirja e tij e maskuar aq mirë. Ndieja se si ai njeri tek po vdiste i kishte zaptuar të gjitha zemrat e njerëzve në sallë. Dhe njerëzit, budallenjtë, të mashtruarit, idiotët, ishin shkrirë pas rolit të tij. O Zot, ata po qanin! Shikojini, mor aman, se si janë molisur nga mallëngjimi?! Janë bërë mu si minj! Dhe janë mallëngjyer që të gjithë si të ishin kope. Lot e qurra. Njësoj si në një epidemi. Gjithë kjo tufë budallenjsh të zgërlaqet kështu?! Dhe psherëtijnë, dhe shkrihen në vajtimin e ëmbël estetik të artit. Po për kë, të lutem?! “Zhaba”, shfryja unë. “Zhaba të ngurtësuar nga vështrimi i kobrës, ja ç’jeni ju! Kuakni zhaba: kuak-kuak!” Gjithë ai dekor fytyrash më ngjante prore si një maskë e stërmadhe me sy të hutuar, të veshur nga cipa e adhurimit si në një seancë hipnotizimi a riti sektesh religjioze e meshash të zeza. Vetëflijimi i tij, i shenjtëruar nga arti, shndërrohej në “katarsis” për gjithë këta shpirtra të sëmurë, që lëngonin nga pendesat e tyre të fshehta ende të pashpallura! Qani, budallenj, qani: kuak-kuak! Ja ku e keni priftin tuaj në ekran, shenjtorin tuaj të zi, futeni kokën nën zhgunin e tij, puthjani mjekrën!... Sesi m’u kujtua që aktorët në teatrin antik grek quheshin “hipokrites”. Pra, mashtrues. Ej-ej, njerëz, ai atje, në ekran, s’është djaloshi që ju e dashuroni, por një mashtrues. Një hipokrit. Ai po ju gënjen haptazi, a s’e ndieni vallë? Ej, ju, kuak-kuakër, sa më bukur që e luan rolin, idhulli juaj, aq më shumë ju mashtron. Zgjohuni, budallenj, naivë! Mos u përmallni me fjalët e tij, mos u përlotni! Ç’bëni kështu? Ai është thjesht... një gënjeshtar... Zgjohuni, idiotë! Zgjohuni, kuak-kuakër!...

Desha të bërtisja sa më hante gurmazi, por njerëzit vazhdonin të ndiqnin plot mallëngjim filmin me sytë e përthithur nga ekrani. Tinëzisht Besimi po hidhte kundër meje “poemën e dashurisë”.

Dhe “poema” e tij ishte vërtet si qielli, ashtu e hapur, e kthjellët, e kaltër, e paanë... pa porta... Në mes të atij qielli, shkëlqente dielli: vetëflijimi i tij për të shpëtuar të dashurën. Një rubin i vërtetë, pa hile, lëbyrur krejt në dritë e rrëzëllim. Ej, njerëz, mos u mashtroni më! Mjaft! “Poema” s’është aspak ai, por Gjergji im, ky këtu, me ju. Besimi është vetëm aktori, asgjë më shumë, kuptoni? Është “hipokritesi”. Një zhabë, një kuak-kuakër. Mos i besoni, ju lutem! Mos i beso, Gjergj! Të paktën ti, jo. Ti s’e njeh atë. Ai të mashtron. Të fut dorën... Siiii? Edhe ti po qan? Edhe sytë e tu po rrjedhin lot prej atij palaçoje atje në ekran?! Edhe ty të paska kënduar një kuak-kuak?! Oh, jo! Zgjohu, Gjergj! Ai është një maskara. Të kap natën te shkalla në errësirë me atë dorën e tij... dhe të shqyen mbathjet... Ti je tjetër. Ti je qielli im, rubini im! Zgjohu! Mos nxirr lot për atë kloun prej bezeje të bardhë, mos u zgërlaq kështu...

Sapo dolëm nga kinemaja, Gjergji më shtrëngoi në krahët e tij çuditërisht ndryshe. Shumë dashuri kishte në gjithë qenien e tij, por edhe njëfarë pendese. Apo dhimbje. Apo s’di çfarë?!

- Bëmë mirë që e pamë, Flora. Ishte një film që të mëson, të bën të kuptosh se jeta s’është aq e thjeshtë, se heshtja është guaska e pendesës, kurse pendesa është si vjeshta, e maturon dashurinë; ajo nuk e vret, përkundrazi e mbron. Vetëm urrejtja e vret dashurinë...

Dhe më fliste e më fliste butësisht rrëzë veshit.

Mua më vinte aq mirë që ai tërthorazi po më kërkonte të falur, kishte gjetur një referencë ideale fati i personazhit të Besimit në film. Por unë plasja nga inati pse pikërisht referenca e tij duhej të ishte e lidhur me rolin e Besimit. Pse, dreqi ta hajë, pse? Gjergji dukej i emocionuar. “Sa film i bukur, ë? Ç’artist i madh ai Besimi? Sa i singertë?! Dhe kaq i ri...” Kurse mua më bëhej të bërtisja: “Jo, jo, ai është një zero me xhufkë, një hiç. Një hipokrit, ja ç’është ai, më kupton? Një plehrë, një kuak-kuak...”

Dhe desha t'i tregoja për episodin tonë, për atë "film" të ndyrë që Besimi deshi ta xhironte atje, te sedilja e makinës, në errësirë. Por prania e syve të tij, që diku pas meje nguleshin si gozhdë, më tërbonte. Të gjithë njerëzit, teksa dilnin nga kinemaja, sytë i kishin ngulur tek ai. Një lumë sysh përkëdhelës. Sidomos vështrimet lajkatare të femrave të bukura. Fytyra e tij vetëm qeshte. Buzët i shpërvileshin ritmikuist. Përshëndeste me kokë. Dikush i zgjaste ndonjë letër a kartolinë për autograf, kurse ai bënte ca gjeste modestie, vetësigurie. Gufatja e Besimit m'u bë e padurueshme. "Një zhabë gushëfryrë, ja kush ishte ai", vazhdoja të shaja me vete unë. E ndjeva rishtazi shikimin e tij. Qe një shikim rrëshqitës. Qe sfida, dorashka e duelit, britma e krenarisë, perdja laramane për të mbuluar të puthurën djegëse atje, në sediljen e "Benz"-it, ku i isha ulur në mirëbesim. Qe kuak-kuaku i batakut të tij për ta shitur, gjithsesi, vulgaritetin e vet teksa më griste mbathjet, si kinse dashuri. E ç'më duhet mua dashuria jote, shikimi yt, pozat e tua, o i zi?! Sa qesharak që bëhesh! As dua t'ia di për "madhështinë" tënde. Po, dakord, ti triumfove, por në film ama, mbi një copë beze, jo mbi lëkurën time, jo në trupin tim, jo.

- Po apo jo? - më tundi krahun Gjergji.

- Çfarë? - ia ktheva unë e hutuar.

- Ajo skena në park, thashë, kur ai i fliste asaj për dashurinë, ndërsa pranë supeve të tyre nga sipër binte ajo gjethja e artë e vjeshtës lëbyrur krejt nga drita e diellit. Gjethja e fatit, ndoshta e përdëllimit, apo jo? Sa regji e bukur, ë?

- Cila skenë? - u nëpërmenda unë.

- Ç'ke kështu, Flora?

- Hiç.

- Të pëlqeu filmi?

- Asfare... një... një... kot...

Gjergji kapsalliti sytë. Por pastaj qeshi. Ne ishim gjendur diku në rrugë të hapur. Pas na ndiqte syri hetues, meditues dhe xheloz i Besimit. Fytyra e tij tashmë kishte marrë një shprehje të hapur përçmimi: “Aha, ja kush na paska qenë! Ai... syfryri... veshllapushi yt?!...”. Po, o Besim “Infiniti”, ky është Gjergji im, Princi im i Kaltër, e more vesh tani? Ky është “kallosi” im. Nuk po të marr vesh ç’kërkon më akoma prej meje? A s’e kupton se po bëhesh gjithnjë e më i bezdisur? Ç’drejin ke që futesh si hajduti te ne, nëpërmjet një ekrani të madh me beze të bardhë?! Ik, pra, o Besim “lemeritësi”, lërmë të qetë, mos ma pre rrugën, shko atje në celuloidin tënd, vdis aty si hero a ku të duash. Qofsh ti një gjeni, një “infinit”, a “klithëm dantiane”, qofsh një “stil absolut” a një “metaforë këlthitëse”, unë s’të shoh dot. Ik! Të lutem, mos ma prish gëzimin! Kam Gjergjin tim. Dhe ai s’ka shumë kohë siç ke ti. I duhet të shkojë në ujësjellësin e tij idiot dhe veç të premten tjetër do të takohemi sërish. Shiko rrugën dhe mos e kthe më kokën pas! Troç, jam e dashuruar, s’e kupton dot kaq gjë? Merru me “vetëflijimet” e tua, me “humnerat” dhe “hieroglifët”, me kërmijtë e tu. Dashuria është ky njeri që kam pranë, paçka se jo i bukur si ti, paçka se një këmbë e hedh disi shtrembër, qoftë dhe “veshllapush” si ke qejf ta quash ti e me qeskat e fryra poshtë syve. Ani! Ky njeri quhet Gjergj, është “poema ime”, rubini im. Ndaj, të lutem, mos ma ndyj dashurinë. Shko, gjej guaskën tënde!

... Besimi po vinte drejt nesh. Një tmerr më zuri. Si guxonte ky njeri? Si? Dhe një pështjellim m’u fut në bark, sikur m’u rrotullua bota. Vrapova në një lokal bri nesh, hyra rrëmbimthi në banjë dhe volla. Volla... Trupi më shkundej dhe spazmat s’më pushonin. Pastaj ndjeva dorën e Gjergjit mbi ballë. Kisha djersitur.

- Ç’ke, Flora?

- Asgjë, kaloi...

E shtrëngova Gjergjin fort në krahë. U mbështeta dhe u ndjeva çuditërisht e mbrojtur, e qetë... Nuk e di pse më lindi dëshira t'i rrasesha atij nëpër trup, të bëhesha njësh, të më puthte menjëherë, aty në lokal, mes njerëzve dhe të gjendesha nën peshën e trupit të tij. Dhe ai të depërtonte thellë meje, sa më thellë, në guaskën time, mes dallgësh dhe shqotash. Aty le të prehej e të ndriste. Sepse aty isha unë. Ishim ne të dy. Vetëm ne, askush tjetër...

- Eja!

Dhe e tërhoqa me ngulm drejt pemëve të liqenit, sado që ishte tepër vonë. Dhe pemët na mbuluan, si dhjetëra të dashuruar, mbi tokën e ngrohtë dhe shtratin e gjetheve të tyre. E desha të tërin. Timin. Pafundësisht. U shtrëngova në trupin e tij, u shkriva krejt. Ishte e gjitha mish e lëng ajo mbrëmje, jo guaskë...

Atë javë, sikur ta ndiente se fryma ime kishte nevojë për frymën e tij, ai e theu lejen dhe qëndroi tek unë, e harroi fare ujësjellësin e tij idiot. Por ujësjellësi, e merrja me mend, s'kishte për t'iu zemëruar. Se mishi kishte nevojë për mishin e "guaska" që thyer e bërë copë e çikë. Prandaj kaluam aq bukur. Lodronim në trupat e njëri-tjetrit, kompozuam mijëra simfoni përkëdheljes, puthjes, shushurimash, orgazmash. Dhe harrova gjithçka. Pastaj ne përsëri u ndamë. Por me një buzëqeshje të madhe në fytyrë. Atë e priste ujësjellësi i tij idiot, kurse unë buzët i ndieja plot me valle nga puthjet, fryma dhe fjalët e tij aq të ëmbla...

- Ah, Gjergj, "poema ime", "infiniti im", "rubini im", sa shumë të dua! Po filmi mua s'më pëlqeu. Për diçka tjetër s'më pëlqeu. S'ishte veçse një ëndërr e keqe, Gjergj! Një "guaskë" pa mish brenda...

NON SON' DEGNO DI TE

- Pa hape dhe një herë, o djalë, ta shoh prapë!

Unë klikova në *Youtube* te emri Giani Morandi dhe i dhashë “play” këngës “Non son’ degno di te” (Nuk jam i denjë për ty). Këngëtari i njohur italian i viteve ’60 këndonte diku poshtë një shtëpie, ndërsa një vajzë tejet e prekur e shihte lart nga dritarja. Në zërin e Morandit ndihej pendesa, ndërsa vajza lotonte. Pastaj ai largohej i dëshpëruar. E dëshpëruar edhe vajza pas xhamave të dritares së mbyllur. Pika shiu në xhama, pika loti në sytë e vajzës. Një dashuri e parealizuar. Një aht...

- Ta vë dhe një herë?

- Vure!

Dhe kur kënga mbaroi për të katërtën herë, si thithi fort cigaren nga ato më të lirat, mësuesi plak vazhdoi:

- Eh, isha i ri atëherë, o çun! Njeriu ka shumë dashuri, siç është bërë në pjesë e inde edhe trupi i tij, por njëra, mbase, buçkon më tepër në mish e në frymë.

- E para, - nënqesha unë.

- Ose e fundit, - ma priti aty për aty mësuesi plak, duke më dhënë të kuptuar që mos ta ndërprisja. - Dashuritë s'i bëjnë hije njëra-tjetrës. Shikoje qiellin, - dhe ngriti kokën e zbardhur lart, - mizëri yjesh ka aty, por gjithkush me dritën e vet, në vendin e vet. Njësoj edhe lulet, të bukura në llojin e vet, në ngjyrën e vet. I thua dot manushaqes se s'është e bukur sa krizantema, sa karafili, sa luledelja, sa trëndafili? Jo, o çun, se Perëndia ato i ka bërë shumë, për të qenë secila më vete. Si dhe femrat. Së bashku, lule e femra, bëjnë parajsën, atë që ka krijuar Zoti.

- E kush është parajsa?

- Dashuria është parajsa. Femra është parajsa. Ndaj dhe e kujtoj përherë atë vajzë e mendja më mbetet veç aty. Si të ta them?! Iku ajo, iku dhe parajsa.

- Dhe kur s'ka parajsë, ka ferr.

- Ferr dhe jeta ime, o çun!...

Dhe mësuesi plak u zymtua. Unë e lashë ironinë.

- Ti mund ta trembësh bletën, madje edhe t'ia thyesh krahët, por ajo, zvarrë-zvarrë, do të shkojë te kosherja e vet, - rinisi ai si të fliste me vete, - dhe aty do ta derdhë nektarin e mbledhur mes dhimbjesh e stërmundimesh. Se pa atë nektar, ajo vdes. Është shkronjë e qiellit. Ti mund ta plagosësh ketrin, por ai zvarrë-zvarrë do të shkojë aty, në strofkën e vet, e ketrushia do t'ia lëpijë plagën derisa ai të japë shpirt. Pëllumbit, po i ngordhi pëllumbesha, s'i hyn gjë në sy, thahet e drobitet e për ca ditë ngordh dhe ai. Edhe njeriu si bleta, si ketri e pëllumbi është. Lind i vetëm, një i vetëm, që të bëhet dy, rrënjë e degë. E më pas tre, katër e sa është e thëna, që janë lulet, frutat. Dhe kur ikën, i vetëm ikën. Por këto të tjerat vijnë nga dyshi. Kur s'ka "dysh", s'ka as tresh e asgjë tjetër. Ka ferr e skëterrë, siç the ti, o çun. "Dyshi" iku nga unë. Iku një mëngjes herët...

- "Dyshi" ishte gruaja?

- Unë e kam fjalën për dashurinë...

Dhe mësuesi plak thithi rishtazi cigaren e tij nga ato me çmim të ulët. Fytyra iu hap e gjaku iu përpush nën lëkurë. Një kujtim i largët ia bujti aty sakaq. Sytë e tij u mbushën me lëng.

- Bën mëkat të humbasësh një dashuri, o çun! Dashuria është si ajri, s'ka dritare, as derë, as vrimë, hyn ngado, pa komandë e urdhër, pa rregull e parim, pa moshë e detyrë. E pengon dot ajrin?

- Jo!

- Ajo ishte si ajri, e mirë, syzezë e vetullzezë dhe kishte një buzëqeshje të hapur, pranuese. Ndoshta dy "pullat" e saj në faqe kur qeshte qe kurthi im. Them kurthi, sepse unë kisha rënë në kurthin e saj. Çdokush bie në një kurth. Dashuria vetë është një kurth. Dhe kur bie në kurth, ti përpiqesh t'i shpëtosh, të dalësh prej tij, por është e pamundur. Vetëm dhelprat i shpëtojnë kurthit, sepse kanë më shumë tru, hanë këmbën e tyre ku kanë ngecur, duke mbetur me tri këmbë. Por ajo s'ishte dhelpër, as unë s'isha një skilak. E kundërta, o çun, ajo ishte si sorkadhja që, teksa e gjuajnë, qan e lëshon lot. Mirë e thashë, si sorkadhja. E ke parë sorkadhen kur lëshon lot? S'e ke parë... Eeee, ndihesha mirë me të, isha i paqme, i lumtur. Prania e saj më jepte gëzim.

- Po si ndodhi që re në dashuri? - e pyeti djali.

- Siç u ndodh të gjithëve, ashtu pa e kuptuar... Një itë ajo erdhi në pasdite vonë në kabinetin e fizikës për të pyetur diçka mbi një formulë a logaritëm. Rrinte përballë meje. Kishte veshur një triko gri të ëmbël dhe pantallona të zeza. Zakonisht ajo mbante xhaketë, por trikoja dukej sikur e ngushtonte trupin e saj dhe ia spikaste gjoksin e bukur e të rrumbullt. Sytë e mi një copë herë mbetën aty. Ai gjoks ishte për mua një... ç'të të them, o çun! Aty desha të flija pak e mërzinë e jetës ta mërgoja. Me instinktin e saj ajo e ndiente syrin tim mbushur neps, ndaj dhe i druhej një përqafimi. "Ç'ke, moj, pse më rri ashtu, syri im s'të vret?", i thosha. Kishim kohë që shiheshim, lëshonim fjalë, ngacmoheshim. "Eja pak, - i zgjatja

dorën unë, - eja pra, të lutem, fare pak, nuk të ha!” Ajo puliste sytë dhe buzëqeshte. Nuk lëvizte. Buzëqeshja ishte një e ndërmjetme midis frikës, dhënies me tepri të një shansi që nesër do të kërkonte edhe më shumë, nga njëra anë, dhe tundimit të fshehur për t’u hedhur në krahët e mi, nëse gjithë ujditë e kësaj bote do të ishin rroposur fund e krye, nga ana tjetër. S’m’i hiqte sytë, por veshët i kishte të ngrehur. Edhe unë pipëz i kisha. Ishim të dy pa tru: ajo sorkadhe e unë dre. Klasat e korridorit tonë në katin e tretë qenë zbrazur. S’dëgjohej asnjë hap. Teksa e shihja përballë, me ato dy pullat në faqe duke qeshur lehtë, thuajse më merrej fryma dhe me zor i ujdísja fjalët, mendimet. Atë hop s’kisha më mendim. E si mund të kesh mendim kur je përballë njeriut që e dëshiron?! Ta thashë, s’isha skilak, mashkulli i dhelprës. Isha i fortë, njeri me mish në trup. Unë e shihja gjithë uri dhe ajo më shihte po me atë uri. Ti më dëshiron, por s’më dashuron - nguronte më tutje syri i saj. Edhe frika e atij shikimi të unshëm kështu më thoshte: unë të dëshiroj, por nuk të dashuroj. Qe vajzë qytetare, unë djalë fshatar. Ma kishte thënë dhe një herë tjetër, gjoja si pyetje se ku dallonin në italisht foljet: *ti amo* dhe *ti voglio*. “Të dëshirosh dhe të dashurosh janë binjakë që pinë nga një sisë, - i thosha, - janë sivilëzër, dy farëza në një tul. Ose dy thithat në gjirin e dhisë”, m’u bë t’i thosha, por më erdhi zor, do dukesha një copë fshatar nga dhe isha. Të duash, do të thotë të vuash e të lumturohesh njëkohësisht, duke mëkuar më fort shpirtin, pjesën e ëndërrt dhe të etertë të tij. Përkundrazi, të dëshirosh do të thotë të kënaqesh, të përplotësohesh me atë që s’e ke, por që e kërkon me ngulm te tjetra e pa të cilën s’jeton dot, prandaj dhe kjo ka të bëjë më fort me trupin e lëngjet e tij, me energjinë e çliruar, me drithërimën, me rrëqethjen. Dhe i kapja dorën. Ajo ulte sytë, ndërsa unë gati ia thosha troç: “E gjitha ngjason me një mbjellje, moj Tatjana, ose më mirë me një ndërtim dhe shkatërrim njëherësh”. Jo tamam këto

fjalë, por diçka të tillë po i shpjegoja atë ditë. E dija se njëra pa tjetrën ato s'bënin dot. E para, domethënë dëshira, i jepte bukurinë dhe thellësinë e shpirtit të dytës, kurse e dyta, domethënë dashuria, i jepte vrullin, ngrohtësinë, kënaqësinë dhe energjinë të parës. Mund t'i quaje ndryshe: shpirti dhe lënda. “Zoti vetë a s'ishte i tillë?” - vazhdoja t'i dërdëllisja unë. Ajo bënte ta largonte dorën, por unë s'ia lëshoja. Në fakt, edhe ajo bënte sikur e largonte. Më kishte rënë një dalldi në kokë për t'i thënë se Zoti e kishte krijuar lëndën e verbër për të konfirmuar vetveten, moj Tana-Tatjana, atë që as ai vetë s'e dinte se ç'ishte. Më pas i kishte dhënë sy, domethënë shpirt. Fillimisht e kishte bërë si trup kafshe, prandaj kafshët kishin vetëm dëshirë jo dashuri. Pastaj lëndën e kishte bërë si trup njeriu, prandaj njeriu kishte njëherazi edhe dëshirën e kafshës, edhe dashurinë e Zotit. Ajo qeshte gjithnjë lehtë dhe dy pullat në faqe të bënin që t'i hidheshe e ta rrokje në qafë. Të venin në djall Zoti, kafsha dhe njeriu! Dhe unë s'pyeta më, i lashë dërdëllitjet dhe iu hodha... E puthja fort si i çmendur, ia bëja gjak buzët dhe gjuhën. Kisha fuqi. Djalë fshati. Ndoshta prandaj Zoti e kishte bërë të ngratin njeri të ngatërruar si puna ime, për ta kthyer në shëmbëlltyrë të tij, domethënë për të luajtur me vetveten, për t'u përmalluar e për të qeshur me vetveten, mbase edhe për t'u tallur e për t'i nxjerrë gjuhën po vetvetes, domethënë krijesës së tij si puna ime. “Se shëmbëlltyra pasqyrë është, moj Tatjana, nuk është e vërtetë! E vërtetë je ti. Ti dhe unë. Eja, m'i jep buzët, de! Vdiqa, moj!”

Kur ia thosha të gjitha këto në një fjalë të zgjatur, të ngatërruar e si tepër të mërzitshme, ajo vetëm buzëqeshte dhe më thoshte: “Mua më pëlqejnë fjalët e tua, vetëm kaq!”. Dhe unë ia ktheja: “Po të pëlqejnë fjalët e mia, ke pëlqyer shpirtin tim, dhe po pëlqeve shpirtin tim, do të pëlqesh edhe trupin tim”. Dhe kështu po e njëjta histori, unë vonoja enkas pasi mbaroja mësimin, orën e katërt, edhe ajo

vinte enkas “për të zgjidhur ushtrimin” e radhës. Dhe e zgjidhnim atë ushtrim duke u puthur e përqafuar plot mall, epsi ynë derdhej shpejt e me frikë. Edhe asaj dite u bëra gati ta përqafoja, ta fusja në krahët e mi, ta tresja në gjak, në limfë dhe ta puthja, ta puthja, aq sa dielli të shuhej. Kishte disa ditë që s’kishte ardhur. Unë e ndieja se ajo donte të puthej nga unë ose së paku ajo të më puthte mua. Veshngritur që të dy, përgjonim zhurmat. Se mbi të, si mbi çdo vajzë gjimnazi, rrinte përsipër një qiell me rregulla, paragjykime, vëzhgime, spiunime.

- Ishte gjimnaziste?

- Po, por e shkollës së natës, se ditën që rrobaqepëse me punë. Në atë kohë shumë vajza vazhdonin studimet në “shkollën e natës”, kështu quhej.

- A kishte frikë se mund të të shikonin?

- Shumë. Koha ishte e ashpër, kishte plot njerëz syshqyer që përgjonin, krijonin opinione, thashetheme, që një Qefserë që ç’të të them!... Pastaj xhelozia shoqesh e femrash, se ajo që shumë e bukur. Qe dhe e fejuar.

- E fejuar?

- Në fakt të fejuarin ia kishin dhënë, nuk e kishte zgjedhur vetë...

- Pse e le atëherë kur e deshe?

- Nuk e lashë, iku.

- Si iku?

... Kur mësuesi ia kishte parë unazën në gisht, e kishte ngacmuar: “Ouuuuu, kur kështu ti?”. Dhe donte t’i thoshte: ku shkoi ai syri yt i bukur, syri yt i pulitur, që rrinte drejt mbi mua e mendjen ma hutonte, më fluturonin ekuacionet dhe formulat, fjalët më ngatërroheshin dhe mësimi më bëhej çorap?! Se më shastiste fare syri i saj, o çun! E dëshiroja me sy, por edhe syri i saj

po të njëjtën gjë bënte. Ajo ndoshta ëndërronte tek unë një Xhani Morandi a një Luçio Batisti, këngëtarët me të dashur të asaj kohe për ne, që të vinin me kitarat e tyre dhe ta nxirrnin nga sikleti duke i falur një qiell me këngë. Një “Non son’ degno di te” të Xhanit. Apo një “Ana” me zërin e dridhur të Luçios. Se Ana e kishte dhe ajo emrin, Tatjana. Po ku të linin Qefseret, o djalë! Edhe atë ditë tersi, kur ajo erdhi lart në katin e tretë, syrin e mbante mbi mua, ndërsa stilolapsin mbi fletore. Sikur kërkonte diçka. Diçka si ftesë. Apo si pendesë. Ose diçka në mes, duke e fluturuar mendjen tutje rëndesës së tokës dhe kodeve të saj. Kishte 36 ditë që s’kishte ardhur. I kisha numëruar një nga një. Më mungonte buza e saj. Gjijnjtë e saj. Kofsha e butë e saj. E vura re, Tana mbante shumë prushe në sy atë ditë. Ëndërronte të hidhej në krahët e mi, të më shtrëngonte fort, kurse unë edhe ca më fort, gjersa brinjët të na thyheshin e gjoksi të na shtypej në dhimbje nga ai shtrëngim trupash, nga ai neps që s’mbahej dot më nga të dy.

“Sa unazë e bukur!”, i thashë unë dhe i kapa dorën. Ajo nuk e hoqi. Sytë i uli poshtë. Mbase fejesa e kishte bërë të zinte inat me veten dhe të vetët. Dhe inatin s’dinte si ta shfrynte veç të më hidhej mua në qafë. Por edhe unë kisha inat. Kisha inat me gjithë Qefseret që të përgjonin kudo, edhe kur shkoje në banjë për të shurruar. Dhe atë minutë më ra një dalldi e desha ta vija përfund. Tani quhej “grua”, mendoja, e kishte provuar mëkatin e ëmbël.

Sa më e bukur unaza, thonë, aq më shpejt del nga gishti!

Dhe e tërhoqa vendosmërisht nga vetja. Ajo nuk kundërshtoi. E pse duhej të kundërshtonte. Ajo donte të binte në krahët e mi e unë t’ia merrja shpirtin me një të puthur, ndërsa fryma të na mbaronte që të dyve. Dhe t’ia ndieja zemrën sesi t’i rrihte e tërbuar. Dhe aromat tona të përziheshin, e pastaj lëngjet, dhe djersa, dhe krejt-krejt lënda të bëhej ajër, frymë, dritë, diç pa peshë, gjethe peme, kërcell i fortë, dhe t’ia nisnim vrapit në erë si të çmendur

dhe dy shpirtrat tanë, ashtu si engjëjt, të silleshin e përsilleshin si Françeska da Rimini me Paolon e saj aty ku mungonte vetë ajri. Dhe në djall të venin Qefseret! Sepse dashuria të lë pa frymë, more çun! Unë e dija se ajo diç të tillë ëndërronte në vetminë dhe paqen e saj, një arrati a ndoshta një hakmarrje ndaj të fejuarit, por mirësia e pengonte. E pengonte ajo që të thashë në kryeherë: Bota. Togu plot qitapë i asaj Bote e pengonte, turpi, ligjet, normat, kodet e vdekura. Arsyeya. E pengonte frika. Qefseret e kudogjendura. Dhe në vend të dëshirës së saj u bëra unë dëshirë. Një dëshirë dhjetëfish më e madhe kësaj here. Njëqindfish. Dhe e putha. Fshatar isha unë, s'dija të puthja mirë. Por atë e putha sa fryma i mbeti. Ia shqeva buzët e gjuhën ia bëra gjak. Se s'ngopesha me frymë vetë. E shtrëngova fort, fort. Dhe atje mbi ato banka të gërvishtura bëra dashuri. Një dashuri të egër si hakmarrje: për atë, për vete, për të gjithë. Nuk shikoja, nuk dëgjoja. Veçse gjakun që rridhte me shpejtësi dhe zemrën që po më dilte nga kraharori. Edhe ajo të njëjtën gjë bëri. Ndukeshim e shqyeshim. Kush e kush të hynte te tjetri si shqotë e tërbim. Ishte vonë. Pastaj trokiti dera. Qenë dy vetë, roja me mësuese Qefseren. Kaq. Qefserja që e pamartuar, lëneshë. Ia pash syrin, e kishte si zhgaba.

“Turp të keni, - ulëriti ajo dhe iu drejtua rojës: - I kapëm në flagrancë, Isuf, dakord?!”

“Po ç'të them unë i ziu, - shoqja Qefsere, - bëri të shmangej roja.”

“Këtë të thuash: i kapëm në flagrancë, kaq!” Dhe nga goja e saj binte erë hudhra, patjetër që kishte ngrënë tarator. Lajmi mori dhenë. Të nesërmen gumëzhinte gjithë shkolla. Qefserja më shihte tërë përbuzje. S'dija ku të fusja kokën. Të pasnesërmen erdhën dhe më rrahën keq. Ishte i fejuari i Tatjanës me nja gjashtë kushërinj të tij. U bëra gjithë plagë. Më shtruan në spital. Më qenë thyer edhe dy brinjë. Mushkërinë e kisha të mbushur me

gjak. Por isha i fortë. Mbërritën pastaj të mitë me kuç e me maç nga Picari i Labërisë. Dhe kërkonin ata që më kishin rrahur mua. Dhe plasi një sherr e shamatë. Babanë e thërritën në organizatën bazë të shkollës, kur u mor vesh se i fejuari e kishte lënë Tatjanën. Qefserja i tha prerë: “Ndreqeni këtë punë, shoku Bekim, shkolla jonë s’e duron dot turpin e djalit tuaj!”. Babai shkoi me një shpurë te familja e Tatjanës dhe e kërkoi për nuse sipas zakonit. Unë dhashë pëlqimin, edhe Tana e dha kokulur. U shërova nga plagët e marra dhe hipur në një kamion kooperative shkua me Tanën të dy në shtëpinë time në fshat. Se unë, more bir, isha jabanxhi në atë qytet, nuk kishte shumë mësues atëherë. Ja kështu!

- Pra, u martove me të.

- S’ ishte martesë, nuk bëra dasmë. Ishte njëfarë rrëmbimi, kështu e hapëm llafin. Kur zakoni priset, rrëmbimi pranohet si zakon në anët tona.

- Pse s’bëre dasmë?

- Eeeee, - lëshoi një psherëtimë mësuesi i vjetër dhe s’foli. Po ç’të më thoshte, mendova unë, se babai i tij qe një burrë i vrazhdë fshati, një patriarkal me qillota shajaku të zi dhe bërruc, çoban dhensh që pinte duhan të grirë në çibuk dëllinje të bërë vetë, që qelbej era djersë e shurrë nga të palarët dhe martesën donte ta quante “rrëmbim”, si kusari që vjedh dhinë e gjitonit? Se familja atje në fshat s’dinte ç’qenë rregullat e qytetit, shëtitjet, se s’kishin parë kurrë me sy plazh ku femrat hiqnin këmishët e dilnin me mbathje banje e sutjena të holla (pupu, turpe të mëdha!). Se nusen e shihnin si bagëti. Se djalin e madh s’donin ta martonin me vajzë qyteti me “dekolte”, shalëjashtë, me fustan mbi kupë të gjurit, por me një çupë fshati nga ana e tyre, të urtë, punëtore, që të milte lopën sabah-sabah, të merrte gomarin e të bënte dru, të priste e ngarkonte shkarpa pjerrinave e skërkave. Po edhe më, të pastronte katoqin nga kakërdhitë, të mblidhte bajgat e t’i bënte pleh. Edhe

më akoma, të hidhte bucelën kurrizit e të zbriste në përrua poshtë, t'i binte vap e vup me kopaçe velenxave në përrua për t'i pastruar nga këllira, pastaj dybekut dup e dap gjersa t'ia nxirrte gjithë gjalpin qumështit të dhirtë. I bënte dot kjo qytetarka? E tirrte në furkë leshin e deleve ajo, dhe ta tëharrte, dhe ta bënte fill, dhe të thurte me shtiza fanella e çorape për 16 shpirt të familjes së madhe të Belulajve?!

E shkreta Tanë, s'mund të ishte Ana e Luçio Batistit! E si mund të ishte Ana mes kakërdhive, kur e vetmja orë që ajo prehej pak nga punët e rënda dhe gjente vetveten, ishte trupi dhe fryma ime netëve kur vija nga qyteti, domethënë vetëm të dielave, se e shtuna qe punë e unë isha larg, i jepja këmbëve, kamion më kamion hipur. Por as unë s'mund të isha i denjë për të, siç i këndonte Xhani Morandi të dashurës së tij italiane. Unë isha një fshatar Shqipërie. Dhe më keq, një fshatar Labërie. Ajo gjithnjë qante. Pasi bënim dashuri, e zinte gjumi, nuk kishte më fuqi. U dobësua shumë sepse nuk hante, nuk qe mësuar me ushqimin e fshatit. Kulaçi i misrit i bënte dëm në stomak. Gjithçka iu shpif. Por kulmi erdhi kur nëna dhe babai e urdhëruan që të vishte çitjanet e të vinte shaminë e bardhë në kokë. U turpëruam në vëllazëri e gjitoni, thoshin ata. Nëna, që nusja të ishte e “mullukrepsur”, e ndershme, kokulur, ndërsa babai, që mos t'ia shikonte pulpat dhe shalët zbuluar nuses tek fshinte odën a hipte shkallëve në katin e dytë, se ishte turp e faqja e zezë. Kur e pashë Tatjanën me çitjane, u lemerisa. Hiqi! - i thashë. Ajo i hoqi dhe të nesërmen në mëngjes ishte e veshur me një fustan të hollë që ia nxirrte bukuri gjithë linjat e trupit të mrekullueshëm, sidomos gjinjtë e mëdhenj, kofshët e drejta. Flokët onde-onde e kishin bërë Perëndi. Qe mu si Ana e Luçio Batistit. Vishi! - bërtiti nëna. Vishi shpejt! - u zymtua sterrë e vrer babai. Vishi! - ulëritën gjithë ç'qenë, farë e fis. Vishi! - gjëmoi fshati. Vishi! - buluriu lopa në haur; Vishi! -

hingëlliu kali; Vishi! - blegërinë delet, pastaj lehu qeni, kakarisën pulat. Vishi! - shungulloi mali. Vishi! - ulëriti dhe përroi. Ky është zakoni ynë, vishi! Dhe ajo i veshi prapë. Dhe prapë qau. Dhe prapë huret e trupit humbën, humbi beli, humbën vithet, humbi gjoksi, humbën kofshët e drejta, humbëm kapakët e gjunjëve, humbi silueta erotike, i përpiu basma e tumanëve si thes. Ajo u zymtua. U vetmua. U neverit. Filloi të pendohej. Të përbuzte. Madje të urrente. “Unë s’rri dot më këtu, Arsen”, më tha një nga ato netët e të dielave kur vija në shtëpi. “Shkojmë në qytet, shteti do të na ndihmojë, gjejmë një dhomë dhe...”

Ja, atë natë gabova, o djalë, nuk fola, nuk i thashë “eja të ikim nesër në mëngjes”. T’ia mbathja si Xhani Morandi e t’i hidhesha nuses në qafë, që të bëhesha i denjë për të. S’kisha guxim të ngrihesha mbi babanë, mbi nënën, mbi motrat dhe vëllezërit, mbi xhaxhallarët, dajat, hallat, tezët, kushërinjtë, fshatarët, zakonin, qentë, lopët, dhitë, pulat. Mbi gjithë Qefseret...

... “Non son’ degno di te”, këndoi lehtë mësuesi plak këngën e Xhani Morandit.

- E kupton? - më pyeti me ashk ai. - Isha dhe mbeta një fshatar. Në fakt nuk desha që Tana ime të ishte me çitjane, triko leshi e shami të bardhë në kokë. E desha të bukur, siç bëhej natën në shtrat kur i hiqte ato të mallkuara e kthehej në mrekulli, hir e aromë, Perëndia vetë. Si Ana e Luçio Batistit, merr vesh?! Drithërimë e ëmbël. Por e kisha qepur gojën, o çun, nuk i thashë “ikim bashkë”. Isha një budalla. Kisha një mal përsipër, s’e ngrija dot, kurrizi m’u bë petë, më shtypte ai drek mali, m’i nxori zorrët e barkut jashtë, ndonëse isha mësues në qytet. Doja t’ia mbathja, ta lija nënën, babanë, motrat, vëllezërit, të gjithë. Doja t’u fusja nga një shkelm në bythë edhe qenit, edhe lopës, edhe kalit, edhe deleve. Edhe maleve. Edhe përroit. Edhe pulave madje. Gjithë Qefsereve

të botës, gjithë asaj skote që s'më linte, veçse më nxirrte gjuhën e më tallte: “Nuk je burrë, nuk je burrë! Të vuri përfund gruaja. Je qullac. Je burrec. O brrec. Nuk ke koqe”.

- Dhe ike?

- Unë jo, iku ajo...

- Tatjana?

- Po. Bëri sikur do të mbushte ujë në kroin e madh, e la bucelën atje dhe ia mbathi malit. “Iku, iku”, ulëriti kroi me sa pati në kokë. “Iku, iku”, buluritën lopët që qenë atje. Por Tana... Ana e Luçio Batistit... doli tutje në xhade, gjeti një makinë dhe u kthye vetë në shtëpi.

- Po ti ç'bëre?

- Desha ta takoja, por ajo s'më qasi.

Ra një heshtje.

Pastaj... “Non son' degno di te”, këndoi sërish mësuesi plak këngën e Xhani Morandit dhe vazhdoi:

- Në fakt, s'më qasën njerëzit e saj, sepse ajo ndoshta donte. Sidoqoftë, ishte shumë e mërzhitur me mua. E zhgënjyer. Babai im erdhi dhe i bujti në shtëpi vjehrrit, folën, u grindën e ç'nuk thanë, por vjehrrit s'e la më të bijën të shkelte në portën e shtëpisë sonë. “Ajo është nusja jonë, vendin e ka në shtëpinë tonë, me zakonet tona”, u kishte thënë vrazhdë babai prindërve të saj. Unë e prisja çdo ditë që Tana të dilte nga shtëpia dhe ta takoja, të sqarohesha, t'i thosha se... Por ajo i druhej takimit me mua. I frikej vetes, mbase. I shmangej një ripranimi. Tmerrohej. Sepse e dija që thellë-thellë më donte akoma. Isha i sigurt se i kujtonte me mall ato pak net kur kthehesha në shtëpi. Isha djalë i fortë, ta thashë, kisha mish në trup. E ndieja afër. I mbaronte fryma nën mua. Mirëpo e kuptonte se në të tjera gjëra unë isha një burrec, një brrec. S'kisha koqe. S'dilja dot mbi babanë. Mbi bërrucin e tij të dhirtë, mbi erën e shurrës së tij në qillotat e leshta, sado

që isha i shkolluar. Tatjana u mbyll në shtëpi të vet, në mes të qytetit. U bë murgeshë. Jo se ishte më e qetë kështu, por ishte më e sigurt. Veçse, syçelur e veshngritur, e dija se dëgjonte gjithmonë gurgullimën e një përroi që zbriste me vërtik teposhtë themeleve të manastirit të saj dhe mes ankthit të befasisë, priste se diku ai ujë i kthjellët e i ftohtë do të gjente një plasë e do të dilte tinëz, heshturazi, si shushurimë, nën këmbët e bukura. Dhe ajo, pa e parë kush, do të pinte nga ai burim i perëndishëm. Nga ai përrua që qante, zhurmonte dhe turravrapej poshtë atij manastiri. Ai përrua duhet të isha unë, e kupton? Mirëpo unë nuk vrapova drejt saj si Xhani Morandi, sepse... “Non son’ degno di te”...

- E si përfundoi? - pyeti djali.

- Siç përfundojnë dashuritë e vrara, pa guxim; dashuritë e fjalës, dashuritë e psherëtimës: një pikë loti dhe një nostalgji që gjithë jetën, deri në të mbramen tënde, pikojnë dhimbje. Një “ah!” i madh që të gërryen, o çun!

- Pse nuk shkove vetë në shtëpinë e saj.

- Shkova, por prindërit e saj s’më pranuan. E pashë Tatjanën prapa xhamit të dritares që më shihte me një sy të molisur. Eja prapë, sikur më thoshte, lutju atyre. Dhe bëra gafën e madhe. I thashë Qefseres që të bisedonte me prindërit e saj. Unë prisja jashtë. Por kur pashë sesi e nxorën me shkelma nga shtëpia Qefseren, u pataksha. Tatjana aq e butë dhe e ëmbël i dha një të shtyrë te dera sa Qefserja u rrëzua nga shkallët e i dolën brekët në selamet. Si gjithnjë, binte era hudhër. “Zhduku dhe mos m’u qas më në shtëpi, llapaqene e dreqit!” - i bërtiti ajo. Unë u fsheha pas një gardhi. Fshatar, more bir, fshatar, nuk m’u dha t’i fusja edhe unë një shkelm bythës, të merrja Tanën dhe t’ia mbathja ku të më hanin këmbët...

S’shkoi as një muaj dhe Tatjanën erdhën dhe e morën njerëz të saj në një qytet të largët.

“Ajo është nusja e tim biri, - kërcënonte babai im prindërit e Tatjanës, - nuk merr dot burrë tjetër veç atij, turpin s’e durojmë dot: o e mbani për vete, o marrim hak!” “Lëre, o shoku Bekim, - i bëhej krah Qefserja, - ata janë borgjezë, familje e degjeneruar!” Babai, nga një anë, e Qefserja, nga ana tjetër, ma bënë mendjen dhallë. Ndihesha i mbrojtur sa dhe i zbuluar lakuriq, i përkëdhelur sa dhe i rrahur, me mundësinë e një ribashkimi sa dhe me prishjen përfundimtare. Ndodhi kjo e dyta. Tatjana iku natën. S’pata guximin t’i thosha as eja, as ik. S’pata guximin ta rrëmbeja e t’ia mbathja në fund të botës. Të vdisja, veç atë ta kisha. Të bëhesha një batanije për pafajësinë e saj. Ta mbroja. Ta dëlirësoja. Nuk isha burrë, s’kisha koqe. Dashuria do koqe. Vetëm dashuria ka guxim, o çun! Unë s’kisha. Stepesha nga nëna, babai, vëllezërit, motrat, xhaxhallarët, dajallarët dhe hallat, dhe tezet, dhe katundarët, dhe më vinte turp, shumë turp nga kali, nga lopa, nga pela, nga delet, nga dhitë, nga qeni dhe... dhe... nga pulat!

- Ptu! - pështyu mësuesi plak dhe thithi puron thellë. - Nuk e pashë më kurrë. Nuk u martova më. Por as ajo s’u martua me dikë. Tani jam ky që jam, një qen i rrahur me bishtin në shalë, pa grua, pa fëmijë, pa nipa, pa askënd në botë. Ja, vij këtu dhe çmallem me të. Ka gjashtë vjet që ka vdekur, ndërsa unë hala s’po vdes. Por s’ka vdekur as Qefserja, ke parë ti?

Unë qesha me të madhe.

- Ta thashë, dashuria është guxim. Ajo më dëshironte, por nuk më dashuronte. Ose-ose isha unë ai që e dëshiroja, por nuk e dashuroja. Kam 50 vjet që s’i jap dot dum kësaj kleçke. I jep dot ti, o çun?! Por një gjë e di sakllam, kur të dyja këto nuk bëhen bashkë, njeriu jo vetëm vuan, por edhe çmendet... A s’ma vë dhe një herë atë këngën e Xhani Morandit? - e bëri syrin të bukur mësuesi plak.

Unë klikova “play” dhe bashkë me këngëtarin e njohur italian, edhe ai nisi të këndonte nën zë:

- ... *Non son’ degno di te...*

KUR HËNA DIGJEJ LART

Ku-ku!...

Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë...

Ku-ku!...

Numëroi përsëri: një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë... derisa zëri i zogut të natës, shi tek “gjashta” ia riniste në mënyrë të përpiktë ritit të tij zanor, pa luajtur as të qindtën e sekondës: ku-ku. Si sahatet elektronike të oficerëve të NATO-s, o Zot! Ku-ku! Dhe atij i bëhej sikur e pyesnin: Ku është? Ku shkoi? Ku humbi? Ku? Ku?...

... E kishte tepruar. Ishte treguar guhak. Budalla. Mendjemadh. Ajo i kishte besuar. Kishin dy vjet që dashuroheshin. Prania e njëri-tjetrit ishte shndërruar jo thjesht në mall e padurim, por pa u takuar një ditë atyre u dukej sikur kalonte një shekull, sikur gjithçka humbte kuptim, sikur mjediset shkretoheshin, bukuria e godinave dhe arkitektura e qytetit zbardhej, shndërrohej befas në një grumbull gurësh, në shkretëtirë, në kurrgjë, në kum.

Ku-ku!...

Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë...

Ku-ku!...

Dhe nata zgjatej e zgjatej gjer në torturë. Sa herë që midis tyre tinëzisht futej mungesa, vuajtja prej saj e mbushte gjumin e tij me ëndrra, shpesh të frikshme, ose të bukura e plot orgazëm, gjersa të vinte e nesërmja apo e pasnesërmja dhe ata të takoheshin rishtazi, të rroknin duart si të dehur, t'i shtrëngonin fort derisa gishtat t'u dhembnin dhe pastaj të putheshin e të putheshin pafundësisht. Ai merrte makinën dhe të dy ia mbathnin larg qytetit, hynin diku në ndonjë rrugë qorre fshati, parkonin pranë ndonjë peme degëgjërë kur dielli digjte apo shiu binte rrebesh dhe aty s'ngopeshin duke u përqaftuar, ledhatuar e puthur. Me shumë ndrojtje, por ajo ia kishte dorëzuar një nga një dyert e kështjellës femërore në mirëbesim: në fillim shikimet e gjata, prekjet e duarve, shtrëngimin e gishtave, puthjet e thella, pastaj erdhi gjoksi i hovur para e me spikamat tunduese të thithave të murrme në të kuqe, barku i ulur poshtë drejt legenit si një trekëndësh, pjesa e fryrë ku puqeshin këmbët e bukura. Pak nga pak ai po e pushtonte atë lëkurë të butë e të bardhë si mëndafsh. Më në fund, pas shumë ngurrimesh, ajo e la dorën e tij të shkonte ledhatuse atje ku fillonte dhe mbaronte femra. Veç kaq, jo më tutje. Banketi i saj ende s'ishte shtruar, mungonte pikërisht ajo mbulesa ngjyrë rozë sipër tavolinës. Sa herë ai bëhej gati ta shtronte, ajo sikur drithëronte, e kapte një panik i pashpjegueshëm, fytyra i zmadhohej, luante kokën sa majtas djathtas, duke shkundur flokët e dendur që i binin mbi qafën e gjatë, të bardhë e të bukur. "Mos, jo atje, mos të lutem!", përgjërohej ajo. Dhe ai e linte, ndrydhte lëngjet e tij, ose ato lëngje merrnin arratinë jashtë vullnetit të mendjes, prirë nga kafshimet e instinktit, vërshonin tutje pa rregull, si të habitura, të hallakatura, madje të fyera, dhe mandej... Mandej ai i kërkonte falje për gjithë atë "ndyrësi" të vdekur mbetur diku si kripa a shkuma e detit nëpër

këmbët e saj mbushur me faj. Fryma i mbahej. Ritmi i zemrës hovte përpjetë, mu sikur do t'i çahet kraharori. Gjaku i rrihte fort në tëmtha. Madje i pulsonte edhe nën cipën e hollë të syrit. Pak nga pak e mblidhte veten dhe e vinte kokën e tij mbushur flokë të ashpër e të dendur mbi gjoksin e saj. Ajo ia merrte, kridhte gishtat e hollë me thonjtë e zgjatur mbi atë shkurrishte flokësh si drizë, e puthte pa pushim dhe e shtrëngonte fort e më fort, sikur ta fuste të tërin në kraharorin e vet. Dhe qante heshturazi. Pa e parë ai. “Më fal”, i shushurinte mbushur e gjitha në faj, gati si e mekur, pa zë, aty rrëzë veshit, duke ia puthur llapën e duke ia mbajtur lehtë mes gjuhës dhe dhëmbëve...

Por ja, erdhi një ditë që ai nuk e priste. Teksa përqafoheshin në shtrat me trupat lakuriq si gjithnjë, ajo me një lëvizje fare të lehtë të vitheve, një si zhvendosje nga lart poshtë, u duk se e ftoi drejt misterit të saj. “Hyr”, i tha. Këmbët sikur u zbutën çuditërisht, fijet e nervave u lëshuan, ngërçet e dikurshme të muskujve në fundbark po e linin, tensioni po i binte. Ai u ndje, më në fund, Zoti i saj. Porta ishte e hapur. E befta kishte bujtur. Ja, mu aty. Aty. S’duhej veçse ta shtyje pak dhe... Madje-madje, ajo vetë sikur donte t’ia shtynin atë portë xhami që ai të hynte pa mundim. Dhe ai veç sa trokiti pakëz, veç sa e shtyu pakëz, fare pak, si psherëtimë, e teksa ia preku një grimë paretet e qelqta asaj porte të qullur, në çast lumi i tij i rrëmbyeshëm vërshoi, derdhi aty breshër të zjarrtë meteorësh. Dhe mbeti. Dhe i iku fryma. Gjoksi i ulej e i ngrihej me shpejtësi. U hutua. Dhe ashtu ende në lumnajë zjarri, u habit. Por nuk donte ta besonte, jo! Si kishte mundësi që aty, tek ai vend i shenjtë, tek ato qelqe, të mos ekzistonte ajo, “diga pritëse”? Si kishte mundësi që ai lumë të hynte kaq “lehtë”?! A ishte “diga” e saj njësoj si e gjithë vashave të tjera? Njësoj si ajo siujdhesa e mitit ku Skilla dhe Karridba përgjaknin udhëtarët e guximit teksa hynin e sfidonin sinorët e pakalueshëm të ngjizjes?

Ai kishte pasur edhe më parë kontakte seksuale me femra dhe e dinte shumë mirë se ç' ishte penetrimi, paçka se, në asnjë nga ato raste, “diga pritëse” nuk kishte qenë aty. Jo, jo, jo, ajo e paskësh gënjyer. Në parardhomën e saj s'kishte farfuri, por një pellg të zi. Si gjithë të tjerat. Ajo na kishte luajtur me të. Kishte bërë, pra, të “ndershmen”. Të “virgjërën”. Virgjërëshën e Orleanit, Zhan Darkën. Oh, mos! S'i lipsej veçse një dëftesë për ta vërtetuar, ashtu si te novela e Kadaresë “Natë me hënë”. E gjitha paskësh qenë “letërsi”. Trill i ëmbël. Teatër. Cipë purpurore.

Smalt verbues. Dritë dhe fishekzjarrë. Ah! Po pse? Pse? U ndje i humbur. I fyer. Deri në palcë i shpërfillur. I tallur. Një leshko, një idiot.

Urëmbimthi u çua nga krevati. Veshi pantallonat, pastaj bluzën e hollë. Kanotierën e harroi diku aty. Edhe çorapet. Ajo kishte mbetur cullak mbi shtrat. E pa fare rrëshqitazi. Trupi i saj i lakuriqtë kishte mbledhur gjunjët rreth vetes sikur t'i bënte njësh me barkun. Vuri re sesi ajo i vendosi padashur duart e saj mbi gjoksin e madh dhe spikamat e thithave, për t'i mbrojtur nga syri i tij. Apo nga një “sy” shpues që mund të ishte diku, në një qoshe të dhomës, i padukshëm.

- Ku shkon, prit?! - i foli ajo e alarmuar. Zëri i saj qe bërë vajtues. Ai nuk po i kthente përgjigje, përkundrazi po mbërthente me duart e dridhura kopsat e pantallonave, veshi këpucët dhe u mat nga dera, pa e kthyer kokën pas. “Pse, - i kishte thënë, - ku po shkon ashtu?” Pse? Atij veç kjo pyetje i rrihte në tru. Ajo u çua si e trembur. Sytë i kishin grumbulluar shumë frikë përbrenda cipës. Dhe panik. Fytyra i qe prishur, qe zbardhur krejt, si në jerm.

- Eja, mos u nxito!... Nuk është e vërtetë ajo që mendon, Goni, të betohem!

- E mësova të vërtetën, paskam qenë një gomar. Betimet lëri për “tjetrin”...

Ai e theksoi fjalën “tjetrin” dhe ironia ia prishi buzët e tulta.

- Të lutem, mos ik! Prit pak, të bisedojmë. Të lutem!

Zëri i saj tashmë ishte fund e krye lutës, përgjërues, mbytur në vaj. Ajo po dëneste. Në çastin e fundit, teksa ai po mbyllte derën e apartamentit, ia pa syrin e rrëmbushur, por dhimbjen e tmerrshme të saj s’e dallooi dot. Veç i mbeti në kokë ai sy ashtu i rrëmbushur. Te dera ndjeu se si ajo ia kapi dorën.

- Të lutem, më dëgjo! - i tha si një qen i rrahur keq nga i zoti. Por ai ia shkëputi dorën me forcë dhe e mbylli derën e apartamentit nga jashtë. Nga pas vinte vaji i saj si kuisje. Një dëshpërim e ngashërim që gati e bëri të ndalonte, por sakaq diçka sikur e pickoi fort dhe ai zbriti vrik dy shkallët e para, pastaj dhe dy të tjera, dhe dy e nga dy gjashtë kate si i çmendur gjersa zbriti poshtë. Dhe u zhduk.

- Ku-ku!...

- Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë...

- Ku-ku!...

Koka po i çahet, gjaku i rrihte fort diku thellë në vesh. Pa orën në errësirë. Fosfori mbi akrepa jepte një dritë të verdhë. “Drita e vdekjes”, donte të tallej ai me veten. Por humori s’i shkonte, s’e lehtësoi dot. Ironia i kthehej në pezëm e pezmi në një pikëllim vrasës. S’kishin kaluar as gjashtë minuta ende, ndërsa zogu i natës, çdo gjashtë sekonda, në gjashtë minuta, kishte vikatur “ku-ku!” gjashtëdhjetë herë. Ai s’i kishte dëgjuar, vetëm kishte menduar. Ndoshta, vetëm përfytyruar. Por përfytyrimi i skenës së ndarjes që më zymtor se vetë mendimi.

... Dhe zogu i natës filloi sërish: “Ku-ku!...”. Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë: “Ku-ku!...”. Më çmendti ky buf, po më çahet koka! Ku-ku! Ku pikërisht? Ku ishte cipa e virgjërisë së saj? Ku? Qelqet qenë thyer, qenë bërë copë e grimë, o buf, o kukuvajkë! Ku-ku?

Plaç, të preftë, ti vetëm “ku-ku” di të bësh! Por ajo s’qe kurrkund, a më dëgjon? S’e hasa kund. Ku-ku? Kurrkund po të them. Ku-ku! Askund. Ku-ku! Po fundja pse të ishte? Qelqet e femrave gjithnjë thyhen. E ç’është një cipë virgjërie veçse një ind i butë, elastik, thuajse poroz, si rrjetë, ku kapet “peshku”. “Peshku” i trurit të tij. Plazma e tij. Sepse “peshku” tjetër e çan atë rrjetë dhe hyn në det.

- Ku-ku!...

S’mund ta duronte më atë zog të shpifur. Mori telekomandën dhe hapi televizorin. E ngriti volumin aq sa zëri nga jashtë të mos dëgjohej më. U shfaqën ca njerëz me maska. Mes tyre, maska korbash. Nuk bënë “ku-ku!”, por flisnin. Ja dhe aktori i njohur i “Hollivudit” Tom Kruis. Qe një film i Kubrikut “Syri që vret” me rituale shtrigërimi dhe orgji erotike. Dhjetëra femra dhe meshkuj lakuriq kryenin si në një meshë të zezë një orgji seksuale të pacipë, thuajse “të ftohtë”, sikur të qenë manekinë apo aktorë teatri. Ku-ku! Ku ishte fshehur ajo cipë, në ç’pjesë të trupit? Asgjëkund! Së paku ato femra atje në ekran nuk thoshin “jam e virgjër”, mendoi ai, thjesht e bënë atë punë; e ndyrë apo jo e ndyrë, s’ka rëndësi. Dhe kaq. Janë të ndershme. Si bushtrat. Se edhe bushtrat janë të ndershme. Madje, kur ai akt shndërrohet në rit, s’mund ta quash “të ndyrë”. Është diç e zakonit, e përsëritshme. Pjesë e riprodhimit. Njëfarë liturgjie, afërmendsh jo e fjalës. Më mirë ca femra lakuriq, si kopetë në afsh mes deshve, por të “ndershme” dhe të “hapura” në atë që bëjnë, sesa dikush me dy vjet gënjeshtër, me shtirje, me “ndershmëri” dhe në fund një ujë barku i bërë moçal kushedi sa vite më parë. “Pëf!” - u gërmuq ai. “E ndershme!...” Dhe grykën ia përpushi shija e athët e neverisë.

- Ku-ku!...

“Plaç, të preftë, se më nxore trutë!”

E kishte dashur shumë. O Zot, sa shumë! E kishte respektuar. Kishte bërë siç donte ajo. Kishte vuajtur për vete, kishte duruar

trysninë e mishit të tij duke e shndërruar lumin në deltë, derdhur diku gjatë, por aty s'kishte synuar të hynte pa qenë ajo e para gati. As vetë s'e dinte pse kishte ndodhur kështu dhe pse kishte duruar kaq shumë si mashkull i fortë, dy vjet, deri në kufijtë e budallallëkut. Ai nuk ishte një eunuk. Atëherë, pse kishte luajtur si budalla rolin e eunukut? Mos ishte vërtet një budalla. Mos ajo e kishte idiotizuar krejt?

Gjithë ato femra e meshkuj lakuriq atje në ekran bënë seks, gjënë më të zakonshme të kësaj bote. Ata s'bënë “dashuri”. E pse i duhet thënë seksit “dashuri”? Ja, ky ishte keqkuptimi i madh. Ai e dashuronte dhe mendonte se dashuria ishte përtej seksit si rit, duke qenë thelbi i vetë seksit, por tashmë me një tjetër emër: Eros. Dashuri do të thoshte “drejt vdekjes”, nga latinishtja “a-morte”, prej nga binte tingulli “t” dhe mbetej “a-more”... Pra, diçka që të lidhte me vdekjen. Shumë më e thellë dhe shumë më tutje se kënaqësia e shpejtë dhe lëndore e seksit. Vdekja ishte hiçi i madh. Fataliteti luante në violën e dashurisë duke e shndërruar këtë të fundit në epilogun e vdekjes. Edhe seksi kishte një lloj “vdekjeje” në mes, pasi orgazma në vetvete kryhej dhe shoqërohej nga erëra vuajtjesh e dhimbjesh të ëmbla. Por gjithsesi ajo që lënda e shprishur, asgjë më shumë. Dashuria, përkundrazi, vdekjen e kishte në frymë, e shndërronte në mit. “Pëf!... - shfryu ajër mes buzëve të shtrënguara Goni, - lojë fjalësh ku bien me kokë budallenjtë si unë. “Peshk budalla, re në rrjetën e saj, - shau veten ai, - i besove si korbi me djathin në gojë teksa dhelpra po të mburrte. Dhe ky korb i lazdruar na e hapi sqepin e vet, ndërsa djathi na ra drejt e në gojën e dinakes që priste poshtë teje. Ja kështu na qenke dhe ti, o trangull, një korb budalla!”

Ku-ku!...

“Mjaft, zog i çartur, mjaft se më çmende me këtë zë të shpifur! E di, jam një idiot, një hajvan, një derr me zile, një glasë, një... një bretkosë...”

Tek e shante veten me fjalët më të vrazhda, ia behu në mendje procesi i fekondimit të bretkosave, parë diku në emisionet e “Discovery Channel”-it. Njësoj si bretkosat edhe ai me të. Po së paku bretkosat qenë të lumtura dhe të pafajshme në seksualitetin e tyre. Mashkulli i hipte femrës, vendoste dy këmbët e tij të përparme mbi shpinën e saj dhe me dy këmbët e pasme i jepte fort ujit si lopata, duke lundruar e duke qitur jashtë 8 deri në 10 milionë farëza në çdo derdhje; po aq vezë lëshonte edhe bretkosa femër. Mirëpo bretku dhe bretkosa nuk depërtonin te njëri-tjetri, siç bënte njeriu. Edhe skifterët në ajër po njësoj e kryenin aktin e tyre seksual, pa depërtuar, duke u pllenuar nëpërmjet erës që krijohej nga mënyra e rrahjes së krahëve. Një iluzion i pastër. Shumë i bukur. Kaq. Pra, atij i thuhej që të bëhej një bretk (bretkosa mashkull) apo një skifter mashkull (qift), dhe jo një njeri?! Të mos depërtonte te femra. Të ndërronte gjini pra, të bëhej tjetër specie? Kështu?! E kush i hante këto broçkulla?! Ai mund të ishte edhe një bretk, mjaft që Zoti llojin e tij, njeriun, ta kishte bërë ashtu: bretkosë. Por rregulli ndër njerëz ishte tjetërfarë. Me depërtim.

Ku-ku!...

“Plaç, të preftë!” - mallkoi për të satën herë ai. Edhe ky zog nate një lloj qifti është, qyqe i thonë, ose kukumjaçkë. Edhe kjo e lëshon farën jashtë. Jo, korrigjoi pastaj, ky s’është skifter, ndonëse i ngjan skifterit. Është një zog dobiç ardhur prej një tjetër dobiçi, sepse ajo që e ka pjellë është ndryshe nga gjithë shpendët e tjerë. Është një kurvë e regjur. Përdor një rreng të paparë. Ajo vetëm vezët ua lë në fole zogjve të tjerë për t’ua rritur, si kalamajtë në jetimore, kurse pllenimin e bën po njësoj si i gjithë lloji i gjallesave me pupla që fluturojnë. Është, pra, një dinake, një hileqare, një skuthe: ua hidhte të tjerëve, jo t’ia hidhnin. Kurse mua duan të ma hedhin. Të më vënë brirët. Të më nxjerrin gjuhën. Të më bëjnë një bretk-bretkosë...

Vazhdoi të shfrynte kështu ndaj vetes edhe ca kohë, donte ta largonte imazhin e Inisit, qoftë edhe një grimë, por qe e pamundur. Prapë dhe prapë i shfaqeshin lotët e saj, sytë e skuqur, përgjërimi me fjalët “të lutem, mos ik!” dhe ajo dorë e dobët që rrekej ta mbante gjithsesi, dhe ai gjoks i zbuluar që cekte bërrylin e tij, dhe krejt ajo bardhësi lëkure, e pambrojtur tashmë, e gjitha e tij para pak sekondash, që i drithëronte pranë e që i lutej, që i përfalej, ashtu vajtueshëm sa zemra të çahet dysh: “Mos ik!”.

Nuk e përballoi dot më tej imazhin, hapi laptopin dhe nisi të shkruante gjithë inat, me furi, rrëmujshtëm...

“... Dje u ndamë. Jetoja me një gënjeshtër. Dashurinë e kisha ngritur mbi një gënjeshtër. Nuk më fyen aspak nëse dikur, diku, ti ke pasur një të dashur. Pas viteve '90, por edhe më përpara, shumë njerëz ‘cipën e virgjërisë’, qe apo nuk qe, e kishin zgjidhur vetë, në mirëbesim, me kthjelltësinë e arsyes. Ti s’ma thoshe, por në fakt, thellë-thellë, mburreshe me atë cipë, sikur ajo të qe një bizhu e shtrenjtë, si diamantet miliardshe në kurorën e mbretëreshës Elisabetë. Jo, ajo cipë s’ka qenë dhe s’është për mua një diamant. As një talisman. Ca më pak misteri i mbarsjes së virgjëreshës Mari me Frymën e Shenjtë. Unë s’jam nga ata që ti ke menduar se jam, duke të kërkuar një dëshmi virgjiniteti. Por edhe bretkosa mashkull nuk jam. As qifti i erës. As bufi i natës. Jam një djalë si gjithë të tjerët. Duke të dashur shumë, unë sakaq të kisha përligjur. Koha vetë përligj. Ajo ‘cipë’ për mua s’është veçse një konvencion, për disa të tjerë një tabu. Gati një fe. Por ama unë s’mund ta pranoj dot ‘pacipësinë’ tënde, domethënë më troç cipën e kthyer në pacipësi. U ndjeva aq keq. I poshtëruar. Një budalla. Po pse? Sepse pikërisht gënjeshtren s’mund të ta fal. Unë s’jam katundari, por qytetari. E çmova fjalën tënde si një vuajtje, qoftë dhe si një ndrojtje. Kaq. Desha të të gjendesha pranë për

ta tejkaluar tronditjen që kishe pasur, Inis. Isha me ty, pa qenë te ti. Kisha një iluzion në duar dhe ai u thyë. Kush e theu, unë apo ti?...”

... Orgjia atje në ekran vazhdonte ende, ndërsa ai po shkruante. Po kujt po ia dërgonte vallë atë letër? Asaj apo vetes? Apo askujt. Shfrim kundër saj apo kthjellim për vetveten qenë ato fjalë nervoze? Apo asgjë? Ai humbi një copë herë në këtë dilemë dhe truri iu mbush me mendime tjetërlloj. Syri vazhdonte të shikonte aktorët, ndërsa mendja e tij përballë kishte veçse atë, Inisin. S’mbante mend se gjer kur e gjer sa sytë e tij qenë të fiksuar pas ekranit, ashtu bosh, me tjetër mendim në kokë. Dikur u përmend nga trandja. Orgjia në ekran kishte mbaruar me kohë dhe dialogu burrë-grua (Tom Kruiz me Nikol Kidman, të shoqen e atëhershme, në jetë e në film), nën veskun e nënkuptimeve, pandehmave dhe ironisë, mbushur gjithë spica e shpoti, mëtonte një tjetër domethënie për dashurinë: dashurinë pa maskë, pa e kthyer atë në ritin e ndyrë dhe informal të seksit, i shndërruar në frymëzim satanik, në orgjinë dionisiake ku “Satirët” qeshnin me përvuajtjen e mishit femëror dhe “Bakantet” nxirrnin gjuhët e tyre epshore, lëpiheshin, gufonin gjinjtë, frynin me gjak mishrat e drunjëzuara të meshkujve, i kafshonin, gjersa nëna në pamendjen e incestit lakmonte trupin e të birit mbret të Tebës që kokën t’ia priste me duart e veta në dalldinë e dehjes dhe ekstazës profanike. “Cila ‘kokë’ duhej prerë?” - mendoj ai në të qindin e sekondës. “Ajo që mendon apo ajo që pllenon?” Por e la pas dore argumentin. Kur dashuria tjetërsohet, ajo ose dhemb keq në shpirt, ose vdes. “‘Bakantet’ dhe ‘Satirët’ nuk mund të tallen me mendjen, janë përtej saj, tjetër ‘nomenklaturë’, tjetër ‘institucion’, senjorët e vdekjes rituale të mishit, i dha fund arsyetimit ai.

E donte shumë Inisin. Qenë njohur në plazhin e Dhërmiut mes një grupi shoqesh e shokësh, siç të rinjtë njihen ashtu lehtësisht. Kishte notuar me të larg dhe ajo e kishte lejuar që këmbët e tyre nën ujë të prekeshin shpesh e më shpesh. Pastaj duart, pastaj ai e kishte rrahur me stërkala uji në fytyrë, ia kishte qullur flokët. I kishte bërë “vulimë” duke e zhytur në thellësi me duart e tij të forta. Ishte futur dhe vetë dhe i buzëqeshte nën ujë. Ajo ishte kapur pas trupit të tij e trembur dhe të dy kishin dalë në sipërfaqe. Por... Gjalmi lidhës i sutjenës së saj që këputur dhe gjiri i majtë, ashtu i bukur si një perëndeshë, thuajse argjendor nga rrëzëllima e diellit, i la pa mend që të dy: ajo nga turpi prej vashe, ai i hutuar mes epshit që i plasi në buzë për t’ia puthur. Qeshën të dy. Ai ia lidhi atë gjalmë mëkatar sutjenash të holla. Gjijnjtë e saj të plotë shtrëngoheshin pas gjoksit të tij muskolor. Ajo sërish qeshi. Edhe ai qeshi. E rinisën këtë “akrobaci deti” sërish e sërish: herë duke e zhytur ajo atë e herë duke e zhytur ai. Në ditën e katërt ata kishin prekur duart dhe duart u shtrënguan vetiu mes gishtash. Nuk u puthën. Ai sikur e ndjeu se ajo nuk dëshironte ta çonte më tutje atë fillim të bukur, që as vetë s’e kuptoi sesi lindi ashtu me atë këputje gjalmi “mëkatar”. Ajo pati një tërheqje të jashtëzakonshme ndaj tij. Edhe ai ndaj saj. Ai kishte mundësi ta puthte, por jo. Nuk duhej ta puthte. Kur u kthyen në Tiranë, s’rrinin dot një ditë pa u takuar. Ai priste sa mbaronte punë dhe fill takohej me të. Ajo, madje, i dilte rrugës edhe në mëngjes, kur ai shkonte në zyrë. Gjithë pasditet rrinin bashkë, kudo bashkë. Në teatër, në kinema, në bare. Një ditë ai e ftoi në apartamentin e vet. Ajo nuk refuzoi, as luajti me fjalët, por e ndoqi pas si të ishte gruaja e tij. Aty u puthën. Nuk shkëputeshin dot. Çdo pasdite kështu. Dikur ai e ngriti hopa dhe u drejtua për nga krevati i tij. E lëshoi ngadalë aty. Ajo as këtë herë nuk refuzoi. Ai nisi ta shkopsisë. Ia hoqi trikon me duart që i dridheshin. Edhe asaj i dridheshin duart, por

nuk bëri asnjë gjest kundërshtimi. Ai qëndronte tashmë mbi të. Peshonte mbi gjoksin dhe barkun e saj. Pasdite të tjera, pak nga pak, një rrobë këtu e një rrobë atje, ata filluan të zhvishen dhe të njohin trupat e tyre, aromën e lëkurës. Kur ai, i ndezur nga gjaku në një prej atyre pasditeve, vonë, kërkoi të hynte në tempullin e saj, teksa apartamenti i tij pak nga pak po mbushej me errësirë duke luajtur me dritën e mekur që hynte nga dritarja, ajo e shtyu me dorë. “Jo”, i tha. Dhe ai pranoi, u tërhoq. Siç u tërhoq dhe vetë drita që fizonte e vdiste në ajër, atje mbi trupat e tyre të zhveshur e të avullt. Bënin dashuri, veç në tempull jo. “Si të ndihesh ti shpirt”, ia kthente ai.

“Të lutem kuptomë, - i përpushej buzëve ajo, - s’mundem dot tani, më vonë...”

“Po, po”, ia kthente ai dhe ia mbyllte gojën me të puthurat e nxehta. Pa fund.

Ku-ku!...

Thuhet se ky shpend është alegoria e “orës së vdekjes”, frymën e dikujt numëron. Frymën time. Dashurinë time të vdekur. Dhe ndërkohë mendja e Gonit paralelizoi diçka nga rrëfenjat e *Biblës*.

“Ej, Adam, ku je?” - i foli Zoti njeriut të parë fill pas tundimit të djallit-gjarpër dhe kafshimit të mollës prej Evës (dijes dhe jetës).

“Jam këtu, pas ferrës, Zoti im!” - i përgjigjej Adami JHV-së.

“Dil atëherë, pse rri fshehur?” - e urdhëroi Zoti. Dhe Adami, tok me Evën, dolën nga ferra. “Paske kafshuar mollën”, i tha Zoti. Ishte dhurata mistike që Krijuesi i pat dhënë Krijesës së vet. Me ta kafshuar, ata kishin njohur turpin duke e mbuluar veten me gjethe fiku. Atëherë Zoti i flaku nga Parajsa dhe Edeni në tokë, jetën ua pakoi nga 800 në 80 vjet, i bëri të vdekshëm dhe dijen e vjedhur ua futi nëpër mijëra dilema, luhatje, dyshime, moskuptime e zhgënjime. JHV-ja, që në hebraishten e vjetër (aramaisht) do të thoshte “Unë Jam!”, pra Zoti, JEHOVA, kur e pa se krijesa e tij

njihte “turpin”, i bërtiti: “Ti s’je më i imi!”. Dhe njeriu e humbi përfundimisht Zotin, shëmbëlltyrën e tij. Gjethja e fikut e bëri dinak. Ajo mbulonte, nuk zbulonte. Nisi të gënjente Zotin dhe veten e tij njëkohësisht. Sepse “gjethja” u bë misteri dhe tinëzia e tij. Dhe fajin e pati pikërisht ajo, që ata u shumuan në mijëra e miliarda Eva nëpër kohë, pra në mijëra e miliarda pabesi. Djalli tashmë dinakërisht ishte futur brenda mishit të dytësit të njeriut, *Femrës*, si një cipëz e hollë, mbushur plot fluskula nga shfrynte e mbillte tundimet. Njerëzit, si për t’u ribashkuar me premtimin dhënë Zotit në zanafillë, në shenjë pendese, e kishin shenjtëruar me kohë “gjethe-cipën” femërore, e kishin bërë tempull, engjëll, Bibël, Kuran, tabu, poezi. Po Zoti s’u kishte besuar më dredhivë të Adamëve. I quajti meshkuj-budallenj që u besonin femrave të nxjerra nga brinja e tyre, ca biçim hajvanësh e naivësh, kopukë, që përgjeshin për të krijuar ndaj këtyre femrave një alibi: *e kam, pra jam*. “Mbajeni për vete ‘gjethe-cipën’ tuaj, - u kishte thënë JHV-ja shekujve dhe civilizimeve, - marrëveshja ime me ju tash e tutje është ‘ndershmëria’.” Atëherë, pak nga pak, meshkujt e çmuan ndershmërinë e femrave të tyre jo më te pasja ose jo e cipës së virgjërisë, por te mirëbesimi, pra te “pakti i ri” me Zotin, ku shenja e besnikërisë ndaj mashkullit zhvendosej nga mishi drejt frymës, duke përmbysur kahun e alibisë së tyre: *s’e kam, por jam*. Ideja u shndërrua në kod, mishi ra nga pushteti, tabuja u shkurorëzua, fryma u bë Zot.

“Ej, Inis, ku je fshehur?”, u përtall Goni duke e shndërruar historinë e tij me Inisin në një mit biblik apokrif, rrëzuar me kryet poshtë, kthyer në absurd. Pastaj i erdhi keq, madje ndotë se përse e kishte krahësuar Inisin dhe “mashkullin” e parë të saj që e pat zhvirgjëruar me Adamin dhe Evën, çiftin biblik, fshehur pas ferrës, me gjethen e fikut përpara. Kurse për vete kishte marrë atributet e Zotit-gjykatës JHV.

Ku-ku! - çirrej zogu i natës.

Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë... Vetëm gjashtë sekonda, asnjë më shumë dhe sërish: “Ku-ku!”. Si një kuje. “Buf i lig, mjaft me këtë zë të shpifur! Ligaç!” Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë: “Ku-ku!”. S’po i ikte nga truri syri i rrëmbushur i Inisit, sidomos dora: “Mos ik! Të lutem, eja të bisedojmë, Goni!...”. Por ai e kishte mbyllur derën. E kishte lënë atë pas shpine, ashtu lakuriq, me duart e vogla që mbulonin gjoksin e plotë, teksa i përgjërohej: “Ej, Eva, ku je? Pse e mban atë gjethe fiku përpara?”. Ah, ajo kishte mbetur lakuriq në sytë e tij, pa “gjethen e fikut”. E kishte lënë zbuluar atë të çarë të pafajshme, kishte harruar. Apo qe e hutuar? “Dil nga ferra ku je fshehur, Eva!” Ah, syri i saj ishte aq i trembur! “Turpin” e kishte lënë jashtë, por kishte sakaq shumë turp përbrenda. “Ej, Inis, me kë ke fjetur para meje?”

Gjithfarë përfytyrimesh, bërë lëmsh njëri me tjetrin, i zhuzhitnin Gonit brenda kafkës, e pickonin, e thumbonin, lëshonin helm duke e torturuar drejt e për më drejt. Kërkonte t’u shmangej, por ato më keq e kafshonin me dhëmbët e hollë e të mprehtë, si një tufë nepërkash. Nepërka që tundoi Evën. Dhe Eva Adamin budalla. Dhe Adami mua...

Inis!

Nuk jam mirë. Fytyra jote po më përndjek, si Orinitë Orestin. Po çmendem, Inis. Shiu i lotit tënd po bëhet breshër i vuajtjes sime. Ti veç lot kishe, kurse unë breshër, furtunë, zjarr. Po si ndodhi kështu, aq papritur, Inis? Njësoj si shiu i verës tek bëhet breshër, kur tejshkon mes për mes një shtrese të ftohtë ajri. Sipër. Ku sipër? Mos do të thuash, Inis, se fati është një paracaktim nga atje “sipër”, me të cilin s’mund të matemi dot?! Ndodh dhe kështu, siç ndodh edhe ndryshe. Oh, po vuaj shumë, Inis! S’e mbajta dot më të fshehtë, ia thashë motrës sime. Motra ime është me ty, Inis...

“Oh, moj motra ime, unë e dua Inisin, por s’mundem, më kupton?”

“Jo, s’të kuptoj, vëllai im!”

“Më erdhi aq keq për të, besomë! Dhe teksa po mbyllja derën m’u duk sikur e preva më dysh trupin lakuriq të Inisit që lëshonte avull, ashtu duke m’u lutur, ngjitur pas meje.”

“Dhe ti ike, vëllai im, ia mbathe!”

“Ç’të bëja tjetër, motër! Porsa nisa të zbres shkallët si i marrë, dy e nga tre, nga pas sikur dëgjoja po atë zë përgjërues: ‘Mos ik, Goni, të lutem!’ Zëri i saj kishte ndryshuar befasisht, motër, nga ledhatar e përplot psherëtima, ishte mbushur me lëngatë.”

“I le një çiban në gjoks, vëllai im.”

“Dhe ajo, o motra ime, qau. Nuk qau, por iu tund gjoksi nga ngashërimi.”

“Po ti ç’bëre, vëllai im? E le, e braktise?”

“Po, motra ime, e lashë. U bëra aq keq. Ecja apo vrapoja, s’di ç’të them, por me siguri do të kem pasur pamjen e një të marri.”

“Pse e bëre këtë, vëllai im?”

“Sepse jam burracak, motra ime.”

“Jo, s’je burracak, je frikacak, vëlla.”

“Më mbeti në vesh ajo lutje, o motër, ajo qarje me ngashërim, gjersa mbërrita në shtëpi dhe ta thashë ty, s’duroja dot më, plasa.”

“I paske hedh’ një mal me baltë mbi kurriz Inisit, vëllai im.”

“S’di se si t’ia heq, motra ime...”

Goni futi kokën nën jastëk, s’e duronte dot dritën dhe aty, në terr, loti mbi sytë e saj, që i shfaqej përpara me një dritë ndryshe, erdhi fill e hyri në sytë e tij. “O Zot, ç’bëra kështu?!” I ra dytri herë nënkresës me grushte, por kjo çartje s’e ngushëlloi dot. Sytë e rrëmbushur të Inisit nuk i iknin. “Po pse, shpirti im bën kështu, s’dua aspak të të lëndo, sikur i thoshin ata. Ndoshta kam bërë gabim me fjalët që të kam thënë më parë, me atë çfarë në

mirëbesim me ngulm të kam kërkuar. Ta kam shpjeguar, shpirti im, isha në vitin e parë gjimnaz atëherë, s'dija ç'ishte dashuria, aq më pak seksi. Por ata çunat e maturës, ashtu budallaçka siç qemë ne vajzat e vitit të parë, na dhanë të provonim nga një të thithur cigare hashashi. Shoqet e thithën gjithë qejf dhe qeshnin. 'Thithe, thithe, thithe!' - thoshin ato. Më në fund e thitha dhe unë. M'u duk sikur më lëvizën muret, tavanin ngjitej lart, kurse vetë rrija shtrirë mbi tavan dhe nuk bija. Dikush ma vuri cigaren sërish në buzë. 'Thithe, thithe, thithe!' Dhe unë sërish e thitha, s'mbaj mend sa herë e thitha. Sa tym i ëmbël?! Tani s'kishte më as tavan, as dysheme, as mure, asgjë prej gjëje. 'Thithe, thithe, thithe!' - më ulërinin shoqet. Dhe unë e thitha prapë dhe prapë. Dhe një si qiell i kuq u hap para meje, pastaj qielli u bë i gjelbër, pastaj i purpur, pastaj i verdhë, pastaj ndryshonte ngjyrë me shpejtësi, herë pas here, si t'i tekej. Mbinin lule, cicërinin zogj. S'isha më aty, isha në ajër. Mbaj mend vetëm që një djalë i gjatë, i madh, më shtrëngonte fort nga gjinjtë dhe po m'i hapte këmbët. S'di ku i kisha mbathjet. Doja t'i gjeja diku mes këmbëve, por aty s'kishte kurrgjë, veç trupi i tij i fortë që kërkonte me ngulm nënbarkun tim. Kur ula kokën poshtë, pashë atë tmerrin e tij dhe u tmerrova aq shumë. Po më dridhej trupi. Më dolën para sysh mijëra kukudhë me sy të jeshilët, gungaçë, plaka me hundë të mëdha shtrigash dhe dhëmbë të rënë. 'Jam 'Valpurgu'', më ulëriti mu në turin një Mag flokëverdhë. E kisha mësuar në leksionet e letërsisë 'Faustin' e Gëtes dhe 'Natën e Valpurgut' të tij mbushur plot fantazma. 'Je e imja, je e imja', sikur më klithnin në kor kukudhët, kurrizot, shtrigat, magët me pelerinat e zeza. Dhe ai, *Shtrigani i Madh*, i zi, i trashë, si gjarpër me një sy, që tërbohej mes kofshëve të mia. Duhet të kem bërtitur se ai, djaloshi i gjatë e trupmadh, m'i vuri duart në gojë që mos të dëgjohesha jashtë asaj dhome moteli. Përpiquej të bënte punën e mashkullit me atë tmerr që kishte mes këmbëve. Gjarpri me një sy..."

“Ku je fshehur ti Adam?”

“Pas ferrës, Zoti im.”

“Kush të tha ta kafshosh mollën time?”

“Eva, imzot.”

“Po Evës, kush i tha?”

“Gjarpri.”

“Ik, atëherë, zhduku nga Parajsa, s’je më i imi, por i Gjarprit.”
Dhe Zoti i kishte flakur që të dy poshtë në baltë.

“Mooooooooos!” - kishte bërtitur më në fund Inisi.

Ndoshta ishte pikërisht ai tmerr që më solli në vete, Goni. Dhe atëherë dallova sipër meje tavanin, kurse poshtë nën shpatulla ndjeva dyshtemenë e ftohtë. Lulet u bënë ferra, ndërsa cicërimat e zogjve u bënë gulçimet e atij çuni trupmadh. Më kishte shtrirë aty. Këmbët i kisha ende të hapura. Tmerri i tij ishte si një përbindësh. Por tmerri tjetër, që ai përbindësh i zi mund të hynte në barkun tim (!), o Zot, kjo qe... kjo qe... e padurueshme. Fillova të klithja. U mbrojta, s’di se nga më erdhi gjithë ajo fuqi gjersa atë tmerr e hoqa prej meje. Ja, kjo ka qenë e gjitha, Goni. Ta kam thënë një herë, pse më detyron të ta them prapë? Nuk di ç’të të shpjegoj tjetër, por që atëherë më zuri tmerri nga “tmerri” i atij mashkulli. Ai njeri më pështyu vajzërinë, kupton? Më futi frikën. S’di sesi kam dalë nga ajo dhomë ku qemë me shoqet, veç kur kam mbërritur në shtëpi nëna u shqetësua aq shumë, sa më futi në dush menjëherë. Më pastroi dhe më lau, ndërsa unë ndieja sesi nga trupi im ai “tmerri” po ikte pak nga pak bashkë me ujin e pistë dhe hynte rrëke pas rrëkeje në piletën e banjës. Dridhej e përdridhej, fërkonte bishtin pas këmbëve të mia si gjarpri, nuk donte të ikte, mbahej fort herë pas kofshëve, herë pas gjinjve, rridhte e lëpihej currila-currila, por pileta më në fund e thithi të tërin. Ajo e degdisi te ulluqet e zinj të nëntokës. Ata e morën dhe e futën shtatë pashë nën dhé. “Shpëtova”, thashë. Ashtu lakuriq,

u plandosa në krevat në dhomën time dhe qava e qava. Në shpinë ndieja duart e nënës që më fshinte me peshqir të butë e më puthte flokët: “Mos u tremb, shpirti i mamit, ke mamën tat këtu, thuamë çfarë të ka ndodhur?!”. Dhe ia thashë të gjitha. Ajo ishte mjeke dhe më provoi. “Mos qaj, e bukura e mamit, asgjë s’ka ndodhur, ai horr s’ka mundur dot të të prekë.” Dhe më parfumoï gjithandej. Dhe era e trëndafilit e thithi dhe e ngopi lëkurën time. “Trëndafil i bukur!” - më shushurinte nëna. Po Goni, kisha mbetur e virgjër. Por tmerrin e kisha të gjithin brenda vetes, asnjë dashuri s’ma hiqte dot. Asnjë djalë.

“Pse e mashtrove Adamin, Eva?”

“Nuk e mashtrova unë, Zot.”

“Po kush?”

“Gjarpri i zi.”

“Ku është gjarpri?”

“Nuk e di, imzot.”

“Atëherë vuaj!”

Dhe unë e vuajta atë “gjarpër të zi”, Goni. Po ja, erdhe ti, i butë, i mirë, fjalëbukur, i ëmbël, përfalës, mirëkuptues, gjithë dritë dhe “tmerrri” sikur ikte tinëz e tinëz nga sytë e mi. Ti ishe ndryshe, zemër. Ti më kuptoje. Ti më toleroje. Ti e munde tmerrin tim. Ti i the: “Ik, se ta këpus kokën!”. Dhe ai po ikte. Ditë pas dite e puthje pas puthje. Dhe natën më dukej se ti vije si një princ i bardhë. Atyre orëve të bardha të netëve pa fund, si këshilltarët më të mirë të njeriut, kam menduar gjatë: s’do desha asnjë sekondë të të lëndoja, i miri im, jo, kurrë! Por doja veç pak kohë, fare pakëz, aq sa lëkura jote e shtat prej “gjarpri” të të kthente në një princ këmishëbardhë siç ti je, kaq qe e gjitha. Kohën ti ma dhe, por gabove, u nxitove. Ishe në vrap. Dhe kur mashkulli është në vrap, shtegu humb. Humb rruga, drita. Humb arsyeja, kështu më tha nëna. Mirëpo dashuria, zemra ime, s’ka arsye, ajo e sfidon

atë. Dashuria është arsyeja e vetvetes. Është ajo që na mungon. Ajo që e lakmojmë. Ajo që na bën “ndryshe”, që na nxjerr nga rituali vrasës i të përditshmes. Dhe lumi ynë del nga shtrati për të gjetur një tjetër shtrat. Arsyeja e dashurisë është fryma ime, fryma jote, jo mishi yt, as mishi im. Ato janë vesku i arsyes, jo vetë arsyeja. Ti gabove, zemra ime dhe më le vetëm, fillikat, në dëshpërimin tim. Një ind i butë femre brenda barkut të pafajshëm e të pabëzajt s’është arsyeja. Kurrë! Është thjesht një shenjë, një stoli, një garmë e integritetit të saj, madje as e tillë s’është. Është veçse “mirëseardhja”. Si ike ashtu, i dashuri im?! S’arrita dot as të vishesha, isha vetëm me lëkurën time, me turpin tim. As gjoksin e pafajshëm s’e mbulova dot. As “atë”, ku ti kërkoje një cipë mbrojtëse, gjithsesi. Një gjethe fiku. Një pergamenë me fjalë prej Zotit. Edhe “atë”, të shenjtën gjë timen, për herë të parë e kisha lënë zbuluar, të pambrojtur, nën mëshirën, mirëbesimin dhe përdëllimin tënd. Oh, sa shumë më ke fyer! Unë s’të kam gënjyer, shpirt...

“Ku je fshehur, Adam?”

“Pas ferrës, Zoti im.”

“Shfaqu siç je!”

... Po binte mëngjesi. Zogu i natës kishte kohë që kishte pushuar.

Goni u la, u vesh dhe doli. I pihej një kafe e fortë. U ul në një bar, ku lexohej “Mërturi”. Rrugët qenë me pak njerëz. Makinat po shtoheshin si pa u kuptuar, qyteti po rilindte nga barku i frymëve të qelbura, orgazmat, çlirimet e zorrëve, meritë dhe betejat e shtratit, ëndrrat e frikshme apo të lëbyrta nga yllësitë e erosit shigjetngulës.

- Mirëmëngjesi, - dëgjoi një zë.

- Mirëmëngjesi, - ia ktheu baristi. Dikush tjetër kishte hyrë në bar. Pa orën. Kishte kaluar gati një orë aty ulur në karrige, i vetëm

me mendimet e tij dhe kafenë e fortë. U çua dhe ndoqi trotuarin që të shpinte drejt qendrës. Gjithnjë në syrin e tij ishte Inisi. Lotët e saj. Ngashërimi i syrit dhe zbulimi i gjoksit. Kurse në vesh dëgjonte gjithë po atë lutje: “Mos ik!”. S’e kishte mendjen në vend. U kujtua kur përbri i kaloi autobusi i linjës plot me njerëz, të cilët nxitonin të kapnin punët. Koha iu duk e zbrazur, truri i tij i zbrazur, zemra e zbrazur. Dy orë të tjera të zbrazura rrugëve të Tiranës. Çaponte kuturu...

“Ku po shkon, Adam?”

“S’e di, Zoti im! Koka m’u bë këmbë e këmba m’u bë kokë...”

... I duhej të shkonte në punë. Këmbët ndryshuan drejtim. Ndryshuan drejtim dhe mendimet e tij. “Le të rrinin siç qenë”, ia behu Gonit në kokën e lodhur një ide e marrë. Le të duheshin me fjalë, ndoshta dhe pa përkëdheljet e tepërta atje ku ndjeshmëria, puthjet, gishtat vraponin drejt të “shenjtës” gjë, sepse gjaku i tij s’ishte si i asaj, mbase ai kërkonte më tepër se çfarë i ofronte ajo, nuk e vuante mashkullitetin e tij siç ajo vuante feminitetin e saj, atë cipë virgjërie dhe atë frikë prej pranisë së seksit mashkullor, kur ajo edhe pa këto të dyja i kishte dhënë shumë, shumë lumturi, atë që ai s’e kishte pasur kurrë më parë. Me asnjërën. Edhe pse kaq herë ajo ngurronte ta çonte drejt burimit të vet, pak nga pak ai nisi të pranojë mendimin se Inisi mund të kishte të drejtë, se ai vërtet qe nxituar, emocioni i tij, asaj dite qe shumë i fortë. Kishte bërë një orgazëm të shpejtë, thuajse të rrufeshme. Ashtu siç plasnin e shkërmoqen galaktikat. S’kishte kuptuar gjë. Ishte ngatërruar. Në vend të cipës së ajërt të tokës, trupi i tij i mushtulluar kishte qitur zjarr e flakë mashtruar nga iluzioni, aty, në ndërmjetmen mes gravitetit shtypës dhe humbjes së peshës. Kaq. Gjithçka qe një keqkuptim. Oh, sa turp!

“Pse je mbuluar, Adam?”

“Eva më tha të mbulohem se kishte turp.”